

Lihona



**Hiri i Tij i Mahnitshëm,
f. 10, 12**

**Përse Duhet ta Ndjekim
Seminarin? f. 20, 46, 48**

**Prindër, Gjeni Kohë për të
Folur me Fëmijët Tuaj, f. 34**

**Fëmijë, Flisni me Prindërit
Tuaj, f. 58**



ME MIRE SINË E INSTITUTIT TË ARTEVE NË MINEAPOLIS (MINESOTA, SHBA), FONDIT PUTNAM DANA MEK MILAN, NUK LEJOHET KOPJIMI

Mohimi nga Shenjtori Pjetër, nga Gerrit van Honthorst

“Një shërbëto e pa ulur [Pjetrin] pranë zjarrit, . . . dhe tha: ‘Edhe ky ishte me [Jezusin]’.

Por ai e mohoi duke thënë: ‘O grua, nuk e njoh’.

Pak më vonë e pa një tjetër dhe tha: ‘Edhe ti je nga ata’. Por Pjetri tha: ‘O njeri, nuk jam’.

. . . Një tjetër pohoi me këmbëngulje duke thënë: ‘Në të vërtetë edhe ky ishte bashkë me të’. . . .

Por Pjetri tha: ‘O njeri, s’di ç’po thua’. Dhe menjëherë . . . këndoi gjeli. . . .

Atëherë Pjetri doli përjashta dhe qau me hidhërim” (Luka 22:56–60, 62).



MESAZHET

- 4 Mesazhi i Presidencës së Parë: "Ai Është Ngritur" – Dëshmia e një Profeti**
Nga Presidenti Tomas S. Monson
- 7 Mesazhi i Vizitave Mësimore: Duajini, Mbrojini dhe Forcojini**

ARTIKUJT KRYESORË

- 12 Shlyerja dhe Udhëtimi i Vdekshmërisë**
Nga Plaku Dejvid A. Bednar
Si na forcon Shlyerja për të bërë mirë e për të qenë të mirë dhe për të shërbyer përtej dëshirës dhe aftësisë tonë.
- 20 Bekimet e Seminarit**
Nga Britëni Biti
Rinia në mbarë botën tregon se si seminari i ndihmon ata të vijnë te Krishti.

- 26 Një Thirrje për një të Kthyer në Besim**
Nga Helena Hanonen
Unë dhe familja ime duhet të bënim shumë sakrificë që unë të përmbushja thirrjen time si pianiste e degës, por jam e lumtur që i bëmë.

- 30 Këshillat e Lagjeve në Punë**
Nga LaRin Gant
Kush është pjesë e këshillit të lagjes dhe çfarë duhet të përmbushin?

SEKSIONET

- 8 Bllok Shënimesh për Konferencën e Prillit: Të Mësojmë më Shumë nga Konferenca e Përgjithshme**
Nga Majkëll Barber dhe Dejvid Marsh

- 10 Ne Flasim për Krishtin: Hiri i Mahnitshëm**
Nga Kristën Nikol Kardon

- 34 Shtëpitë Tona, Familjet Tona: Gjetja e Kohës për të Folur e për të Dëgjuar**
Nga Rozmari M. Uiksom

- 38 Zëra të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme**

- 74 Lajme të Kishës**

- 79 Ide për Mbrëmje Familjare në Shtëpi**

- 80 Kur Prapë të Takohemi: Shpresë te Shlyerja**
Nga Peshkopi Riçard C. Exhli

NË KOPERTINË

Përpara: *Mos Më Prek*, nga Minerva Teichert, me mirësinë e Muzeut të Artit të Universitetit "Brigam Jang". Prapa: Detaj nga *Vini Re Duart e Mia*, nga Jeff Ward.

**42 Të Gjithë e Njohin Bllekun**

Nga Adam C. Olson

Dashuria e Bllekut për basketbollin ka qenë në të njëjtën kohë një provë dhe një bekim.



Shihni nëse mund të gjeni Liahonën e fshehur në këtë botim. E dhënë: Zgjidh faqen e duhur.

46 Pyetje e Përgjigje

Përse duhet të shkoj në seminar kur thjesht mund t'i studioj shkrimet e shenjta në mënyrë të pavarur?

48 Përse Duhet ta Ndjekim Seminarin?

Shtatë profetë flasin për bekimet e seminarit.

50 Seminari në Xhunglat e Ekuadorit

Nga Xhoshua J. Perki

Si i ka mbushur seminari të rinjtë në një lagje të re kryesisht me të kthyer së fundmi në besim, me dëshmi, njohuri dhe besim.

52 Çfarë Vjen pas Seminarit?


Nga Dejvid A. Eduards

Ja fiesa juaj për në institut.

53 Rresht pas Rreshti: 2 Timoteut 3:16-17**54 Mos u Rrëzoni**

Nga Adam C. Olson

Pak kujdes dhe përgatitje tani, mund të parandalojnë probleme të mëdha më vonë.

57 Afishe: Studiojini Shkrimet e Shenjta**58 Koha për të Biseduar**

Nga Hilari Uotkins Lemon

Xhozi ishte e trishtuar për atë që ndodhi në shkollë, por të folurit rreth asaj e ndihmoi atë të ndihej më mirë.

61 Ai Këputi Lidhjet e Vdekjes

Nga Plaku Patrik Kiëron

Shpëtimtari vdiq dhe u ringjall në mënyrë që ne të mund të jetojmë përsëri me Atin tonë Qiellor dhe familjet tona.

62 Sjellim Filloren në Shtëpi: Jezu Krishti Më Mëson të Zgjedh të Drejtën**64 Muzikë: Përpiqem t'Jem si Jezusi**

Nga Xhenis Kap Peri

66 Motra në Emër dhe Besim

Nga Hedhër Rigli

Motrat në Rumani tregojnë se si e forcojnë ato besimin e tyre.

68 Dëshmitar i Veçantë: Çfarë Mund të Bëj që të Ndjek Planin që Ati Qiellor Ka për Mua?

Nga Plaku Riçard G. Skot

69 Standardet e Mia Ungjillore**70 Për Fëmijët e Vegjël****81 Figura të Shkrimeve të Shenjta nga Libri i Mormonit**

48



Për pajtimet dhe për çmimet jashtë Shteteve të Bashkuara dhe Kanadasë, ju lutemi të lidheni me qendrën tuaj vendore të shpërndarjes të Kishës ose me udhëheqësin e lajjes apo degës.

Paraqitini dorëshkrimet dhe pyetjet në internet në liahona.lds.org; nëpërmjet postës elektronike liahona@ldschurch.org; ose nëpërmjet postës në *Liahona*, Rm. 2420, 50 E. North Temple St., Salt Lake City, UT 84150-0024, USA.

Liahona (një term nga Libri i Mormoni, që do të thotë "busull" apo "drejtues") botohet në anglisht, armenisht, bislamisht, bullgarisht, çekisht, danisht, estonisht, fihxisht, finlandisht, frëngjisht, greqisht, gjermanisht, holandisht, hungarisht, indonezisht, islandisht, italisht, japonisht, kambodhisht, kinezisht, kiribatisht, koreanisht, kroatisht, letonisht, lituanisht, malagasisht, marshallisht, mongolisht, norvegjisht, polonisht, portugalisht, rumanisht, rusisht, samoaisht, sebuanisht, sllovenisht, spanjisht, suedisht, shqip, tagalogisht, tahitisht, taisht, tongaisht, ukrainisht, urduisht dhe vietnamisht. (Periodiciteti ndryshon sipas gjuhës.)

© 2012 nga Intellectual Reserve, Inc. I rezervohen të gjitha të drejtat. Shtypur në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Lënda e shkruar dhe ajo figurative e *Liahonës* mund të kopjohet për ta përdorur me raste në kishë ose në shtëpi, jo për tregti. Lënda figurative nuk mund të kopjohet nëse ajo shoqërohet me kufizime të shënimi i meritave për punën artistike. Çështjet e së drejtës së autorit duhet të adresohen te: Intellectual Property Office, 50 E. North Temple St., Salt Lake City, UT 84150, USA; adresa elektronike: cor-intellectualproperty@ldschurch.org.

For Readers in the United States and Canada:

April 2012 Vol. 14 No. 1. LIAHONA (USPS 311-480) Albanian (ISSN 1521-4753), is published four times a year (April, May, October and November) by The Church of Jesus Christ of Latter-day Saints, 50 E. North Temple St., Salt Lake City, UT 84150. USA subscription price is \$3.00 per year; Canada, \$3.60 plus applicable taxes. Periodicals Postage Paid at Salt Lake City, Utah. Sixty days' notice required for change of address. Include address label from a recent issue; old and new address *must* be included. Send USA and Canadian subscriptions to Salt Lake Distribution Center at address below. Subscription help line: 1-800-537-5971. Credit card orders (Visa, MasterCard, American Express) may be taken by phone. (Canada Post Information: Publication Agreement #40017431)

POSTMASTER: Send address changes to Salt Lake Distribution Center, Church Magazines, PO Box 26368, Salt Lake City, UT 84126-0368.

Më Shumë Gjenden në Internet Liahona.Lds.org



PËR TË RRRITURIT

Disa artikuj në këtë botim japin mësim dhe dëshmojnë për Shpëtimtarin. Mësoni më shumë rreth Tij në JesusChrist.Lds.org.

PËR RININË

Disa artikuj në këtë botim flasin rreth bekimeve të seminarit (shih faqet 20–25 dhe 46–53). Për të mësuar më shumë, vizitoni seminary.Lds.org.

PËR FËMIJËT

Për të dëgjuar këngën "Përpiqem t'Jem si Jezusi" (shih faqet 64–65), vizitoni liahona.Lds.org.

TEMAT NË KËTË BOTIM

Numrat përfaqësojnë faqen e parë të artikullit.

Bindja, 54

Familja, 34, 42, 58, 66

Frymëzimi, 39, 40

Hiri, 10, 12

Instituti, 52

Jezu Krishti, 4, 10, 12, 61, 64, 70

Këshillat, 30

Komunikimi, 34, 58

Konferenca e përgjithshme, 8

Libri i Mormoni, 38

Lutja, 41

Muzika, 26, 64

Përgatitja, 54

Puna misionare, 42

Ringjallja, 4, 61, 62, 70

Seminari, 20, 46, 48, 50

Shlyerja, 4, 12, 61, 62, 80

Shpresa, 80

Standardet, 69


Studimi i shkrimeve të shenjta,

53, 57, 68

Thirrjet në Kishë, 26, 30

NË GJUHËN TUAJ

Liahona dhe materiale të tjera të Kishës janë të disponueshme në shumë gjuhë në languages.Lds.org.

Nga Presidenti
Tomas S. Monson

“Ai Është Ngritur”

DËSHMIA E NJË PROFETI

“**T**hirrja kumbuese e krishtërimin”, ka deklaruar Presidenti Tomas S. Monson, është se Jezusi i Nazaretit u ngrit së vdekuri. “Realiteti i Ringjalljes u jep të gjithëve, paqen që ia tejkalon çdo zgjuarësi” (shih Filipianëve 4:7).¹

Në fragmentet vijuese, Presidenti Monson ndan dëshminë dhe mirënjohjen e tij për Ringjalljen e Shpëtimtarit dhe deklaroi se për shkak se Biri mposhti vdekjen, të gjithë fëmijët e Atit që vijnë në tokë, do të jetojnë përsëri.

Jeta përtej Vdekshmërisë

“Besoj se asnjë prej nesh nuk mund ta konceptojë rëndësinë e plotë të asaj që bëri Krishti për ne në Gjetseman, por çdo ditë të jetës sime jam mirënjohës për sakrificën e Tij shlyese në të mirën tonë.

Në çastin e fundit, Ai mund të kthehej pas. Por nuk u kthye. Ai kaloi nën të gjitha gjërat, që të mund t’i shpëtonte të gjitha gjërat. Duke vepruar ashtu, Ai na dha jetë përtej kësaj ekzistence tokësore. Ai na ka rifituar prej Rënies së Adamit.

Deri në thellësinë e vetë shpirtit tim, i jam mirënjohës Atij. Ai na mësoi si të jetojmë. Ai na mësoi si të vdesim. Ai na siguroi shpëtimin.”²

Çlirimi nga Errësira e Vdekjes

“Në situata të caktuara, për shembull në vuajtje dhe sëmundje të mëdha, vdekja vjen si një engjell i mëshirës. Por, në pjesën më të madhe, ne e mendojmë atë si armikun e lumturisë njerëzore.

Errësira e vdekjes mund të zhduket përgjithmonë nëpërmjet dritës të së vërtetës së zbuluar. ‘Unë jam ringjallja dhe jeta’, foli Mësuesi. ‘Ai që beson në mua, edhe sikur

të duhej të vdesë do të jetojë. Dhe ai që jeton e beson në mua, nuk do të vdesë kurrë përjetë.’

Ky pohim – po, madje konfirmimi i shenjtë – i jetës përtej varrit mund të sjellë fare mirë paqen e premtuar nga Shpëtimtari kur Ai i siguroi dishepujt e Tij: ‘Unë po ju lë paqen, po ju jap paqen time: unë po jua jap, po jo si e jep bota; zemra juaj mos u tronditë dhe mos u frikësoftë.’³

Ai nuk Është Këtu

“Shpëtimtari ynë jetoi përsëri. Ngjarja më e lavdishme, më ngushëlluese dhe më siguroese e të gjithë historisë njerëzore kishte ndodhur – fitorja mbi vdekjen. Dhimbja dhe agonia e Gjetsemanit dhe e Kalvarit qenë zhdukur. Shpëtimi i njerëzimit që siguroar. Rënia e Adamit që korrigjuar.

Varri i zbrazët atë mëngjes të parë të Pashkës ishte përgjigja për pyetjen e Jobit: ‘Në qoftë se njeriu vdes, a mund të kthehet përsëri në jetë?’ Të gjithëve atyre që mund të më dëgjojnë unë u deklaroj: ‘Nëse një njeri vdes, ai do të rrojë përsëri’. Ne e dimë, sepse ne kemi dritën e së vërtetës së zbuluar. . . .

Vëllezër dhe motra të mia të dashura, në orën tonë të hidhërimit më të thellë, ne mund të marrim paqe të plotë nga fjalët e engjellit atë mëngjes të parë të Pashkës: ‘Ai nuk është këtu: sepse u ringjall’.”⁴

Të Gjithë Njerëzit do të Jetojnë Përsëri

“Ne qeshim, qajmë, punojmë, luajmë, dashurojmë, jetojmë. Dhe më pas vdesim. . . .

Dhe ne do të kishim qëndruar të vdekur nëse nuk do të kishte qenë për një Njeri dhe misionin e Tij, madje Jezusin e Nazaretit. . . .



Me gjithë zemrën time dhe zjarrin e shpirtit tim, unë ngre zërin në dëshmi si dëshmitar i veçantë dhe shpall se Perëndia jeton. Jezusi është Biri i Tij, i Vetëmlinduri i Atit në mish. Ai është Shëlbuesi ynë; Ai është Ndërmjetësi ynë me Atin. Ishte Ai që vdiq në kryq për të shlyer për mëkatet tona. Ai u bë fryti i parë i Ringjalljes. Për shkak se Ai vdiq, të gjithë do të jetojnë përsëri.”⁵

Një Dëshmi Vetjake

“Unë shpall dëshminë time personale se vdekja është mundur, fitorja ndaj varrit është arritur. U bëfshin realitet për të gjithë fjalët e shenjtëruara prej Atij që i përbushi ato. Kujtojini. Vlerësojini. Nderojini. *Ai u ringjall.*”⁶ ■

SHËNIME

1. “Ai Është Ringjallur”, *Liahona*, prill 2003, f. 7.
2. “Në Lamtumirë”, *Liahona*, maj 2011, f. 114.
3. “Now Is the Time”, *Liahona*, janar 2002, f. 68; shih edhe Gjoni 11:25–26; 14:27.
4. “Ai Është Ngritur”, *Liahona*, maj 2010, f. 89, 90; shih edhe Jobi 14:14; Mateu 28:6.
5. “E Di se Rron Shëlbuesi Im!” *Liahona*, maj 2007, f. 24, 25.
6. *Liahona*, prill 2003, 7.

MËSIMDHËNIA NGA KY MESAZH

Pasi të ndani citate nga mesazhi i Presidentit Monson, vini re dëshminë që ai ndan për domethënien e vërtetë të Pashkës. Ju mund t’u bëni pjesëtarëve të familjes pyetjet në vijim: “Çfarë do të thotë për ju që një profet i gjallë ka dëshmuar për këto të vërteta sot? Si mund t’i zbatoni ato në jetën tuaj?” Merrni parasysh të shtoni dëshminë tuaj.

Unë do ta Shoh Atë Përsëri

Nga Morgën Uebek

Babai e bëri secilin nga ne fëmijët të ndihet i veçantë. Ai na donte dhe do të na falte lehtësisht. Ai bëri më të mirën për t'u siguruar që secili prej nesh të ishte i lumtur, dhe ai e bëri të qartë se dëshironte më të mirën për ne. Unë e doja shumë atë.

Kur isha në klasën e gjashtë, babai im vdiq në një aksident me makinë. Unë dhe familja ime ishim plotësisht të trishtuar. Kishte një boshllëk të madh në familjen tonë. Babai ishte personi tek i cili mbështeteshja, i vetmi tek i cili drejtohesha nëse do kisha probleme. Në vend që të kërkoja ndihmë pasi ai vdiq, unë lejova inatin dhe dhembjen që të më shoqëronin. Përfundimisht vendosa se ishte faji i Perëndisë. Ndala së lexuari shkrimet e shenjta dhe së luturi. Shkoja në kishë vetëm sepse dëshironte Mamaja. U përpoqa të qëndroja larg nga Ati im Qiellor.

Më pas shkova te kampi i Të Rejave për herë të parë. Më pëlqeu të takohesha me shoqe të reja, por përsëri nuk i lexova shkrimet e mia të shenjta. Mbrëmjen e fundit ne patëm një mbledhje dëshmish. Unë ndieva diçka që s'e kisha ndier për një kohë të gjatë: Shpirtin. I admiroja vajzat që ngriheshin dhe ndanin dëshmitë e tyre, por qëndrova e ulur, sepse mendoja se nuk kisha një dëshmi. Papritmas ndieva sikur duhet të ngrihesha. Hapa gojën, duke pyetur veten se çfarë të thoja. Kështu që, thashë se isha e lumtur për kampin e vajzave Të Reja. Më pas e gjeta veten duke thënë se e dija se Jezu Krishti vdiq për mua dhe se Ati im Qiellor më donte dhe se Kisha ishte e vërtetë.

Isha mbushur me një paqe të papërshkrueshme. Falë kësaj përvoje, unë mund të them se e di se do ta shoh përsëri babain tim për shkak të Shlyerjes dhe Ringjalljes së Shpëtimit.

FËMIJËT

Ai Jeton!

Presidenti Monson jep mësim se për shkak se Jezu Krishti vdiq dhe u ringjall, ne të gjithë do të jetojmë përsëri. Shiko figurat më poshtë. Shkruaj një numër në secilën kuti për të treguar radhën sipas së cilës ndodhën këto ngjarje.

Për shkak se Jezu Krishti jeton, familjet mund të jenë së bashku përgjithmonë. Vizato një figurë të familjes tënde në kutinë më poshtë.





Studiojeni këtë material plot lutje dhe, si të jetë e përshtatshme, diskutojeni atë me motrat që vizitoni. Përdorini pyetjet për t'ju ndihmuar të forconi motrat tuaja dhe për ta bërë Shoqatën e Ndhimës një pjesë aktive të vetë jetës suaj.

Duajini, Mbrojini dhe Forcojini

Njësoj si Shpëtimtari, mësueset vizitore shërbejnë një nga një (shih 3 Nefi 11:15). Ne e dimë se jemi të suksesshme në shërbimin tonë si mësuese vizitore kur motrat tona mund të thonë: 1) mësuesja ime vizitore më ndihmon të rritem shpirtërisht; 2) unë e di se mësuesja ime vizitore kujdeset fort për mua dhe familjen time; dhe 3) nëse kam probleme, unë e di se mësuesja ime vizitore do të veprojë pa prituri që t'i kërkohet.¹

Si mundemi ne si mësuese vizitore ta duam, ta mbrojmë dhe ta forcojmë një motër? Në vijim janë nëntë sugjerime që gjenden në kapitullin 7 të librit *Daughters in My Kingdom: The History and Work of Relief Society [Bija në Mbretërinë Time: Historia dhe Puna e Shoqatës së Ndhimës]* për t'i ndihmuar mësueset vizitore t'u shërbejnë motrave të tyre:

- Lutuni çdo ditë për të dhe familjen e saj.
- Kërkoni frymëzim për ta njohur atë dhe familjen e saj.
- Vizitoni atë rregullisht për të mësuar se si po ia kalon dhe për ta mbështetur e forcuar atë.
- Qëndroni në kontakt të shpeshtë me të nëpërmjet vizitave, telefonatave, letrave, postës elektronike, mesazheve me celular dhe gjesteve të thjeshta të mirësisë.
- Përhëndeteni atë në mbledhjet e Kishës.
- Ndhimjojeni atë kur ka një urgjencë, sëmundje ose nevoja të tjera të ngutshme.
- Mësojani asaj ungjillin nga shkrimet e shenja dhe Mesazhet e Vizitave Mësimore.



- Frymëzoheni atë duke i dhënë një shembull të mirë.
- Raportoni te udhëheqësja e Shoqatës së Ndhimës për shërbimin e tyre dhe mirëqenien shpirtërore e materiale të motrës.

Nga Shkrimet e Shenjta

Lluka 10:38–39; 3 Nefi 11:23–26; 27:21

SHËNIME

1. Shih Xhuli B. Bek, "Ajo Ç'Ka Unë Shpresoj se Mbesat e Mia (dhe Nipërit e Mi) do të Kuptojnë rreth Shoqatës së Ndhimës", *Liahona*, nëntor 2011, f. 113.
2. *Daughters in My Kingdom: The History and Work of Relief Society* (2011), f. 112.
3. *Daughters in My Kingdom*, f. 119–120.
4. Brigham Young, "Remarks", *Deseret News*, 15 tetor 1856, f. 252.
5. Shih *Daughters in My Kingdom*, f. 36–37.

Çfarë Mund të Bëj Unë?

1. Si mund ta di se për çfarë kanë nevojë motrat e mia?
2. Si mund ta dinë motrat e mia se unë interesohem thëllësisht për to?

Besim, Familje,
Ndhimë

Nga Historia Jonë

"Vizita mësimore është bërë një mjet për t'i ndihmuar gratë shenjtoze të ditëve të mëvonshme në mbarë botën për të dashur, ushqyer e shërbyer – 'për të vepruar sipas atyre mirëkuptimeve që Perëndia ka mbjellë në kraharorin [tonë]', siç na mësoi Jozef Smithi."²

Një motër që ka mbetur e ve së fundmi, tha për mësueset e saj vizitore: "Ato dëgjuan. Ato më mbështetën. Ato qanë me mua. Dhe ato më përqaftuan. . . . [Ato] më ndihmuan për të dalë nga dëshpërimi dhe depresioni i thellë i atyre pak muajve të parë të vetmisë."³

Të ndihmuarit me punë fizike është gjithashtu një formë shërbimi. Në konferencën e përgjithshme të tetorit të 1856-ës, Presidenti Brigam Jang njoftoi se pionierët e karrocave të dorës qenë bllokuar në borë të thellë 270–370 milje (435–595 km) larg. Ai u kërkoi shenjtorëve të ditëve të mëvonshme në Solt-Lejck-Siti që t'i shpëtonin ata dhe të "përqendroheshin pikërisht mbi ato gjëra që ne i quajmë materiale"⁴.

Lusi Mesërv Smith shënoi se gratë hoqën fundet e brendshme dhe çorapet e tyre të ngrohta pikërisht atje në tabernakull dhe i grumbulluan në qerre për t'i dërguar te pionierët që po ngrinin. Më pas ato mblodhën dyshekë dhe veshje për ata të cilët do të vinin përfundimisht me pak plaçka. Kur kompanitë e karrocave të dorës mbërritën, një ndërtesë në qytet ishte "ngarkuar me furnizime për ta"⁵.

Bllok Shënimesh për Konferencën e Prillit

“Atë që unë, Zoti, kam thënë, e kam thënë, . . . goftë nëpërmjet zërit tim apo nëpërmjet zërit të shërbëtorëve të mi është njësoj” (DeB 1:38).

Të Mësojmë më Shumë nga Konferenca e Përgjithshme

Nga Majkëll Barber dhe Dejvid Marsh

Seksioni i Programeve Mësimore

Edhe pse themi “amen” në mbarim të sesionit të fundit të konferencës së përgjithshme, ushqimi shpirtëror me bollëk nuk ka pse të përfundojë atje. Ai mund të vazhdojë për sa kohë që i studiojmë dhe i zbatojmë mësimet nga ajo konferencë. Përgjatë viteve, profetët na kanë nxitur të bëjmë pikërisht atë. Për shembull, në 1946-ën, Presidenti Harold B. Li (1899–1973) u bëri thirrje anëtarëve që t’i lejonin bisedat e konferencës “të ishin udhëzuese për mënyrën se si ata do të vepronin dhe do të flisnin gjatë gjashtë muajve të ardhshëm”. Ai shpjegoi: “Këto janë çështjet e rëndësishme që Zoti vendos t’ia zbulojë këtij populli në këtë ditë”¹.

Në vitin 1988, Presidenti Ezra Taft Benson (1899–1994) përsëri shprehu atë këshillë kur dha mësim:

“Për gjashtë muajt e ardhshëm, botimin e konferencës

tuaj të *Ensign-it* duhet ta vendosni pranë veprave tuaja standarde dhe t’i drejtoheni shpesh”².

Në mbyllje të konferencës së përgjithshme të tetorit 2008, Presidenti Tomas S. Monson ripohoi rëndësinë e studimit të bisedave të konferencës. Ai tha: “E mbajshim mend për shumë kohë atë që kemi dëgjuar gjatë kësaj konference të përgjithshme. Mesazhet që u dhanë do të shtypen në numrat e muajit të ardhshëm të revistave *Ensign* dhe *Liahona*. Unë ju nxis t’i studioni ato dhe të meditoni për mësimet e tyre.”³

Ndërsa i studioni dhe meditoni për mesazhet e konferencës, çfarë mund të bëni ju për t’i bërë ato më kuptimplotë



në jetën tuaj? Këtu janë disa sugjerime për t'ju ndihmuar që të përgatiteni, t'i merrni dhe të veproni sipas fjalëve të frymëzuara:

Përgatituni për të marrë frymëzim. Qoftë nëse i shihni, i dëgjoni, ose i lexoni bisedat e konferencës, ju duhet ta hapni zemrën dhe mendjen tuaj ndaj frymëzimit hyjnor. Plaku Dejvid A. Bednar, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, dha mësim se, nuk ka rëndësi se sa efektivisht një folës mund të japë mësim, “përmbajtja e një mesazhi dhe dëshmia e Frymës së Shenjtë depërtojnë në zemër vetëm nëse një marrës i lejon ato të hyjnë”. Ai shpjegoi se marrja e frymëzimit “kërkon përpjekje shpirtërore, mendore e fizike dhe jo thjesht marrjen e çfarëdolloj gjëje që ndodh të vijë tek ju”⁴.

Idetë në vijim mund t'ju ndihmojnë të përgatiteni për të marrë mësim me anë të Shpirtit:

1. Gjeni kohë dhe krijoni një mjedis ku mos të ketë gjëra që ju hutojnë, në të cilin ju mund të merrni nxitje shpirtërore.
2. Kërkoni udhëheqje hyjnore përmes lutjes.
3. Rendisni pyetjet ose shqetësimet vetjake për të cilat jeni duke kërkuar përgjigje.

Kuptoni mesazhet. Profetët dhe apostujt e gjallë japin mësim, sqarojnë, këshillojnë, paralajmërojnë dhe dëshmojnë. Hedhja e një vështrimi më të afërt në bisedat e tyre do t'ju ndihmojë t'i kuptoni më plotësisht mesazhet e tyre. Më poshtë janë disa metoda të efektshme studimi:

- **Bëni pyetje.** Për shembull: Çfarë dëshiron Zoti që unë të mësoj nga ky mesazh? Si e zgjeron kjo bisedë kuptimin tim për një parim të ungjillit ose një varg të shkrimit të shenjtë?

Çfarë historish janë përdorur për të ilustruar parimet e ungjillit dhe çfarë mësoj prej tyre?

- **Bëni një skicë orientuese.** Kushtojini vëmendje asaj që duket të jetë skica orientuese e folësit. Ndajini bisedat në paragrafe dhe



SHKRUAJENI DHE MENDONI RRETH SAJ

“Nga gjithçka që kemi dëgjuar, mund të ketë një frazë ose paragraf që do të jetë i dallueshëm dhe do të na bëjë t'i kushtojmë vëmendje. Nëse kjo ndodh, unë shpresoj se ne do ta shkruajmë atë dhe do të mendojmë rreth tij derisa të kemi thellësinë e kuptimit të tij dhe ta kemi bërë atë pjesë të jetës sonë.”

Presidenti Gordon B. Hinckley (1910–2008), “An Humble and a Contrite Heart”, Liahona, janar 2001, f. 103.

tyre të plotë. Sa herë që studioni, mbajini shënim njohuritë e reja që merrni.

Veproni sipas asaj që mësoni. Nëse i studioni bisedat plot lutje, ju do të shihni se si zbatohen mesazhet në jetën tuaj. Ju mund të mësoni se si të bëni ndryshime kuptimplote duke bërë pyetje si: Çfarë dëshiron Zoti që unë të bëj me atë që mësoj? Dhe: Çfarë kam mësuar që do të më ndihmojë në familje, në punë ose në thirrjen time në Kishë? Shkruajini përshtypjet në mënyrë që të mos i harroni. Nëse e bëni këtë, ju do të jeni të frymëzuar për t'i vënë në jetë mësimet dhe do të merrni bekimet e premtuara.

Konferenca e përgjithshme është koha kur Zoti ju zbulon vullnetin e Tij nëpërmjet shërbëtorëve të Tij. Presidenti Spenser W. Kimball (1895–1985) dha mësim mbi bisedat e konferencave: “Asnjë libër përveç veprave standarde të Kishës nuk duhet të ketë një vend të tillë të rëndësishëm në raftet e bibliotekës tuaj personale – jo për cilësinë dhe bindshmërinë e shkrimit, por për konceptet që tregojnë rrugën drejt jetës së përjetshme”⁵. ■

SHËNIME

1. Harold B. Lee, në Conference Report, prill 1946, f. 68.
2. Ezra Taft Benson, “Come unto Christ, and Be Perfected in Him”, *Ensign*, maj 1988, f. 84.
3. Tomas S. Monson, “Derisa Të Takohemi Përsëri”, *Liahona*, nëntor 2008, 106.
4. David A. Bednar, “Seek Learning by Faith”, *Liahona*, shtator 2007, f. 17, 20.
5. Spenser W. Kimball, *In the World but Not of It*, Brigham Young University Speeches of the Year (14 maj 1968), f. 3.

shkruani një përmbledhje që shpjegon idenë kryesore të paraqitur në çdo paragraf.

- **Përcaktoni elementë të ndryshëm brenda bisedës.** Vini re gjëra të tilla si: doktrina, shkrime të shenjta, histori, paralajmërime, lista, dëshmi, ftesa për të vepruar dhe bekime të premtuara për bindje ndaj këshillës.
- **Studiojeni bisedën më shumë se një herë.** Është e domosdoshme t'i studioni të vërtetat e ungjillit më shumë se një herë për të kapur kuptimin dhe domethënien e



Për të lexuar, parë ose dëgjuar fjalimet e konferencës së përgjithshme, vizitoni conference.lds.org.





NË FUQINË E ZOTIT

“Me besim në Zotin Jezu Krisht dhe bindje ndaj ungjillit të Tij, duke u përmirësuar hap pas hapi ndërsa ecim, duke u lutur për forcë, duke përmirësuar qëndrimet dhe qëllimet tona, ne do ta gjejmë veten me sukses në vathën e Bariut të Mirë. Kjo do të kërkojë disiplinë e trajnim dhe punë e forcë. Por sikurse tha Apostulli Pal: ‘Unë mund të bëj gjithçka me anë të Krishtit që më forcon’ (Filipianëve 4:13).”

Presidenti Howard W. Hunter (1907–1995), “Developing Spirituality”, *Ensign*, maj 1979, f. 26.

MAHNITSHËM Hiri

Nga Kristën Nikol Kardon

Unë varem nga hiri i Jezu Krishtit çdo ditë.

“Në mbledhjet tona të Kishës, ne nuk flasim shpesh për hirin”, tha mësuesi im i fesë në Universitetin “Brigam Jang”, “por ne, meqënëse jemi anëtarë të Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme, *vërtet* besojmë në hirin.”

Në të vërtetë, mua nuk më kujtohej ndonjë mësim i Të Rejave ose i Shkollës të së Dielës mbi hirin, por m’u kujtua kori i shkollës time të mesme duke kënduar “Amazing Grace” [“Hiri i Mahnitshëm”].

Hiri i mahnitshëm! (Sa i ëmbël tingulli!)

Ai shpëtoi një qyqar si unë!

Dikur i humbur isha, por tani jo më;

I verbër isha, por tani shoh.¹

“Hiri është fuqia e Perëndisë nga Shlyerja e Jezu Krishtit”, shpjegoi mësuesi im. “Unë e ndaj hirin në katër fuqi: ringjallje, shëlbim, shërim dhe forcim.” Ai vazhdoi të shpjegonte secilën fuqi, por mendja ime u kthye sërish te kujtimet e mia.

Dikur, i njëjti kor i shkollës së mesme udhëtoi për në Kaliforni të SHBA-së

për të konkurruar në një konkurs muzikor. Vetëm pak para nisjes unë u sëmura dhe dhembja e grykës paracaktoi se unë nuk do isha në gjendje të këndoja me korin tim në konkurs – ose, nëse do të këndoja, unë do të kisha kënduar keq e me dhembje. Unë i kërkoja atit tim një bekim priftërie dhe e kalova ditën vijuese duke u lutur për shërim.

Ndërsa këndova “Hiri i Mahnitshëm” me fytin plotësisht të shëruar në konkurs, mbase unë nuk kuptova plotësisht në atë kohë, se po këndoja pikërisht për atë fuqi që më shëroi vetëm një ditë më parë. Shlyerja e Shpëtimtarit më kishte bekuar atë ditë; hiri i Tij ishte burimi i shërimit tim.

“Dhe ai do të shkojë përpara, duke vuaritur dhimbje dhe hidhërimi dhe tundime të çdo lloji; dhe kjo, që të plotësohet fjala që thotë se ai do të marrë përsipër dhembjet dhe sëmundjet e popullit të tij” (Alma 7:11).

Pas shkollës së mesme, sikurse shumë studentë të vitit të parë, unë isha e hutuar nga lëndët e universitetit dhe sfidat e të jetuarit njëkohësisht larg nga shtëpia por



edhe me pesë shoqe dhome.

Kjo ndodhi kur unë mësova të kuptoja fuqinë forcuese dhe ndihmuese të hirit të Krishtit. I kaloja ditët duke punuar dhe studiuar, por varesha nga lutjet e përditshme në të cilat i lutesha Atit Qiellor për aftësi që të përmbushja detyrat e nevojshme. Ndërsa viti shkollor vazhonte, unë zbulova për çudinë time se me fuqinë forcuese dhe ndihmuese të Shlyerjes së Krishtit, unë jo vetëm që mund të punoja mirë, por pa vështirësi.

“Unë mund të bëjë gjithçka me anë të Krishtit që më forcon” (Filipianëve 4:13).

Edhe pse më ka mbetur t'i provoj dy aspektet e tjera të hirit të Tij – ringjalljen dhe plotësinë e shëlbimit – unë ende çdo ditë varem nga Shlyerja e Jezu Krishtit. Hiri, fuqia e Perëndisë nga Shlyerja e Jezu Krishtit, më ka shëruar dhe forcuar. Ndërkohë që përpiqem t'u bindem urdhërimeve të Perëndisë dhe të ndjek vullnetin e Tij, unë marr ndihmë qiellore të jashtëzakonshme që tejkalon vetë aftësinë time.

“Ne shpëtohem nëpërmjet hirit, pas gjithçkaje që ne mund të bëjmë” (2 Nefi 25:23). ■

SHËNIM

1. John Newton, “Amazing Grace”, *Olney Hymns* (1779), nr. 41.

SI NDIKON HIRI I ZOTIT NË JETËN TONË?

Plaku Dejvid A. Bednar, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, ndihmon në përgjigjen e kësaj pyetjeje në “Shlyerja dhe Udhëtimi i Vdekshmërisë” në këtë botim në faqen 12:

- “Zoti dëshiron, nëpërmjet Shlyerjes së Tij dhe me anë të fuqisë së Frymës së Shenjtë, të jetojë brenda nesh – jo vetëm për të na drejtuar, por edhe për të na dhënë forcë.”
- “Vullneti individual, vendosmëria dhe nxitja vetjake, planifikimi i efektshëm dhe vendosja e qëllimeve janë të nevojshme, por në fund të fundit të pamjaftueshme që ne ta përfundojmë ngadhënjimtarë këtë udhëtim të vdekshëm. Me të vërtetë, ne duhet të mbështetemi te ‘merit[at], dhe mëshira dhe hiri i Mesias së Shenjtë’ (2 Nefi 2:8).”
- “Fuqia ndihmuese e Shlyerjes na forcon ne për të bërë mirë e për të qenë të mirë dhe për të shërbyer përtej dëshirës sonë vetjake dhe aftësive të zakonshme.”

Merrni parasysh të shkruani në ditarin tuaj dhe t'i tregoni familjes suaj rreth kohëve kur keni ndier hirin e Zotit t'ju shëronte, ndihmonte ose forconte.



**Nga Plaku
Dejvid A. Bednar**

i Kuorumit të
Dymbëdhjetë Apostujve

Synimi kryesor i ungjillit të Shpëtimtarit është përmbledhur shkurtimisht nga Presidenti Dejvid O. Mek-Kei (1873–1970): “Qëllimi i ungjillit është . . . t’i bëjë njerëzit e këqij të mirë dhe njerëzit e mirë më të mirë, dhe të ndryshojë natyrën njerëzore”¹. Pra, udhëtimi i vdekshmërisë do të thotë të përparosh nga i keq, në i mirë, në më i mirë dhe të përjetosh

Shlyerja

DHE UDHËTIMI I VDEKSHMËRISË

Fuqia ndihmuese e Shlyerjes na forcon ne për të bërë e për të qenë të mirë dhe për të shërbyer përtej dëshirës sonë vetjake dhe aftësive të zakonshme.

ndryshimin e madh të zemrës – që të ndryshojmë karakterin tonë të rënë (shih Mosia 5:2).

Libri i Mormonit është manuali ynë i udhëzimeve ndërsa udhëtojmë në shtegun nga të qenit i keq, në të qenit i mirë, në të qenit më i mirë dhe luftojmë për t’i ndryshuar zemrat tona. Mbreti Beniamin na jep mësim rreth udhëtimit të vdekshmërisë dhe rolit të Shlyerjes në përmbushjen me sukses të atij udhëtimi: “Pasi njeriu i natyrshëm është një armik ndaj Perëndisë dhe ka qenë që nga rënia e Adamit dhe do të jetë gjithmonë e përgjithmonë, nëse ai nuk dëgjon thirrjet e Frymës së Shenjtë dhe nuk zhvesh njeriun e natyrshëm dhe nuk bëhet një shenjtor nëpërmjet shlyerjes së Krishtit Zot” (Mosia 3:19; theksimet e shtuara).

Ju tërheq vëmendjen me dy fraza të veçanta. Së pari – “zhvesh njeriun e natyrshëm”. Udhëtimi nga të qenit i keq në të qenit i mirë është procesi i zhveshjes së burrit ose gruas së natyrshe tek secili prej nesh. Në jetën tonë ne të gjithë tundohemi nga dëshirat e mishit. Shumë elemente me të cilat trupat tanë janë krijuar janë për nga natyra të rëna dhe gjithmonë të ndjeshëm për t’u tërhequr ndaj mëkatit, korrupsionit dhe vdekjes. Por ne mund ta rrisim aftësinë



tonë për t'i mposhtur dëshirat e mishit dhe tundimet “nëpërmjet shlyerjes së Krishtit”. Kur ne bëjmë gabime, kur bëjmë shkelje dhe mëkatojmë, ne mund të pendohemi dhe të bëhemi të pastër me anë të fuqisë shlyese të Shlyerjes së Jezu Krishtit.

Së dyti – “bëhet një shenjtor”. Kjo frazë përshkruan vazhdimin dhe fazën e dytë të udhëtimit të jetës për t'i bërë “njerëzit e mirë më të mirë” ose, me fjalë të tjera, për t'u bërë më shumë si një shenjtor. Kjo pjesë e dytë e udhëtimit, ky proces i bërjes nga i mirë në më i mirë, është një temë rreth së cilës ne nuk studiojmë ose japin mësim shumë shpesh dhe nuk e kuptojmë siç duhet.

Dyshoj se shumë anëtarë të Kishës kanë më shumë njohuri për natyrën e fuqisë shlyese dhe pastruese të Shlyerjes sesa për fuqinë forcuese dhe ndihmuese. Kjo është një gjë që të dini se Jezu Krishti erdhi në tokë për të *vdekur* për ne – kjo është një pjesë e rëndësishme e doktrinës së Krishtit. Por gjithashtu ne duhet të vlerësojmë se Zoti dëshiron, me anë të Shlyerjes së Tij dhe nëpërmjet fuqisë së Frymës së Shenjtë, të *jetojë* te ne – jo vetëm për të na drejtuar, por edhe për të na dhënë forcë.

Shumica prej nesh e di se kur bëjmë gjëra të gabuara, ne kemi nevojë për ndihmë për të kapërcyer pasojat e mëkatit në jetën tonë. Shpëtimtari e ka paguar çmimin dhe bëri të mundur për ne që të bëhemi të pastër me anë të fuqisë së Tij shlyese. Shumë prej nesh e kuptojnë qartësisht se Shlyerja është për mëkatarët. Megjithatë, nuk jam aq i sigurt se, ne e dimë dhe kuptojmë se Shlyerja është edhe për shenjtorët – për burrat dhe gratë e mira që janë të bindur, të denjë e të ndërgjegjshëm dhe që po përpiqen për t'u bërë më të mirë dhe për të shërbyer me më shumë besnikëri. Ne gabimisht mund të besojmë se duhet ta bëjmë udhëtimin, nga të bërit i mirë në më i mirë, dhe të bëhemi një shenjtor, plotësisht vetë, përmes fuqisë e kurajës mendore, forcës së vullnetit e të disiplinës dhe me aftësitë tona dukshëm të kufizuara.

Ungjilli i Shpëtimtarit nuk është thjesht për të shmangur gjërat e këqija në jetën tonë; para së gjithash është edhe për të bërë mirë e për t'u bërë i mirë. Dhe Shlyerja na ofron ndihmë për t'i

mposhtur dhe shmangur gjërat e këqija dhe për të bërë mirë e për t'u bërë të mirë. Ndihma nga Shpëtimtari është e disponueshme për të gjithë udhëtimin e vdekshmërisë – nga të qenit i keq në të qenit i mirë e më i mirë dhe për të ndryshuar karakterin tonë.

Nuk jam duke sugjeruar se fuqitë shlyese dhe ndihmuese të Shlyerjes janë të ndara e të ndryshme nga njëra-tjetra. Përkundrazi, këto dy dimensione të Shlyerjes janë të lidhura dhe plotësuese; të dyja ato duhet të jenë vepruese gjatë gjithë fazave të udhëtimit të jetës. Dhe është përjetësisht e rëndësishme për të gjithë ne që të pranojmë se *të dyja* këto elemente thelbësore të udhëtimit të vdekshmërisë – edhe zhveshja e njeriut të natyreshëm dhe të bërit një shenjtor, edhe mposhtja e njeriut të keq dhe të bërit i mirë – përmbushen nëpërmjet fuqisë së Shlyerjes. Vullneti individual, vendosmëria dhe nxitja personale, planifikimi i efektshëm dhe vendosja e qëllimeve janë të nevojshme, por në fund të fundit të pamjaftueshme që ne ta përfundojmë ngadhënjimtarë këtë udhëtim të vdekshëm. Me të vërtetë, ne duhet të mbështemi te “merit[at], dhe mëshira dhe hiri i Mesias së Shenjtë” (2 Nefi 2:8).

Hiri dhe Fuqia Ndhmuese e Shlyerjes

Tek “Udhëzuesi për Shkrimet e Shenjta” ne mësojmë se fjala *hir* shpesh përdoret në shkrimet e shenjta për të treguar fuqinë ndihmuese:

“[Hiri është] një fjalë që përsëritet shpesh në Dhiatën e Re, sidomos në shkrimet e Palit. Ideja kryesore e fjalës është *metodë hyjnore ndihme ose force*, dhënë përmes mëshirës bujare dhe dashurisë së Jezu Krishtit.

Është me anë të hirit të Zotit Jezus, që u bë e mundur përmes sakrificës së Tij shlyese, që njerëzimi do të ngrihet në pavdekësi, çdo person duke marrë trupin e tij nga varri në një gjendje të jetës së përjetshme. *Në të njëjtën mënyrë, është me anë të hirit të Zotit që individët, nëpërmjet besimit në shlyerjen e Jezu Krishtit dhe pendimit nga mëkatet e tyre, marrin forcë dhe ndihmë për të bërë vepra të mira që përndryshe nuk do ishin në gjendje t'i*

mbanin nëse liheshin vetëm në përpjekjet e tyre. Ky hir është një fuqi ndihmuese që i lejon burrat dhe gratë të sigurojnë jetën e përjetshme dhe ekzaltimin pasi të kenë harxhuar përpjekjet e tyre më të mira.”²

Hiri është ndihma hyjnore ose mbështetja qiellore që i duhet dëshpërimisht secilit prej nesh për t'u kualifikuar për mbretërinë



Nefi nuk u lut që të ndryshonin rrethanat e tij. Në vend të kësaj, ai u lut për forcë për të ndryshuar rrethanat e tij.

çelestiale. Prandaj, fuqia ndihmuese e Shlyerjes na forcon ne për të bërë mirë e për të qenë të mirë dhe për të shërbyer përtej dëshirës tonë vetjake dhe aftësive të zakonshme.

Në studimin tim vetjak, unë shpesh shtoj termin “fuqi ndihmuese” kurdoherë që ndesh fjalën *hir*. Për shembull, merrni parasysh këtë varg të cilin të gjithë e kemi hasur: “Ne e dimë se ne shpëtohemi nëpërmjet hirit, pas gjithçkaje që ne mund të bëjmë” (2 Nefi 25:23). Unë besoj se ne mund të mësojmë më shumë rreth këtij aspekti jetësor të Shlyerjes nëse do të shtojmë “fuqinë ndihmuese dhe

forcuese” çdo herë që gjejmë fjalën *hir* në shkrimet e shenjta.

Ilustrime dhe Nënkuptime

Udhëtimi i vdekshmërisë është të bëhemi nga i keq, në i mirë, në më i mirë dhe të ndryshojmë karakterin tonë. Libri i Mormonit është i mbushur me shembuj dishepujsh dhe apostujsh që e dinin, e kuptuan dhe u shndërruan nga fuqia ndihmuese e Shlyerjes në bërjen e atij udhëtimi. Kur ne e kuptojmë gradualisht më mirë këtë fuqi të shenjtë, perspektiva jonë mbi ungjillin do të zgjerohet dhe pasurohet në masë të madhe. Një perspektivë e tillë do të na ndryshojë në mënyra të mrekullueshme.

Nefi është një shembull i atij që e njohu, e kuptoi dhe u mbështet mbi fuqinë ndihmuese të Shpëtimtarit. Kujtoni se bijtë e Lehit u kthyen në Jerusalem për të marrë Ishmaelin dhe familjen e tij në kauzën e tyre. Lamani dhe të tjerët në udhëtimin në grup me Nefin nga Jerusalemi përsëri për në vendin e shkretëtirë rebeluan, dhe Nefi i paralajmëroi

vëllezërit e tij të kishin besim në Zot. Ishte në këtë pikë të udhëtimit të tyre që vëllezërit e Nefit e lidhën atë me litarë dhe planifikuan vdekjen e tij. Ju lutem, kujtoni lutjen e Nefit: “O Zot, sipas besimit tim që është te ti, a do të më shpëtosh nga duart e vëllezërve të mi; po, madje më *jep fuqinë që t'i këpus këta rripa* me të cilët jam i lidhur” (1 Nefi 7:17; theksimet e shtuara).

A e dini se në çfarë mënyre do të isha lutur nëse do të isha lidhur nga vëllezërit e mi? “Të lutem më nxirr nga kjo bela TANI!” Është veçanërisht interesante për mua se Nefi nuk u lut që të ndryshonin rrethanat e tij. Në vend të

kësaj, ai u lut për forcë për të ndryshuar rrethanat e tij. Dhe unë besoj se ai u lut në këtë mënyrë pikërisht sepse e dinte, e kuptoi dhe e kishte përjetuar fuqinë ndihmuese të Shlyerjes.

Nuk besoj se rripat me të cilat ishte lidhur Nefi thjesht ranë nga duart dhe kyçet e tij në mënyrë magjike. Përkundrazi, unë dyshoj se ai u bekua si me forcën e këmbënguljes edhe atë personale përtej aftësisë së tij të zakonshme, që ai më pas “në fuqinë e Zotit” (Mosia 9:17) veproi, zgjidhi e tërhoqi litarët dhe, më në fund e me kuptimin e plotë të fjalës, që në gjendje që t’i këpuste rripat.

Nënkuptimi i kësaj ngjarjeje për secilin prej nesh është i thjeshtë. Kur unë dhe ju arrijmë ta kuptojmë dhe ta përdorim fuqinë ndihmuese të Shlyerjes në jetën tonë vetjake, ne do të lutemi dhe do të kërkojmë për forcë për të ndryshuar rrethanat tona në vend që të lutemi që rrethanat tona të ndryshohen. Ne do të bëhemi faktorë që veprojnë në vend që të bëhemi objekte që kanë pësuar (shih 2 Nefi 2:14).

Merrni parasysh shembullin në Librin e Mormonit kur Alma dhe njerëzit i tij u persekutuan nga Amuloni. Zëri i Zotit erdhi te këta njerëz të mirë në pikëllimin e tyre dhe u tregoi:

“Dhe unë do t’ju lehtësoj gjithashtu barrat që ju janë vënë mbi shpatulla, që ju të mos i ndjeni në shpinat tuaja. . . .

Dhe tani ndodhi që barrat që iu vunë Almës dhe vëllezërve të tij u lehtësuan; po, *Zoti i forcoi ata* që të mund të duronin barrat e tyre me lehtësi dhe ata iu nënshtuan me gëzim dhe me durim gjithë vullnetit të Zotit” (Mosia 24:14–15; theksimet e shtuara).

Çfarë kishte ndryshuar në këtë situatë? Nuk ishte barra që ndryshoi; sfidat dhe vështirësitë

e persekutimit nuk u hoqën menjëherë nga njerëzit. Por Alma dhe pasuesit e tij u forcuan dhe aftësia e forca e tyre e rritur i bënë barrat që ata mbajtën më të lehta. Këta njerëz të mirë ishin bërë të fuqishëm përmes Shlyerjes për të *vepruar* në pozicionin e agjentëve dhe për të *ndikuar* rrethanat e tyre. Dhe “në fuqinë e Zotit” Alma dhe njerëzit i tij më pas u drejtuan



shëndoshë e mirë në tokën e Zarahemlës.

Ju me të drejtë mund të jeni duke pyetur veten: “Çfarë e bën historinë me Almën dhe njerëzit e tij një shembull të fuqisë ndihmuese të Shlyerjes?” Përgjigjja gjendet në krahasimin e vargjeve Mosia 3:19 dhe Mosia 24:15.

“Dhe nuk zhvesh njeriun e natyrshëm dhe nuk bëhet një shenjtor nëpërmjet shlyerjes së Krishtit Zot, dhe *nuk bëhet si një fëmijë, i nënshtuar, i bindur, i përlur, i duruar, plot me dashuri, i gatshëm t’u nënshtrohet të gjitha gjërave që Zoti* i sheh të përshtatshme të shkaktojë mbi të, madje sikurse një fëmijë i nënshtrohet atit të tij” (Mosia 3:19; theksimet e shtuara).

Zëri i Zotit erdhi te Alma dhe njerëzit e tij në hidhërimin e tyre dhe u tregoi: “Dhe unë do t’ju lehtësoj gjithashtu barrat që ju janë vënë mbi shpatulla, që ju të mos i ndieni në shpinat tuaja”.

Ndërsa përparojmë në udhëtimin e vdekshmërisë nga të qenit i keq, në të qenit i mirë, në më i mirë, ndërsa zhveshim burrin dhe gruan e natyrshme në secilin prej nesh, dhe ndërsa përpiqemi për t'u bërë shenjtore e ndryshojmë karakterin tonë, atëherë vetitë e caktuara në këtë varg duhet të përshkruajnë llojin e njeriut që unë dhe ju po bëhemi gjithnjë e më shumë. Ne do të bëhemi më shumë si fëmija, më të bindur, më të duruar dhe më të gatshëm për t'u nënshtruar.

Tani krahasojini këto karakteristika në Mosia 3:19 me ato të përdorura për të përshkruar Almën dhe njerëzit e tij: “Dhe ata iu nënshtruan me gëzim dhe me durim gjithë vullnetit të Zotit” (Mosia 24:15; theksimet e shtuara).

Unë gjej krahasime midis vetive të përshkuara në këto vargje shumë të dukshme dhe një tregues se njerëzit e mirë të Almës po bëheshin njerëz më të mirë nëpërmjet fuqisë ndihmuese të Shlyerjes së Krishtit Zotit.

Kujtoni historinë e Almës dhe Amulekut që e përmban Alma 14. Në këtë ngjarje shumë shenjtore besnikë u dogjën në zjarr dhe këta dy shërbëtorë të Zotit u burgosën dhe u qëlluan. Merrni parasysh këtë kërkesë të bërë nga Alma kur u lut në burg: “O Zot na jep fuqi sipas besimit tonë që është në Krisht, madje deri në çlirim” (Alma 14:26; theksimet e shtuara).

Përsëri këtu, ne shohim kuptueshmërinë dhe mirëbesimin e Almës në fuqinë ndihmuese të Shlyerjes të treguar në kërkesën e tij. Dhe vini re përfundimin e kësaj lutjeje:

“Dhe ata [Alma dhe Amuleku] këputën litarët me të cilët ishin lidhur; dhe kur njerëzit e panë këtë, ata filluan t'ia mbathin, pasi frika e shkatërrimit kishte ardhur mbi ta. . . .

Dhe Alma dhe Amuleku dolën nga burgu pa pësuar dëm; pasi Zoti u dha atyre fuqi, sipas besimit të tyre që ishte në Krisht” (Alma 14:26, 28; theksimet e shtuara).

Edhe një herë fuqia ndihmuese është e dukshme ndërsa njerëzit e mirë luftojnë kundër të keqes dhe përpiqen për t'u bërë më të mirë dhe për të shërbyer me efektshmëri “në fuqinë e Zotit”.

Një shembull tjetër nga Libri i Mormonit është udhëzues. Në Alma 31, Alma kryeson një mision për të rifituar zoramitet që braktisën fenë, të cilët, pas ndërtimit të Rameumptomit të tyre, ofruan një lutje që ishte plot me krenari.

Vini re lutjen për forcë në lutjen personale të Almës: “O Zot, më jep mundësi, që të kem fuqi, që të vuaj me durim këto hidhërimet që do të vijnë mbi mua, për shkak të paudhësisë së këtij populli” (Alma 31:31; theksimet e shtuara).

Alma gjithashtu u lut që shokët e tij të misionit të merrnin një bekim të ngjashëm: “Jepu mundësi, që ata të kenë fuqi, që të mund të durojnë hidhërimet e tyre që do të vijnë mbi ta për shkak të paudhësisë të këtij populli” (Alma 31:33; theksimet e shtuara).

Alma nuk u lut që t'i hiqeshin hidhërimet. Ai e dinte se ishte një veprues për Zotin dhe ai u lut për fuqi që të vepronte e të ndikonte në gjendjen e tij.

Pika më e rëndësishme e këtij shembulli ndodhet në vargun e fundit të Alma 31: “[Zoti] u dha atyre fuqi që të mos vuanin nga ndonjë pikëllim, por që çdo gjë të përfshihej vetëm në gëzimin për Krishtin. Tani, kjo ishte sipas lutjes së Almës; dhe kjo, sepse ai u lut me besim” (vargu 38; theksimet e shtuara).

Hidhërimet nuk iu hoqën. Por Alma dhe shokët e tij misionarë u forcuan dhe u bekuan nëpërmjet fuqisë ndihmuese të Shlyerjes që të mos “vuanin nga ndonjë pikëllim, por që çdo gjë të përfshihej vetëm në gëzimin për Krishtin”. Çfarë bekimi i mrekullueshëm! Dhe çfarë mësimi që secili prej nesh duhet të mësojë.

Shembuj të fuqisë ndihmuese nuk gjenden vetëm në shkrimet e shenjta. Daniel W. Xhons u lind në 1830-ën në Misuri dhe ai u bashkua me Kishën në Kaliforni në vitin 1851. Në 1856-ën ai mori pjesë në shpëtimin e kompanive të karrocave të dorës që ishin bllokuar në Uajoming nga stuhitë e rënda të dëborës. Pasi grupi i shpëtimit i kishte gjetur shenjtoret që vuanin, ofroi atë mbështetje të menjëhershme që mundi, dhe bëri përgatitjet për të sëmuret dhe të dobëtit që do të çoheshin në Solt-Lejk-Siti, Danieli dhe disa të rinj të tjerë dolën vullnetarë për të qëndruar dhe për të ruajtur zotërimet e kompanisë. Ushqimi dhe furnizimet

e lëna me Danielin dhe shokët e tij ishin të pakta dhe u përdorën me shpejtësi. Citati i mëposhtëm nga ditari personal i Daniel Xhonsit përshkruan ngjarjet që pasuan.

“Kafshët për gjueti shpejt u pakësuan kaq shumë sa nuk mund të vrisnim gjë. Ne e hëngrëm të gjithë mishin e paktë; dikujt do t’i shtohet uria duke e ngrënë atë. Së fundmi gjithçka mbaroi, s’kishte mbetur asgjë përveç lëkurëve të kafshëve. Ne provuam t’i hanim ato. Shumë ishte gatuar dhe ngrënë pa erëza dhe kjo e sëmuri të gjithë kompaninë. . . .

Situata dukej e pashpresë, por asgjë nuk mbeti përveç lëkurëve të gjalla e të pakta të kafshëve, të marra nga bagëtitë e uritura. Ne i kërkuam Zotit të na drejtonte se çfarë të bënim. Vëllezërit nuk u ankuan, por ndien se duhet të besonin në Perëndi. . . . Më në fund, unë pata përshtypjen se si t’i rregulloja gjërat dhe i dhashë këshillë kompanisë, duke i thënë se si ta gatuanim atë; që ta digjinin dhe t’ia shkullnim qimet; kjo kishte për qëllim që t’ia hiqte dhe pastronte shijen e keqe që i jepte gatimi me ujë të nxehtë ose avull. Pas djegies, e zienim për një orë me shumë ujë; duke e derdhur ujin që kishte nxjerrë gjithë zamkën, pastaj e lanim dhe e nxirrnim plotësisht lëkurën e kafshës, duke e larë me ujë të ftohtë, më pas e zienim në një pelte dhe e linim të ftohej, më pas e hanim me pak sheqer të spërkatur në të. Ky ishte mundim i madh, por nuk kishim ç’të bënim tjetër dhe ishte më mirë sesa të ngordhnim urie.

Ne i kërkuam Zotit që të bekonte stomakun tonë dhe *që ta ndryshonte në mënyrë që të mësoheshim me këtë ushqim*. . . . Dukej tashmë sikur të gjithëve u shijonte ushqimi. Ne rezistuaam tre ditë pa ngrënë përpara se të bëhej kjo përpjekje e dytë. Ne e shijuam ushqimin e shijshëm për rreth gjashtë javë.”³

Në këto rrethana unë me siguri do të isha lutur për të ngrënë diçka tjetër: “Atë Qiellor, të lutem më dërgo një thëllëzë ose një buall”. Kishte gjasa që të mos më kishte shkuar në mendje të lutesha që stomaku im të forcohej dhe të përshtatej me ushqimin që kishim. Çfarë dinte Daniel W. Xhonsi? Ai dinte në lidhje me fuqinë ndihmuese të

Shlyerjes së Jezu Krishtit. Ai nuk u lut që rrethanat e tij të ndryshonin. Ai u lut që të forcohej për t’u përballur me rrethanat e tij. Ashtu siç u forcuan Alma dhe njerëzit i tij, Amuleku dhe Nefi, Daniel W. Xhonsi pati largpamësinë shpirtërore për të ditur se çfarë të kërkonte në atë lutje.

Fuqia ndihmuese e Shlyerjes së Krishtit na forcon për të bërë gjëra që ne nuk do t’i bënim kurrë me forcat tona. Ndonjëherë unë pyes veten a mësojmë ne ndonjëherë në botën e sotme të rehatisë – në botën tonë të furrave ngrohëse dhe telefonave celularë e makinave me ajër të kondicionuar dhe shtëpive të rehatshme – t’i njohim varësitë tona të përditshme në fuqinë ndihmuese të Shlyerjes.

Motra Bednar është një grua shumë besnike dhe e urtë, dhe kam marrë mësim të rëndësishme për fuqinë forcuese nga shembulli i saj i qetë. Ekam parë atë të këmbëngulë gjatë sëmundjes së vazhdueshme e të shpeshtë në mëngjes – me plot kuptimin e fjalës e sëmurë çdo ditë për tetë muaj – gjatë secilës nga tre shtatzënitë e saj. Së bashku luteshim që ajo të bekohej, por ajo sfidë nuk iu hoq kurrë. Përkundrazi, asaj iu mundësua të bënte fizikisht atë ç’ka ajo nuk mund ta bënte me fuqinë e vet. Përgjatë viteve kam parë gjithashtu, se si ajo është forcuar që të përballonte talljen dhe përbuzjen që vjen nga një shoqëri e botës kur një grua shenjto e ditëve të mëvonshme i vë veshin këshillës profetike dhe e bën familjen dhe edukimin e fëmijëve prioritetet e saj më të larta. Unë e falënderoj dhe jam mirënjohës për Suzanën që më ka ndihmuar për të mësuar mësim të tilla të paçmueshme.

Shpëtimtari e Di dhe e Kupton

Te Alma kapitulli 7 ne mësojmë se si dhe përse Shpëtimtari është në gjendje të sigurojë fuqinë ndihmuese:

“Dhe ai do të shkojë përpara, duke vuajtur *dhimbe* dhe *hidhërime* dhe *tundime* të çdo lloji; dhe kjo, që të plotësohet fjala që thotë se ai do të marrë përsipër *dhembjet* dhe *sëmundjet* e popullit të tij.

Dhe ai do të marrë përsipër vdekjen që ai të mund të zgjidhë rripat e vdekjes, që e lidhin popullin e tij; dhe ai do të marrë përsipër *dobësitë* e tyre, që zemra e tij të mund të mbushet me mëshirë, sipas mishit, që ai të mund të dijë, sipas mishit, se si të ndihmojë popullin e tij sipas dobësive të tyre” (Alma 7:11–12; theksimet e shtuara).



Nuk ka dhembje fizike, ankth të shpirtit, vuajtje të shpirtit, sëmundje ose dobësi që unë dhe ju do të përjetojmë ndonjëherë gjatë udhëtimit të vdekshëm që nuk e përjetoj më parë Shpëtimtari.

Shpëtimtari ka vuajtur jo vetëm për paudhësitë tona, por edhe për pabarazinë, padrejtësinë, dhembjen, vuajtjen dhe mundimet emocionale që aq shpesh na rrethojnë. Nuk ka dhembje fizike, ankth të shpirtit, vuajtje të shpirtit, sëmundje ose dobësi që unë dhe ju do të përjetojmë ndonjëherë gjatë udhëtimit të vdekshëm që nuk e përjetoj më parë Shpëtimtari. Unë dhe ju, kur ndihemi të dobët, mund të bërtasim me hidhërim: “Askush nuk e kupton. Askush nuk e di.” Ndoshta, asnjë qenie njerëzore nuk e di. Por Biri i Perëndisë e di dhe e kupton përsosmërisht, sepse Ai i ndieu dhe i mbajti barrat tona përpara se ne ta

bënim ndonjëherë. Dhe për shkak se Ai pagoi çmimin përfundimtar dhe e mbajti atë barrë, Ai mund të na kuptojë plotësisht dhe mund të shtrijë ndaj nesh krahun e Tij të mëshirës në shumë faza të jetës sonë. Ai mund të arrijë, mund të na prekë emocionalisht, të na ndihmojë – të vrapojë vërtet drejt nesh – dhe të na forcojë që të jemi më shumë sesa mund të jemi ndonjëherë dhe të na ndihmojë të bëjmë atë që nuk do mund ta bënim kurrë duke u mbështetur vetëm mbi vetë fuqinë tonë.

“Ejani tek unë, o ju të gjithë të munduar dhe të rënduar, dhe unë do t’ju jap çlodhje.

Merrni mbi vete zgjedhën time dhe mësoni nga unë, sepse unë jam zemërbutë dhe i përlur nga zemra; dhe ju do të gjeni prehje për shpirtat tuaj.

“Sepse zgjedha ime është e ëmbël dhe barra ime është e lehtë!” (Mateu 11:28–30)

Unë shpall dëshminë dhe vlerësimin tim për sakrificën e pafundme e të përjetshme të Zotit Jezu Krisht. E di se Shpëtimtari jeton. Unë e kam provuar edhe fuqinë e Tij shlyese edhe fuqinë

e Tij ndihmuese dhe unë dëshmoj se këto fuqi janë të vërteta dhe të disponueshme për secilin prej nesh. Në të vërtetë, “në fuqinë e Zotit” ne mund t’i bëjmë dhe t’i mposhtim të gjitha gjërat ndërsa shkojmë përpara në udhëtimin tonë të vdekshmërisë. ■

Nga një bisedë e takimit shpirtëror të dhënë në Universitetin “Brigam Jang” më 23 tetor 2001. Për tekstin origjinal në anglisht, vizitoni speeches.byu.edu.

SHËNIME

1. Shih Franklin D. Richards, në Conference Report, tetor 1965, f. 136–137; shih edhe David O. McKay, në Conference Report, prill 1954, f. 26.
2. “Udhëzuesi për Shkrimet e Shenjta”, “Hiri”; theksimet e shtuara.
3. Daniel W. Jones, *Forty Years among the Indians* (n.d.), f. 57–58.

Në mbarë botën, seminari është duke i sjellë të rinjtë si ju më pranë Jezu Krishtit.



Bekimet e SEMINARIT

Nga Britëni Biti

Revistat e Kishës

Ju nuk jeni vetëm në vendimin tuaj për të marrë pjesë në seminar. Kudo në botë, qindra e mijëra të rinj e bëjnë seminarin një pjesë të jetës së tyre, duke shkuar në klasat e tyre me autobus, kanoe, biçikletë ose madje dhe mjete të tjera. Disa të rinj zgjohen herët në mëngjes dhe udhëtojnë në distanca të gjata për të arritur në kohë, të tjerë e bëjnë udhëtimin në mbrëmje dhe të tjerë studiojnë në shtëpi për disa ditë të javës.

Marrja pjesë në seminar kërkon sakrificë, por të rinjtë në të gjithë botën po zbulojnë se ia vlen çdo përpjekje për të marrë pjesë në seminar. Dhe ata që marrin pjesë kanë diçka të përbashkët: përvoja e tyre e seminarit i sjell ata më afër Shpëtimtarit dhe Atit tonë Qiellor.

Marrja e Bekimeve të Premtuara

Përse seminari është kaq i rëndësishëm për ju? Disa nga arsyet përfshijnë këto premtime nga profetët dhe apostujt e ditëve të mëvonshme:

- Ai “bëhet një bekim nga Perëndia për shpëtimin e Izraelit modern në një periudhë shumë të vështirë [në historinë e botës]”¹.
- Ai “do t’ju përgatisë të përcillni mesazhin e ungjillit të rivendosur tek ata që keni rastin të takoni”².
- Ai do t’ju ndihmojë “të fitoni kuptimin thelbësor të së vërtetës”³.
- Seminari “ofron mundësi të mrekullueshme për të mësuar doktrina që do t’ju

bëjnë të lumtur. Ai ofron mundësi të mrekullueshme për shoqërimin me njerëz që ndajnë të njëjtin besim si ju.”⁴

- “Njohuria juaj për ungjillin do të rritet. Besimi juaj do të forcohet. Ju do të krijoni shoqëri dhe miqësi të mrekullueshme.”⁵
- “Ai sjell . . . rritjen shpirtërore, forcën morale për t’i rezistuar të keqes që është mbi të gjithë ne, si dhe rritjen e pamasë në të kuptuarin e ungjillit.”⁶
- Ai është “një nga përgatitjet më të mira për një mision”⁷.

Gjetja e Një Mënyre për të Marrë Pjesë

Vajtja në seminar shpesh do të thotë se do t’ju duhet të hiqni dorë nga diçka tjetër që ju e keni për zemër ta bëni, në mënyrë që të gjeni kohë për të marrë pjesë. Por është një sakrificë që ia vlen të bëhet. Elija Bugajong nga Filipine zgjodhi ta merrte atë vendim gjatë vitit të saj të fundit në shkollën e mesme. Gjatë gjithë shkollës së mesme, ajo kishte qenë gjithmonë e dyta në klasën e saj. Ajo ishte e vendosur që të zinte vendin e parë në vitin e parë të shkollës së lartë dhe madje kishte menduar të mos regjistrohej në seminarin ku kishte marrë pjesë në vitet e mëparshme, që të përmbushte qëllimin e saj.

Më pas një ditë mendimet e saj ndryshuan. “Unë [pashë] tryezën time të studimit”, thotë ajo. “Pashë një grumbull me libra pranë saj, shkrimet e shenjta së bashku me fletoren e shënimeve dhe manualin e seminarit. Thellë



NJË BEKIM ME PASOJA TË PËRJETSHME

“Shumë vite më parë kam pasur privilegjin të jepja mësim në një klasë seminari herët në mëngjes. Ora e mësimi mbahej nga ora 6:30 deri në 7:30 të mëngjesit çdo ditë të shkollës. Për dy vite kam parë studentë të përgjumur, të ngathët për të ecur për në klasë, duke e sfiduar mësuesin e tyre për t’i zgjuar ata nga gjumi. Pasi bëhej lutja dhe jepej një mendim frymëzues, unë shihja mendje të ndritura të zgjoheshin për të rritur njohuritë e tyre për shkrimet e shenjta. Pjesa më e vështirë e orës së mësimi ishte të përfundojë diskutimin në kohë për t’i dërguar ata në orët e tyre të rregullta të mësimi të shkollës së mesme. Ndërsa viti shkollor vazhdonte, unë pashë secilin nga studentët të fitonte siguri më të madhe, miqësi më të ngushta dhe një dëshmi në rritje për ungjillin.

Disa vite më parë unë isha në një dyqan ushqimor në qytet, jo shumë larg nga këtu, kur dëgjova dikë të më thërriste në emër. Unë u ktheva për të përshëndetur dy nga nxënësit e mi të mëparshëm të seminarit. Tani, ata ishin burra e grua. Ata më prezantuan me katër fëmijët e tyre të bukur. Ndërsa i takuam, u mahnita me numrin e shokëve të klasës së seminarit me të cilët ata ende kishin kontakte pas gjithë këtyre viteve. Ajo ishte një dëshmi e një lidhjeje të veçantë që ishte krijuar në atë klasë seminari shumë herët në mëngjes.”

Plaku L. Tom Perry, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, “Receive Truth”, *Ensign*, nëntor 1997, f. 62.

brenda pyeta veten: ‘Cila ka më shumë rëndësi?’”

Elija e gjeti përgjigjen e saj te Mateu 6:33: “Por para së gjithash kërkoni mbretërinë e Perëndisë dhe drejtësinë e tij dhe të gjitha këto gjëra do t’ju shtohen”. Ajo vendosi që të merrte pjesë në seminar me besnikëri dhe të gjente mënyra të tjera për të drejtpeshuar kohën e saj në mënyrë që të punonte në studimet e shkollës. Në fund të vitit, ajo u shpall velëdiktoriale [studentja me notat më të larta për atë vit] dhe madje fitoi një bursë universitare.

Spensër Daglas nga Alabama në SHBA, vendosi që të hiqte dorë nga disa ngjarje shoqërore në mënyrë që të përfitonte më shumë nga seminari. Dy vitet e para të seminarit, ai ngrihej në 4:00 të mëngjesit për të marrë pjesë, dhe dy vitet e fundit ai ngrihej në 5:00 të mëngjesit. Ai thotë: “Unë nuk mund të merrja pjesë në shumë aktivitete vonë në mbrëmje me miqtë e mi sepse duhet të isha herët në shtrat. Nëse nuk do të shkoja herët, nuk do të isha në gjendje të merrja pjesë plotësisht dhe të mësoja mëngjesin tjetër.” Për Spensërin, nuk ishte thjesht shfaqja në klasë, ishte edhe të qenit zgjuar e i përgatitur për të mësuar.

Plaku Dallin H. Ouks, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, dha mësim: “Thjesht se diçka është e mirë, nuk është një arsye e mjaftueshme për ta bërë. Numri i gjërave të mira që mund të bëjmë, e tejkalon shumë kohën në dispozicion për t’i kryer ato. Disa gjëra janë më të mira se vetëm mirë dhe këto janë gjërat që duhet të marrin vëmendje me përparësi

në jetën tonë.”⁸ Kjo është këshillë e rëndësishme për t’u kujtuar ndërsa vendosni ta bëni seminarin të rëndësishëm në kohën tuaj.

Përgatitja për Misione

Seminari shërben edhe si një përgatitje e madhe për punën misionare që ju do të bëni – si anëtarë misionarë sot dhe gjithashtu nëse shërbeni si një misionar me kohë të plotë në të ardhmen. Franko Huamen Kurinukui nga Peruja e di se studimi i shkrimeve të tij të shenjta në seminar e ka ndihmuar atë të përgatitet për misionin e tij.

Ai thotë se kjo përgatitje ia vlen, që të ngrihesh për seminarin në 4:00 të mëngjesit, të hipësh në kanoe kur muajt e përmbytjeve godasin zonën, dhe më pas të çash përmes baltës për të shkuar në klasë. Ai thotë: “Unë dua të përfundoj seminarin dhe të filloj klasat e institutit në mënyrë që të jem i përgatitur për mision. Unë do të vazhdoj të rritem në Kishë.” Seminari është i rëndësishëm për të, sepse ai mëson rreth shkrimeve të shenjta dhe mban në kujtesë vargje të rëndësishme, të cilat do ta ndihmojnë atë të jetë një misionar më i mirë.

Të Qenit i Bekuar në të Gjitha Aspektet e Jetës

Ndërsa të rinjtë në gjithë globin bëjnë përpjekje për të marrë pjesë në seminar, ata po marrin forcë në shumë më tepër sesa thjesht tek studimi i shkrimeve të shenjta. Kameron Lisni nga Anglia zbuloi se ishte i bekuar në të gjitha fushat e jetës së tij. “Seminari jo vetëm që të ndihmon

nga ana shpirtërore e gjërave, por edhe të ndihmon për shkollën dhe arsimimin”, tha Kameroni.

Ai thotë se “një fillim i shpejtë i ditës e bën trurin të punojë. Disa nga miqtë e mi thonë se ishin shumë të zënë për të marrë pjesë – epo, nuk është se do përsërisësh matematikën në orën 6:00 të mëngjesit, apo jo?” Ndërsa studioni, “Zoti do t’ju ndihmojë në provimet tuaja dhe, nëse shkoni në seminar, Ai do t’ju ndihmojë edhe më shumë”, thotë Kameroni.

Sigurisht, seminari gjithashtu e ka ndihmuar Kamerinin të forcojë dëshminë. Ai thotë: “Fillimi i dëshmisë time erdhi nga programi i seminarit. Në moshën e adoleshencës, 14 vjeç, unë me të vërtetë isha duke luftuar për ungjillin. Nuk kënaqesha në kishë dhe bëja gjëra që nuk duhet t’i bëja. Ishte vetëm çështje muajsh përpara se unë të kisha hequr dorë plotësisht.” Por kur një mike e ftoi Kamerinin që të merrte pjesë në seminar, ai vendosi të shkojë me të. Më pas vërtet filluan të vinin bekime.

“Unë fillova të ndieja Shpirtin përsëri”, thotë Kameroni. “Unë fillova t’i kushtoja më shumë vëmendje kishës dhe të merrja pjesë në mësimet e Shkollës të së Dieles dhe të priftërisë. U bë më e lehtë dhe unë fillova të ndihesha i lumtur. Më në fund fitova dëshminë e ungjillit për veten time.” Pas dy muajsh seminari, Kameroni u takua

me peshkopin e tij dhe u shugurua si mësues në Priftërinë Aarone.

Kameroni e dinte se seminari e ndihmon atë t’u rezistojë tundimeve të botës. “Ndërsa seminari vazhdon”, thotë ai, “Unë e kisha më të lehtë të përballesha me sfidat që bota shfaq. Është goxha e vështirë të jesh një i ri në botën ku jetojmë – mëkati na rrethon në të gjitha anët. Nëse merrni pjesë në seminar, unë ju dëshmoj se, ju do të gjeni forcën për të mbrojtur veten kundër mëkatis që na rrethon. Seminari krijon një mburojë shpirtërore për t’ju mbrojtur juve. Shumë sfida dhe tundime të ndryshme kanë ardhur gjatë rrugës sime dhe seminari ka qenë një ndihmë kaq e pamatshme për të më mbajtur në shtegun e ngushtë dhe të ngushtuar.”

Forcimi i Njëri-Tjetrit

Seminari gjithashtu ju lejon që të mblidheni me adoleshentë të tjerë që kanë të

njëtin besim me ju. Vika Çelishkova nga Rusia thotë: “Unë jam e frymëzuar nga njerëzit me të njëjtat ideale që mbajnë standarde të ngjashme morale dhe që besojnë në Perëndi siç bëj unë”. Ajo shton: “Nëse kam ndonjë pyetje, unë mund ta diskutoj me mësuesin e seminarit dhe studentë të tjerë. Unë mund të ndaj mendimet dhe dëshminë time me të tjerët për të forcuar besimin tim dhe të të tjerëve. Duke lexuar shkrimet e shenjta së bashku dhe duke medituar rreth përmbajtjes së tyre shpirtërore, ne afrohemi më shumë me Perëndinë dhe me njëri-tjetrin.”

Ksenia Gonkarova nga Ukraina ka parë rezultate të ngjashme. Ajo thotë: “Kur ne ndajmë përvojat tona me njëri-tjetrin, ne bëhemi më të fortë dhe i kuptojmë më mirë shkrimet e shenjta. Kur ne flasim për shembuj nga jeta jonë gjatë mësimëve, unë shoh





SEMINARI NDIKOI NË JETËN E PRESIDENTIT HENRI B. AJRING

Mildred Beniën ishte ndër nxënëset e klasës së parë të seminarit në Seminarin "Granit" në vitin 1912. Më vonë ajo do të bëhej mamaja e Presidentit Henri B. Ajring, Këshilltar i Parë në Presidencën e Parë.

Ajo e kuptoi rëndësinë e seminarit në jetën e saj dhe ajo dëshironte që fëmijët e saj të kishin të njëjtat bekime që ajo kishte ndier nga seminari, kështu që familja e saj mori një vendim të madh: "Ne u shpërngulëm në Juta pavarësisht sakrificës së madhe financiare, në mënyrë që bijtë tanë të marrin pjesë në Seminare e Institute dhe të gjenin miq në mesin e njerëzve tanë. Kjo mund t'i përgjigjet pyetjes për mendimet e mia rreth gjërave të tilla" (cituar në C. Coleman, *History of Granite Seminary*, f. 142).

Rëndësia e arsimit të Kishës vazhdoi në familjen Ajring kur Presidenti Henri B. Ajring në 1971-shin u bë president i Universitetit "Riks" (tani UBJ – Ajdaho), një universitet në pronësi të Kishës, dhe shërbeu si Komisioner për Arsimimin e Kishës nga 1980 deri 1985 dhe përsëri nga 1992 deri 2005.

mënyrën se si ungjilli punon në jetën time dhe në jetën e të tjerëve."

Arritja në Njohjen e Atit Qiellor dhe të Jezu Krishtit

Kohët e fundit një grup të rinjsh u pyetën se si seminari i ka bekuar ata. Përgjigjet e tyre zbuluan një temë të rëndësishme – se seminari i ndihmon ata të afrohen më pranë Atit Qiellor dhe Shpëtimtarit. Plaku Dejvid A. Bednar, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, ka dhënë mësim: "Të gjitha temat që ju studioni në seminar janë të rëndësishme. Çdo vit ndërsa përqendrohemi te një nga vëllimet e shkrimit të shenjtë, fokusi kryesor është Zoti Jezu Krisht."⁹

Ja se ç'thonë disa adoleshentë rreth mënyrës se si seminari i ka sjellë ata më afër Jezu Krishtit.

- "Unë kam mësuar se çfarë bën Shpëtimtari për mua, duke lexuar gjithë këto histori nga profetë të shumtë dhe duke kuptuar se sa e rëndësishme jam për Të. Unë e kuptoj se Ai më donte mua mjaftueshëm sa për të vdekur dhe shlyer për dhembjen time."
- "Seminari është një mënyrë e mrekullueshme për të filluar ditën time. Pavarësisht se sa i lodhur jam, unë e ndiej Shpirtin dhe ndihem i forcuar kështu që kur gjëra të vështira të ndodhin në ditën time, unë e di pa dyshim se Shpëtimtari më do dhe jam më se i sigurt për të mbështetur atë që është e drejtë."
- "Unë jam një e kthyer në besim në Kishë. Unë fillova të shkoja

në seminar madje përpara se të pagëzohesha. Unë nuk e di fare nëse do të isha pagëzuar pa seminarin. Pa seminarin, unë nuk do ta kisha Shpëtimtarin në jetën time pikërisht tani ose nuk do të dija se mund të marr falje për mëkatet e mia. Unë kurrë nuk e kisha pasur vërtet Atin Qiellor ose Jezu Krishtin në jetën time. Seminari më ndihmoi t'i gjeja Ata dhe t'i bëja Ata përgjithmonë një pjesë të jetës sime dhe të jetës së fëmijëve të mi të ardhshëm."

- "Vajtja në seminar çdo ditë më ka ndihmuar të rritem më pranë Zotit dhe Shpëtimtarit tim, Jezu Krishtit, përmes të mësuarit të mësimëve të Tij, dashurisë së Tij të madhe për mua dhe të mësuarit se si mund të kthehem dhe të jetoj me Të."
- "Kur jam në seminar, unë gjej një kuptim më të thellë në shkrimet e shenjta. Ai më ndihmon çdo mëngjes të jem si Krishti në aktivitetet e mia të përditshme."
- "Seminari më ka mësuar se si t'i lexoj shkrimet e mia të shenjta dhe jo vetëm të kënaqem me to, por gjithashtu t'i zbatoj ato që lexoj në jetën time. Unë kam mësuar doktrina dhe parime që më kanë ndihmuar të forcoj dëshminë time për një Atë të dashur Qiellor dhe Jezu Krishtin, që do ta marr me vete për pjesën tjetër të jetës sime." Me kaq shumë bekime që vijnë nga pjesëmarrja në seminar, është e lehtë të kuptosh përse të rinjtë në mbarë botën janë duke e bërë atë një përparësi në programin e tyre ditor. ■

SHËNIME

1. Boyd K. Packer, *Teach the Scriptures* (drejtuar mësuesve të Sistemit Arsimor të Kishës, 14 tetor 1977), f. 3.
2. L. Tom Peri, "Lartësimi i Synimeve", *Liahona*, nëntor 2007, f. 48.
3. Richard G. Scott, "Realize Your Full Potential", *Liahona*, nëntor 2003, f. 42.
4. Gordon B. Hinckley, "Stand True and Faithful", *Ensign*, maj 1996, f. 93.
5. Gordon B. Hinckley, "The Miracle Made Possible by Faith", *Ensign*, maj 1984, f. 47.
6. Gordon B. Hinckley, "The State of the Church", *Ensign*, maj 1991, f. 52.
7. Ezra Taft Benson, "Our Responsibility to Share the Gospel", *Ensign*, maj 1985, f. 7.
8. Dallin H. Oaks, "Mirë, Më Mirë, Më e Mira", *Liahona*, nëntor 2007, f. 104.
9. David A. Bednar, "Conclusion and Testimony", *Welcome to Seminary 2010–2011*, seminary.lds.org/welcome.

HISTORIA E SEMINARIT

Në vijim keni një vështrim se si seminari është rritur përgjatë viteve.

1888: Presidenti Uillford Udraf mbikëqyri krijimin e Këshillit të Kishës për Arsimin për të drejtuar përpjekjet e Kishës për arsim, përfshirë orët mësimore fetare pas shkollës.

1912: Organizimi i orëve të para ditore të mëimit të seminarit, me në total 70 studentë që lënë një orë mësimi në shkollën e mesme për të marrë pjesë në seminar. Orët e mëimit bëhen nga ana tjetër e rrugës përballë Shkollës së Mesme "Granit" në Solt-Lejk-Siti të Jutas në SHBA.

1925: Regjistrimi arrin 10.000 nxënës.

1948: U bë i mundur në Kanada, vendi i parë jashtë Shteteve të Bashkuara që kishte klasat e seminarit.

1950: Organizimi i orëve ditore të mëimit të seminarit (të quajtura më parë "seminari herët në mëngjes") në Kaliforni, ku nxënësit takohen në shtëpitë e mbledhjeve të Kishës para se të fillojnë shkolla.

1958: Regjistrimi arrin 50.000 nxënës.

1985: U bë i mundur në Amerikën Qendrore, prezantuar fillimisht në Meksikë.

1962: U bë i mundur në Europë, paraqitur fillimisht në Finlandë dhe Gjermani.

1963: U bë i mundur në Azi, paraqitur fillimisht në Japoni.

1965: Regjistrimi arrin 100.000 nxënës.

1967: Fillimi i seminarit për studim në shtëpi në komunitetet rurale, ku nxënësit studiojnë në shtëpi katër ditë në javë dhe takohen së bashku një ditë në javë.

1968: U bë i mundur në Australi.

1969: U bë i mundur në Amerikën Jugore, prezantuar fillimisht në Brazil.

1972: U bë i mundur në Afrikë, prezantuar fillimisht në Afrikën Jugore.

1983: Regjistrimi arrin 200.000 nxënës.

1991: Regjistrimi arrin 300.000 nxënës.

2012: I disponueshëm në 134 vende dhe territore në mbarë botën, me rreth 370.000 nxënës të regjistruar.



NJË THIRRJE PËR NJË TË KTHYER NË BESIM



Nga Helena Hanonen

Pak pasi u pagëzova në moshën 10-vjeçare në Lapenranta të Finlandës, unë mora thirrjen time të parë në Kishë. Ishte viti 1960 dhe dega jonë e vogël kishte nevojë dëshpërimisht për dikë që të shoqëronte [në piano] himnet për mbledhjet e sakramentit. M'u kërkua që ta përmbushja këtë detyrë.

Ndërkohë që mamaja ime gjithmonë na ka nxitur vëllanë tim dhe mua që të ushtronim talente artistike, unë nuk dija të luaja në piano, ne nuk kishim një piano. Por unë doja ta përmbushja thirrjen time, kështu që bëmë një plan.

Në mbrëmjen familjare, ne folëm rreth asaj se çfarë do të thoshte kjo thirrje për të gjithë ne. Megjithatë, për shkak se mamaja ime ishte



Unë isha një e kthyer e re në besim dhe nuk kisha aftësi për të luajtur piano. Por, sa mirënjohëse jam për thirrjen time si shoqëruese e degës në piano, që më ndryshoi jetën.

e ve me dy fëmijë të vegjël, ne e dinim se do të ishte një sfidë e madhe për ne që të blinim një piano dhe të paguanim për mësimet. Ne vendosëm se do të ishim të gatshëm për të bërë sakrificat e nevojshme.

Sakrificat e parë që familja ime bëri, ishte financiare. Ne vendosëm që nga pranvera në vjeshtë ne do të ngisnim biçikletat në vend që të merrnim autobusin. Vëllai im, Marti, ishte i guximshëm dhe u bë i zoti veçanërisht në ngarjen e biçikletës – madje edhe në borë e akull. Unë hoqa dorë nga blerja e disa rrobave dhe mësova të qep. Ne gjithashtu mësuam të jetojmë me kursime për të ruajtur për të ardhmen. Ne krijuam një kopsht në fshat, afër shtëpisë së gjyshërve të mi dhe ruajtëm ushqim për dimër. “Pushimet” tona u bënë udhëtimet e mamasë në tempullin në Zvicër ose piknikët dhe ngritja e kampeve afër shtëpisë.

Sakrificat e dytë që familja ime bëri, ishte kohën. Ne i ndamë punët dhe i riprogramuam aktivitetet tona të tjera e detyrat e shtëpisë, kështu që të kisha kohë mjaftueshëm për të praktikuar pianon. Për shkak të sakrificës tonë dhe punës së vështirë, Mamaja shpesh u shpreh se ne nuk kishim kohë të lirë për t'u marrë me telashet sikurse të tjerët në moshën tonë. Në të vërtetë, thirrja ime u bë një thirrje e familjes shumë kohë përpara se të luaja ndonjë notë.

Unë fillova të merrja mësimet me një mësues muzike në shkollën vendore. Unë u ushtrova duke përdorur një tastierë prej letre dhe pianon në kishë. Kur mësuesi im i pianos u largua, ne e blemë pianon e tij dhe unë u pranova për të studiuar me një mësuese të njohur pianoje në zonë.

Unë i mësova himnet në mënyrë të pavarur dhe u ushtrova shumë me drejtuesin e muzikës së degës. Të gjithë më nxisnin – edhe nëse luhej një notë jo e saktë. Mësuesja ime u mahnit pasi zbuloi se unë luaja përballë njerëzve përpara se të kisha mësuar dhe

mbajtur mend plotësisht pjesët. Por të luajturit me një dorë ishte më mirë se sa mos të kishte muzikë fare.

I hipja biçikletës për të marrë mësimet e mia dhe, kur dimri afrooi, u përpoqa të ecja ose nëse ishte e mundur të bëja ski. Të dielave ecja vetëm për në mbledhjet e Kishës në mënyrë që të arrija një orë përpara dhe të kisha kohë për t'u ushtruar. Unë vendosa që të shkoja me autobus vetëm kur temperaturat arrinin poshtë -15°C (5°F). Shiu dhe bora në të vërtetë nuk më bezdisnin; koha kalonte më shpejt ndërsa ecja, sepse kisha kaq shumë himne të mrekullueshme që më bënë shoqëri. Ndërsa ecja, kaloja fushat me pionierët (shih “Eni Shenjtorë” *Himne dhe Këngë të Fëmijëve*, f. 2), ecja lart në majën e malit në Sion (shih “Lart në Majën e Malit”, *Himne dhe Këngë të Fëmijëve*, f. 30) dhe qëndroja me të rinjtë të cilët nuk do të ligështoheshin kurrë (shih “True to the Faith” [“Të Vërtetë ndaj Besimit”] *Hymns*, nr. 254). Unë nuk do të rreshtja kurrë së qeni e fortë me atë mbështetje – edhe pse unë dhe familja ime ishim të vetmit shenjtorë të ditëve të mëvonshme në komunitetin tonë në Finlandën lindore, afër kufirit rus.

Përgjatë viteve unë u përmirësova shumë në luajtjen e pianos dhe mund të bëja muzikë në vend që thjesht të luaja notat e dhura. Unë mësova ta përzgjidhja muzikën me lutje në mënyrë që Shpirti të ishte në mbledhje. Dhe më e rëndësishme, dëshmia ime për ungjillin erdhi tek unë nëpërmjet muzikës. Unë mund t'i kujtoja me lehtësi ndjenjat, fjalët dhe mesazhet e himneve nëse ndonjëherë kisha ndonjë dyshim. Unë e dija se parimet dhe ordinancat e ungjillit ishin të vërteta, duke i mësuar ato rresht pas rreshti dhe notë pas note.

Më kujtohet një ditë e veçantë, kur u vu në provë zotimi im ndaj atyre parimeve. Isha 14-vjeçe; e kisha pasion notin dhe ëndëroja të notoja në Lojërat Olimpikë. Nuk konkurroja



të dielave, por përsëri ecja përpara. Së fundi, kur Lojërat Olimpikë në Meksiko-Siti u afruan, një trajnier më ftoi të merrja pjesë në trajnime të veçanta.

Trajnimi, megjithatë, ishte çdo të diel në mëngjes gjatë Shkollës të së Dielës. Unë arsye-tova duke menduar se unë mund të shkoja për t'u ushtruar dhe të humbisja orën e Shkollës të së Dielës, sepse mund të kthehesha përsëri në kishë në kohë për mbledhjen e sakramentit në mbrëmje. Unë kurseva para për biletën e autobusit dhe planifikova gjithçka. Të shtunën para trajnimit të parë, i tregova planin nënës sime.

Unë pashë trishtim dhe zhgënjim në sytë e saj, por përgjigjja e saj e vetme qe se vendimi ishte i imi dhe se më ishte mësuar se çfarë ishte e drejtë. Atë natë nuk më hiqeshin nga mendja fjalët e “Choose the Right” [“Zgjidh të Drejtën”] (*Hymns*, nr. 239). Fjalët më përsërite-shin në mendje si një disk i prishur.

Të dielën në mëngjes, unë kisha çantën e notit në njërin krah dhe çantën e muzikës në krahun tjetër, duke shpresuar që ta bëja ma-manë të besonte se po shkoja në kishë. Unë shkova jashtë deri te stacioni i autobusit. Ndo-dhi që stacioni i autobusit që shkonte për te ndërtesa publike e notit ishte në krahun tim të rrugës dhe tjetri që shkonte për në kishë ishte në krahun e kundërt. Ndërkohë që prita, nisa të pezmatohesha. Në mendjen time vazhdoja të dëgjoja muzikën “Have I Done Any Good?”

Njëri autobus do të më çonte te thirrja ime në Kishë, tjetri te ëndrra ime e fëmijërisë për notare të klasit botëror.

Frazat e himneve që kam luajtur kaq shumë herë [në piano] ma dhanë përgjigjen.

[“A Kam Bërë Ndonjë të Mirë?”] *Hymns*, nr. 223) – himni i planifikuar për Shkollën e së Dielës atë ditë. Unë e dija nga përvoja se, me ritmin e vështirë, tekstin e ndërlikuar dhe notat e larta, ky himn do të ishte një katastrofë pa shoqërues të fortë.

Ndërsa po mendohesha për zgjedhjet e mia, të dy autobusët u afruan. Autobusi që të çonte te ndërtesa publike e notit ndali për mua dhe shoferi i autobusit që të çonte për në kishë ndali dhe pa drejt meje, me mëdyshje sepse e dinte që unë gjithmonë merrja autobusin e tij. Ne të gjithë i ngulëm sytë te njëri-tjetri për pak sekonda. Çfarë isha duke pritur? Unë kisha zgjedhur Zotin (shih “Who’s on the Lord’s Side?” [“Kush është në Anën e Zotit?”] *Hymns*, nr. 260). Unë kisha premtuar të shkoja ku Ai donte që unë të shkoja (shih “Do të Shkoj ku Ti Do që të Shkoj”, *Himne dhe Këngë të Fëmijëve*, f. 46). Vendimi im për të mbajtur urdhërimet ishte marrë kohë më parë (shih “Keep the Commandments” [“Mbani Urdhërimet”], *Hymns*, nr. 303).

Përpara se mënyra ime e të menduarit të mund të drejtohej nga dëshirat e mia, trupi im mori pushtetin. Unë vrapova matanë rrugës dhe ia bëra me dorë shoferit të autobusit. Paga-gova biletën dhe shkova në pjesën e prapme të autobusit të drejtuar për në kishë dhe u duk sikur ëndrra ime për të qenë një notuese e suksesshme u largua në drejtim të kundërt.

Gjithkush mendoi se qava atë ditë sepse ndieva Shpirtin. Por me të vërtetë qava, sepse kuptova se ëndrra ime e fëmijërisë nuk do të bëhej realitet dhe sepse më erdhi turp se kisha menduar të argëtohesha me idenë e të notuarit në ditën e Shabatit. Por atë të diel, sikurse ato para dhe pas, unë e përmbusha thirrjen time.

Në kohën që unë isha gati të shkoja në universitet, unë kisha trajnuar shumë anëtarë të degës për të drejtuar muzikën dhe për t'i rënë pianos. Në universitet unë vazhdova të luaja në piano dhe të merrja mësimë organoje. Mendova se mundësia ime për të shkuar në Amerikën Latine ishte zhdukur përgjithmonë kur hoqa dorë nga konkursi i notit por, pasi përfundova studimet e mia pasuniversitare në Universitetin "Brigam Jang", unë shërbeva në një mision në Kolumbi. Gjatë misionit tim, unë dhashë mësimë pianoje. Unë dëshiroja t'i lija ata shenjtore me dhuratën e muzikës. Fëmijë dhe të rinj nga Kolumbia ecnin me kilometra në diellin e nxehtë që të kishin mundësinë për të mësuar të luanin në piano. Ata gjithashtu filluan me njëren dorë derisa përparuan për të luajtur me të dyja duart. Dhe ata bënë më shumë sakrificë seç bëra unë në përpjekjet e tyre për të mësuar për të luajtur në piano.


Kanë kaluar më shumë se 50 vjet që kur u pagëzova. Unë kam udhëtuar jashtëzakonisht larg nga shtëpia ime në Finlandë, por pavarësisht se ku kam shkuar, gjithmonë ka qenë nevoja për dikë që të luajë himnet [në piano]. Gjuha e përbotshme e muzikës ka krijuar lidhje mirëkuptimi dhe dashurie në shumë vende.

Tani duart e mia janë të ngadalta dhe të gjymta. Shumë muzikantë më të aftë kanë zënë vendin

Gjatë misionit tim në Kolumbi, unë dhashë mësimë pianoje. Fëmijët dhe të rinjtë ecnin me kilometra në diellin e nxehtë për të mësuar, duke bërë sakrificë të mëdha për të marrë dhuratën e muzikës.

tim. Mamaja ime shpesh ndihet e trishtuar kur sheh prapa në vitet e mia të para në Kishë dhe sakrificat që kam bërë, kilometrat që kam ecur dhe gjërat që kam sakrifikuar. Ajo ka frikë se i ftohti ndikoi në gjymtimin tim. Megjithatë, unë ndiej gëzim nga shenjat e dukshme të sakrificave të mia. Unë ia kushtova muzikës gjithë gëzimet dhe hidhërimet e mia. Unë mësova të qesh dhe qaj duke përdorur gishtat e mi.

Zemra ime ndien mirënjohje të madhe kur mendoj se Ati Qiellor dhe udhëheqësit e mi u kujdesën mjaftueshëm për t'i kërkuar një vajze të vogël që të përmbushë një detyrë të tillë sfiduese. Ajo thirrje më ndihmoi të fitoj një kuptueshmëri të sigurt të ungjillit dhe më lejoi t'i ndihmoj të tjerët që të ndiejnë Shpirtin përmes muzikës. Unë jam një dëshmi e gjallë se të sapokthyerit në besim kanë nevojë për një thirrje – madje edhe vajzat e vogla pa asnjë aftësi në piano. Nëpërmjet thirrjes time, kam zbuluar se me Perëndinë asgjë s'është e pamundshme dhe se Ai ka një plan dhe qëllim për secilin nga fëmijët e Tij. Dhe nëpërmjet muzikës, unë fitova një dëshmi të palëkundur për ungjillin e rivendosur të Jezu Krishtit. ■



Këshillat e Lagjeve

NË PUNË

Nga LaRin Gant

Revistat e Kishës

Shenjtoret e ditëve të mëvonshme janë duke përdorur këshillat e lagjeve dhe të degëve për të bekuar jetët e njerëzve në nevojë.



Në mbrëmjen e 22 majit 2011, në mes të zërit të sirenavë të forta, një tornado masive preku zemrën e Xhoplinit, në Misuri të SHBA duke shkatërruar shtëpi dhe jetë. Lagjja e Parë e Xhoplinit u godit rëndë nga tornadoja, por menjëherë Peshkopi Kris Hofmen dhe këshilli i lagjes filluan të siguroheshin se anëtarët e lagjes qenë të sigurt.

“Ne patëm një plan-veprimi të gatshëm, sepse kishim folur rreth këtyre përgatitjeve në këshillin e lagjes përpara se të ndodhnin”, tha ai. “Ne gjithashtu u mbështetëm te Shpirti për të ditur se çfarë të bënim. Shtyllat e energjisë elektrike qenë rrëzuar. Telefonat celularë nuk funksionin. Ne u lutëm e dëgjua në pritje të përgjigjeve dhe ato erdhën – ato gjithmonë kanë ardhur. Më bëri të ndihem i kënaqur dhe i gëzuar si peshkop të dëgjoja anëtarët kur thonin: ‘Kjo është ajo që kam bërë unë’, në vend që të thonin ‘Çfarë doni që unë të bëj?’”

Përgjigjja në Xhoplin tregon fuqinë e një këshilli lagjeje të bashkuar. “Mbledhja e këshillit të lagjes është një nga takimet më të rëndësishme në Kishë”, shkroi Plaku M. Rasëll Ballard, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, “sepse udhëheqësit e kuorumit të priftërisë dhe të organizatave ndihmëse mund të diskutojnë dhe të planifikojnë me peshkopatën. . . . Nga të gjithë këshillat dhe komitetet në



Kishë, unë besoj se këshilli i lagjes mund të ketë ndikimin më të madh për të ndihmuar fëmijët e Atit tonë.”¹

Të Bashkuar nga Dashuria dhe Besimi

Në Puerto-Francisko të Orellanës, një fshat i veçuar në xhunglat e Ekuadorit, anëtarët kanë një lidhje të fortë dashurie dhe besimi. Këshilli i degës çdo muaj tregon se sa shumë kujdesen ata. Ata përqendrohen së pari mbi individët dhe familjet, më pas tek mënyra se si mund të ndihmojnë programet. Frymëzimi pason.

Shumë anëtarë kanë nevojë për ndihmë për të gjetur punë. Këshilli i degës konstaton se sfidat e anëtarëve shpesh mund të zgjidhen në shkallë vendore. Ndërsa këshilli diskutoi për nevojat e një nëne të vetme me një vajzë të vogël që kishte probleme shëndetësore, presidentja e Shoqatës së Ndhmës dinte një punë ku mamaja mund të punonte dhe ende të mund të ishte pranë vajzës së saj.

Këshilli i degës shfrytëzon gjithashtu burimet e Kishës, të tilla si materiale trajnimi për karrierën nga Shërbimet e Punësimit të SHDM.² Ata krijuan një klasë ku jepte mësim një anëtar i degës, që i ndihmoi anëtarët e tjerë të degës për të gjetur një punë të mirë.

Ramiro Rijes, këshilltar i parë në presidencën e degës, thotë për këshillin e degës: “Ne jemi mjete në duart



POROSI TË DOMOSDOSHME PËR KËSHILLAT E EFEKTSHËM

Në librin e tij *Counseling with Our Councils [Këshillimi me Këshillat Tanë]*, Plaku M. Rasëll Ballard, i Kuorumit të Dymbëdhjetë

Apostujve, na jep tre sugjerimet e mëposhtme:

“Së pari, përqendrohuni mbi gjërat themelore.”

Ndiqni udhëzimet në *Handbook 2: Administering the Church [Manualin 2: Administrimi i Kishës]*, kapitullin 4, i cili mund të gjendet në internet në seksionin *Serving in the Church* në LDS.org.

“Së dyti, përqendrohuni te njerëzit, jo te programet.” Përpiquni “për t’i bërë anëtarët e rinj pjesë të lagjes, për t’i aktivizuar anëtarët më pak aktivë, për shqetësimet e të rinjve, për problemet ekonomike të çdo anëtari dhe për nevojat e nënave të vetme dhe të vejave”.

“Së treti, këshillat janë për këshillim dhe ndarje idesh, jo vetëm për raportim dhe udhëzime. Krijoni një mjedis që i mirëpret mendimet e gjithësecilit, ku çdo person dhe grup është i rëndësishëm dhe çdo opinion është i vlefshëm.” Individët kanë pikëpamje dhe formime të ndryshme kulturore, kështu që secili mund të shtojë një perspektivë të dobishme për të kuptuar nevojat e anëtarëve.

Shih Plaku M. Russell Ballard, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, *Counseling with Our Councils [Këshillimi me Këshillat Tanë] (1997)*, f. 106, 109, 112.



e Zotit. Ne do t'i përmbushim qëllimet e Tij përmes veprave tona."

Shtegu drejt Tempullit

Në Liverpul të Nju-Jorkut në SHBA, ndërsa presidentja e Fillores Melisa Fisk mori pjesë në mbledhjen e këshillit të lagjes, ajo gradualisht e kuptoi fuqinë e saj. Kur ajo kërkoi brenda çantës për një bllok shënimesh, ajo gjeti një fotografi të 28 fëmijëve të Fillores në shkallët e Tempullit të Palmirës në Nju-Jork. Të gjithë qenë të mbuluar me thumba grenzash. Për një moment, figura e largoi vëmendjen e saj nga takimi, dhe ajo u përqendrua pak në ditën

kur Fillorja e lagjes kishte shkuar në Palmira për të shijuar ndjesinë e shenjtë të tokës së tempullit. Për fat të keq, kur fëmijët shtruan batanijet e tyre, kishin përmbysur padashur një koshere grenzash.

Pasi të gjithë morën përkujdesje, udhëheqësit i ftuan fëmijët të preknin tempullin. Fëmijët refuzuan pasi kishin frikë se mund të kishte akoma grenza. Kështu që prindërit dhe udhëheqësit qëndruan në një rresht dhe krijuan një rrugë për në tempull. Kjo u dha fëmijëve kurajë për të ecur përpara.

Kur Melisa e ktheu vëmendjen e saj përsëri në mbledhjet e këshillit të lagjes, ajo mendoi: "Ah, sikur secili të mund të rrethohej nga miq dhe udhëheqës të tillë të dashur ndërsa bëjnë përpara drejt tempullit".

KUSH PËRFSHIHET NË KËSHILLIN E LAGJES OSE DEGËS?

Udhëheqësit vijues të priftërisë dhe të organizatave ndihmëse marrin pjesë në këshill me dy funksione: 1) si anëtarë të këshillit të lagjes që e ndihmojnë peshkopin të gjejë zgjidhje për nevojat dhe shqetësimet e lagjes dhe 2) si

Peshkopata

Peshkopata ka përgjegjësi për të gjithë anëtarët, organizatat dhe aktivitetet e lagjes. Peshkopi kryeson në këshillin e lagjes, por ai mund të marrë vendime më të mira pas diskutimeve me këshilltarët e tij dhe me këshillin e lagjes, kur është e përshtatshme.

(Shih *Handbook 2: Administering the Church [Manualin 2: Administrimi i Kishës]*, 4.1; 4.2.)

Nëpunësi i Lagjes

"Nëpunësi i lagjes mban një dokument të detyrave dhe vendimeve të marra gjatë mbledhjeve të këshillit të lagjes. . . . Ai gjithashtu siguron informacionin përkatës statistikor për lagjen nga programi kompjuterik i Kishës për mbajtjen e dokumenteve."

(*Handbook 2 [Manuali 2]*, 4.6.4.)

Sekretari Ekzekutiv

"Sekretari ekzekutiv përgatit rendet e ditës për mbledhjet e këshillit të lagjes. . . . Peshkopi mund t'i kërkojë atij gjithashtu që ta ndihmojë për ndjekjen e mëtejshme me anëtarët e këshillit të lagjes në detyrat e tyre. . . . [Ai] gjithashtu mund të jetë një person ndërlidhës midis këshillit të lagjes dhe komitetit ekzekutiv të priftërisë."

(*Handbook 2 [Manuali 2]*, 4.6.5.)

Udhëheqësit e Priftërisë Melkizedeke

Udhëheqësit e grupeve të priftërinjve të lartë dhe presidenti i kuorunit të pleqve janë përgjegjës për mirëqenien shpirtërore dhe materiale të burrave mbi të cilët ata kryesojnë. Peshkopi mund t'u delegojë udhëheqësve të kuorunit dhe grupeve si detyra disa nga punët që ai bën me familjet.

(Shih *Handbook 2 [Manualin 2]*, f. 7.)

Udhëheqësi i Misionit i Lagjes

Udhëheqësi i misionit i lagjes bashkërendon përpjekjet e lagjes për të bërë punë misionare. Ai punon me misionarët me kohë të plotë dhe misionarët e lagjes. Në mbledhjet e këshillit të lagjes, peshkopi mund t'i kërkojë atij të drejtojë diskutimet mbi punën misionare.

(Shih *Handbook 2 [Manualin 2]*, 5.1.3.)

Mendimet e saj u ndërpre në ndërsa dëgjoi presidenten e Shoqatës së Ndhmës të komentonte mbi një motër në nevojë: “Ajo nuk ishte në kishë të dielën e kaluar. Do të sigurohem që mësueset e saj vizitore ta vënë në dijeni për udhëtimin e ardhshëm në tempull.”

“Ata kanë kaluar shumë gjëra të vështira deri tani”, shtoi presidenti i kuorumit të pleqve. “Unë do të flas me mësuesit e tyre të shtëpisë dhe do të shoh nëse ka ndonjë gjë që mund të bëjmë.”

“Të rehat mund të ndihmojnë me kujdesin ndaj fëmijëve”, shtoi presidentja e Të Rejave.

Ndërkohë që Melisa vështroi fytyrat e anëtarëve të këshillit të lagjes, ajo pa kënaqësi dhe shqetësim të sinqertë.

Një buzëqeshje erdhi në fytyrën e saj. “Zoti ka përgatitur mënyra për Fëmijët e Tij që të jenë të mbrojtur dhe të kenë dashuri”, mendoi ajo. “Këshilli i lagjes!”

Ashtu sikurse në Xhoplin, në Puerto-Fransisko të Orelanës dhe në Liverpul, udhëheqësit e Kishës në mbarë botën vazhdojnë të zbulojnë bekimet e këshillave të lagjeve dhe degëve. Kur veprojnë, ata do të marrin fuqinë e jashtëzakonshme të këtyre këshillave për të ndihmuar Zotin që t'i bekojë fëmijët e Tij dhe për të përmbushur punën e Tij. ■

SHËNIME

1. M. Russell Ballard, *Counseling with Our Councils: Learning to Minister Together in the Church and in the Family* (1997), f. 102.
2. *The Career Workshop Participant's Workbook* (artikulli nr. 35163) është i disponueshëm përmes store.lds.org. Shërbimet e Shpërndarjes ose qendra të Kishës për burimet për punësim.

përfaqësues të organizatave të tyre. Ata punojnë së bashku me dashuri për t'u shërbyer dhe për t'i forcuar individët dhe familjet e tyre në lagje ose degë. (Referencat për lagjet dhe peshkopatat zbatohen gjithashtu për degët dhe presidencat e degëve.)

Presidentja e Shoqatës së Ndhmës

Presidentja e Shoqatës së Ndhmës përfaqëson gratë e një lagjeje mbi moshën 18 vjeç. Ajo bën gjithçka që mundet për t'i ndihmuar gratë të rrisin besimin dhe drejtësinë e tyre vetjake, të forcojnë familjet e shtëpitë dhe të ndihmojnë njerëzit në nevojë.

(Shih *Handbook 2 [Manualin 2]*, f. 9.)

Presidenti i Të Rinjve

Presidenti i Të Rinjve kërkon të forcojë të rinjtë e lagjes midis moshës 12 deri në 18 vjeç. Duke u ndihmuar nga këshilltarët e tij, ai ndihmon presidencën e Priftërisë Aarone (peshkopatën) dhe mbikëqyr programin e skautizmit aty ku është në dispozicion.

(Shih *Handbook 2 [Manualin 2]*, 8.3.4.)

Presidentja e Të Rejave

Presidentja e Të Rejave kërkon të forcojë të rehat e moshave 12 deri në 18 vjeç. Ajo është përgjegjëse për të “ndihmuar secilën të re të jetë e denjë për të bërë dhe mbajtur bësëlidhjet e shenjta dhe për të marrë ordnancat e tempullit”.

(*Handbook 2 [Manuali 2]*, 10.1.1.)

Presidentja e Filllores

Presidentja e Filllores përfaqëson fëmijët e moshës 18 muajsh deri në 11 vjeç. Këndvështimi i saj do të jetë i dobishëm kur këshilli i lagjes merr në konsideratë një çështje që prek fëmijët e lagjes.


(Shih *Handbook 2 [Manualin 2]*, 11.)

Presidenti i Shkollës të së Dielës

Presidenti i Shkollës të së Dielës është përgjegjës për paraqitjen e të gjithë ungjillit gjatë Shkollës të së Dielës. “Ai vjen në mbledhjen e këshillit të lagjes i përgatitur për të sugjeruar mënyra që anëtarët mund të përmirësojnë nxënien dhe mësimdhënien në kishë dhe në shtëpitë e tyre.”

(*Handbook 2 [Manuali 2]*, 12.2.2.)

Për të mësuar më shumë rreth arritjes së suksesit në thirrjen tuaj, vizitoni Bibliotekën e Trajnimit për Udhëheqjen, të disponueshme në disa gjuhë në leadershiplibrary.lds.org.



Nga Rozmari M. Uiksom
Presidente e Përgjithshme e Fillores

Gjetja e Kohës për të Folur e për të Dëgjuar

Përpyekja jonë e qëllimshme për të komunikuar më mirë sot, do t'i bekojë familjet tona përjetësisht.

Në një botë të përkryer çdo fëmijë do të kthehej nga shkolla në shtëpi duke u mirëpritur me një pjatë biskotash të sapopjekura me çokollatë, një gotë të madhe me qumësht të ftohtë dhe me një nënë të gatshme për të gjetur kohën për të folur dhe për të dëgjuar rreth ditës së fëmijës së saj. Ne nuk jetojmë në një botë të përkryer, kështu që ju mund t'i anashkaloni biskotat dhe qumështin, nëse dëshironi, por ju nuk duhet ta anashkaloni “gjetjen e kohës për të folur e për të dëgjuar”.

Njëzet e nëntë vite më parë, Presidenti Xhejms E. Faust (1920–2007), Këshilltar i Dytë në Presidencën e Parë, vërejtje trishtueshëm se familjet kalojnë shumë pak kohë së bashku. Mendoni për këtë – 29 vite më parë – në konferencën e përgjithshme: “Një nga problemet kryesore të shoqërisë së sotme është se ne kalojmë sa vjen e më pak kohë së bashku. . . . Koha së bashku është kohë e çmuar – kohë e nevojshme për të folur, për të dëgjuar, për të dhënë nxitje dhe për të treguar se si t'i bëjmë gjërat.”¹

Ndërsa ne kalojmë kohë së bashku dhe flasim me fëmijët tanë, ne arrijmë t'i njohim ata dhe ata arrijnë të na njohin ne. Përparësitë tona, ndjenjat e sinqerta të zemrës sonë, do të bëhen pjesë e bashkëbisedimit tonë me secilin fëmijë.

Cili është mesazhi më i rëndësishëm i zemrës suaj që ju do të zgjidhni t'ia tregoni fëmijës suaj?

Profeti Moisiu na mëson te Ligji i Përtërirë: “Ti do ta duash, pra, Zotin, Perëndinë tënd, me gjithë zemër, me gjithë shpirt dhe me tërë forcën tënde.

Dhe këto fjalë që sot po të urdhëroj do të mbeten në zemrën tënde;

do t'ua ngulitësh bijve të tu, do të *flasësh* për to kur rri ulur në shtëpinë tënde, kur ecën rrugës, kur ke rënë në shtrat dhe kur çohesh” (Ligji i Përtërirë 6:5–7; theksimet shtuar).

Dhe më lejoni të shtoj një tjetër: “Dhe kur të hani së bashku darkën në tryezë”.

Nëse dëshirojmë që familjet tona të jenë bashkë përgjithmonë, ne duhet ta fillojmë këtë proces sot. Kalimi i kohës duke folur me fëmijët tanë është një investim për familjen tonë të përjetshme ndërsa ecim në shtegun drejt jetës së përjetshme së bashku.

Një nënë nga Ilinoisi në SHBA, tregoi se si gjeti kohë për të folur me fëmijët e saj:

“Kur fëmijët ishin të vegjël, unë e kisha zakon të shikoja disa programe të parapëlqyera televizive. . . . Fatkeqësisht, programet fillonin në të njëjtën kohë kur fëmijët shkonin në shtrat.

. . . Erdhi një pikë kur kuptova se unë i kisha vënë programet e mia në krye të listës time të përparësive dhe fëmijët e mi i kisha vënë shumë më poshtë. Për pak kohë, unë u përpoqa t'i lexoja tregimet përpara gjumit me televizorin ndezur, por unë e dija në zemrën



time se ajo nuk ishte mënyra më e mirë. Ndërsa meditoja për ditët dhe javët që kisha humbur me zakonin tim të televizorit, fillova të ndihesha fajtores dhe vendosa të ndryshoja. U desh pak kohë që të bindja veten se unë mund ta fikja me të vërtetë televizorin.

Pas pothuajse dy javëve që e kisha lënë televizorin fikur, unë ndieva se m'u lehtësua disi një barrë. E kuptova se ndihesha më mirë, madje disi më e pastër dhe e dija se kisha bërë zgjedhjen e duhur.”²

Koha përpara gjumit është një kohë e përsosur për të folur.

Helamani tha për djemtë luftëtarë: “Dhe më përsëritën fjalët e nënave të tyre, duke thënë: Ne nuk dyshojmë që nënat tona e dinin atë” (Alma 56:48).

Ishin “fjalët e nënave të tyre” që i mësuam

ata. Ndërsa flisnin me fëmijët e tyre, këto nëna u mësuam fjalën e Perëndisë.

Ruajtja e Komunikimit Vetjak

Shumë të mira vijnë nga komunikimi dhe kundërshtari është në dijeni të fuqisë së fjalës së folur. Ai do të dëshironte shumë që të pakësonte shpirtin që vjen në shtëpitë tona kur ne flasim, dëgjojmë, nxisim njëri-tjetrin dhe i bëjmë gjërat bashkë.

Satani u orvat më kot të pengonte Rive-ndosjen e ungjillit të Jezu Krishtit në këtë periudhë ungjillore kur ai u përpoq të ndalonte një bisedë vendimtare mes Jozef Smithit dhe Perëndisë, Atit, e Birit të Tij, Jezu Krishtit.

Me fjalët e Jozefit: “Papritur u mbërtheva nga një fuqi që më pushtoi të tërin dhe që kishte një ndikim kaq të mahnitshëm mbi mua,



sa të ma lidhte gjuhën, kështu që unë nuk mund të flisja” (Joseph Smith – Historia 1:15).

Kundërshtarit do t’i pëlqente shumë të na i lidhte gjuhët – gjithçka vetëm që të na pengojë ne t’i shprehim gojarisht ndjenjat e zemrave tona ballë për ballë. Ai merr kënaqësi nga largësia dhe hutimi; ai merr kënaqësi nga zhurma; ai merr kënaqësi nga komunikimi i përgjithshëm (i paadresuar) – gjithçka që do të na mbante ne larg nga ngrohtësia e një zëri dhe ndjenjat e afërta që vijnë nga bisedimi kokë më kokë.

Dëgjimi i Zemrave të Fëmijëve Tanë

Të dëgjosh është aq e rëndësishme sa të flasësh. Plaku Xhefri R. Holland, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, tha: “Nëse ne dëgjojmë me dashuri, ne nuk do të kemi nevojë të vrasim mendjen se çfarë të themi. Ajo do të na jepet neve . . . nëpërmjet Shpirtit.”³

Kur mbajmë vesh, ne i kuptojmë ndjenjat e zemrave të atyre që na rrethojnë. Ati Qiellor ka një plan për çdonjërin nga fëmijët e Tij. Përfytyroni nëse ne do të mund ta shihnim planin individual për çdonjërin nga fëmijët tanë. Po sikur të mund ta dinim se si t’i zmadhoni

dhuratat e tyre shpirtërore? Po sikur të mund të dinim se si ta nxisnim një fëmijë që të arrijë potencialin e tij apo të saj? Po sikur të mund ta dinim se si të ndihmojmë çdo fëmijë që të zhvillohet nga besimi si i fëmijës te dëshmia?

Si mund ta dimë?

Ne mund të fillojmë ta dimë duke dëgjuar.

Një baba shenjtor i ditëve të mëvonshme tha: “Unë bëj një të mirë më të madhe kur i dëgjoj fëmijët e mi sesa kur u flas atyre. . . . Unë kam mësuar me kohë se fëmijët e mi nuk i duan përgjigjet e mia të gatshme, të vërtetuara në kohë dhe të mençura. . . . Për ta të qenit në gjendje që të bëjnë pyetje dhe që t’iu flas rreth problemeve të tyre është më e rëndësishme se të marrin përgjigjet e mia. Zakonisht kur ata mbarojnë së foluri, nëse unë kam dëgjuar mjaftueshëm mirë dhe gjatë, ata nuk kanë nevojë për përgjigjen time. Ata e kanë gjetur tashmë përgjigjen.”⁴

Duhet kohë për t’u përqendruar në gjërat që kanë më shumë rëndësi. Bisedimi, mbajtja vesh dhe nxitja nuk ndodhin me shpejtësi. Ato nuk mund të nxitohen ose të planifikohen – ato ndodhin më së miri përgjatë rrugës. Ato ndodhin kur ne i *bëjmë* gjërat bashkë: punojmë së bashku, krijojmë së bashku dhe luajmë së bashku. Ato ndodhin kur ne fikim televizorin dhe mediat e tjera, lëmë mënjanë hutimet e botës dhe përqendrohemi te njëri-tjetri.

Tani, kjo është diçka e vështirë për t’u bërë. Kur ndalemi dhe e fikim çdo gjë, ne duhet të jemi të përgatitur për atë që do të ndodhë më pas. Në fillim qetësia mund të jetë e sikletshme; një ndjenjë e çuditshme humbjeje mund të vijë nga kjo. Jini të duruar, prisni vetëm pak sekonda dhe më pas kënaquni me të. Jepuni vëmendjen tuaj të plotë atyre që ju rrethojnë duke u bërë një pyetje për veten dhe më pas filloni të dëgjoni. Prindër, flisni rreth diçkaje për të cilën interesohet fëmija juaj. Qeshni me të shkuarën – dhe ëndëroni për të ardhmen. Bisedimi qesharak mundet madje të ndryshohet në një diskutim kuptimplotë.

Ta kemi Përparësi Qëllimin Tonë të Përjetshëm

Pranverën e kaluar, ndërsa po vizitoja një klasë të të rejave, mësuesja na kërkoi si klasë që të shkruanim 10 përparësitë tona. Unë fillova të shkruaja menjëherë. Duhet ta pranoj, mendimi im i parë filloi me: “Numër 1: të pastroj sirtarin e lapsave në kuzhinë”. Kur lista jonë ishte plotësuar, udhëheqësja e Të Rejave na kërkoi të tregonim atë që kishim shkruar. Ebi, që sapo kishte mbushur 12 vjeç, ishte ulur pranë meje. Kjo ishte lista e Ebit:

1. Të shkoj në universitet.
2. Të bëhem stiliste mjedisesh të brendshme.
3. Të shkoj në mision në Indi.
4. Të marthohem në tempull me një misionar të kthyer nga misioni.
5. Të kem pesë fëmijë dhe një shtëpi.
6. T'i dërgoj fëmijët e mi në misione dhe në universitet.
7. Të bëhem një gjyshe “dhënëse-biskotash”.
8. Të llastoj nipërit e mbesat.
9. Të mësoj më shumë rreth ungjillit dhe të shijoj jetën.
10. Të kthehem e të jetoj me Atin në Qiell.

Unë them: “Faleminderit, Ebi. Ti më mësove rreth të pasurit të një kuptueshmërie për planin që Ati Qiellor ka për secilin prej nesh. Kur e dini që po ecni në një shteg, pavarësisht nga rrugët e tërthorta që mund të dalin, ju do të jeni mirë. Kur shtegu juaj është i përqendruar te qëllimi përfundimtar – ai i ekzaltimit dhe kthimit te Ati Qiellor, ju do të arrini atje.”

Nga e mori Ebi këtë kuptim të qëllimit të përjetshëm? Ai fillon në shtëpitë tona. Ai fillon në familjet tona. Unë e pyeta atë: “Çfarë bëni në familjen tuaj për t'i krijuar këto përparësi?”

Kjo ishte përgjigjja e saj: “Përveç leximit të shkrimeve të shenjta, ne po studiojmë *Predikoni Ungjillin Tim*”. Pastaj ajo shtoi: “Ne flasim shumë – gjatë mbrëmjes familjare, gjatë ngrënies në darkë së bashku dhe ndërsa ngasim makinën”.

Nefi shkroi: “Ne flasim për Krishtin, ne gëzohemi në Krisht, ne predikojmë për Krishtin”. Përse? “Që fëmijët tanë të mund të dinë se cilit burim t'i drejtohen për heqjen e mëkateve të tyre” (2 Nefi 25:26).

Të folurit, të dëgjuarit, nxitja e njëri-tjetrit dhe bërja e gjërave së bashku si familje, do të na afrojnë me Shpëtimtarin tonë, i cili na do. Përpjekja jonë e qëllimshme për të komunikuar më mirë sot – pikërisht sot – do t'i bekojë familjet tona përjetësisht. Unë dëshmoj se kur ne flasim për Krishtin, ne gjithashtu gëzohemi në Krishtin dhe në dhuratën e Shlyerjes. Fëmijët tanë do arrijnë ta dinë “se cilit burim t'i drejtohen për heqjen e mëkateve të tyre”. ■

Nga një fjalim i mbajtur në një transmetim satelitor të konferencës së kumjit në Solt-Lejke-Siti më 24 tetor 2010.

SHËNIME

1. James E. Faust, “Enriching Family Life”, *Ensign*, maj 1983, f. 41.
2. Susan Heaton, “Talk Time Instead of TV Time”, *Ensign*, tetor 1998, f. 73.
3. Jeffrey R. Holland, “Witnesses unto Me”, *Liahona*, korrik 2001, f. 16.
4. George D. Durrant, “Pointers for Parents: Take Time to Talk”, *Ensign*, prill 1973, f. 24.



BORONICAT DHE LIBRI I MORMONIT

Disa vite më parë, familja jonë u shpërngul nga një zonë e rrahur dhe e mbipopulluar qyteti në një pronë të vogël bujqësore në skaj të një fshati të vogël e të qetë. Aty pranë ishte një fermë e braktisur boronicash dhe falë miqve dhe pronarit, ne morëm leje për të këputur sa boronica të dëshironim.

Disa mëngjese çdo javë gjatë asaj vere, ne futeshim të gjithë në makinë

me kova e çanta dhe kalonim një orë zbavitëse e të kënaqshme duke mbledhur boronica. Një mëngjes, djali ynë më i vogël, Hajrëmi dukej ngurrues për të na shoqëruar. Ai ishte i sigurt se kishte mbledhur çdo boronicë të mundshme dhe se do ta çonte kohën dëm nëse shkonte përsëri. Sa u habit ai kur gjeti më shumë boronica se kurrë. Kishte grumbuj [boronicash] në vende ku ai kishte

stërparë dhe disa nga boronicat më të lëngshme po rriteshin në degët ku ai ishte i sigurt se kishte kërkuar më parë.

Në të njëjtën kohë, udhëheqësit e lagjes për rininë e vënë adoleshentët përpara një sfide për ta lexuar të gjithë Librin e Mormonit atë gusht përpara se të fillonte shkolla. Fëmijët tanë na lajmëruan për këtë sfidë dhe familja jonë u zotua që të bashkohej me ta në përpjekjet e tyre.

Ne e kishim përfunduar Librin e Mormonit pak përpara se të vinte revista *Ensign* e gushtit të vitit 2005,

Hajrëmi ishte i sigurt se kishte mbledhur çdo boronicë të mundshme dhe se do ta çonte kohën dëm nëse shkonte përsëri në fermën e boronicës.



me sfidën e presidentit Gordon B. Hinkli (1910–2008) që ta lexonim të gjithë Librin e Mormonit deri në fund të atij viti. Hajrëmi dhe vëllai i tij Jozefi, qenë të emocionuar – nga mendimi se ne i ishim bindur tashmë profetit! Pastaj vëllai dhe motra më e madhe, Sethi dhe Bethëni, u kujtuan atyre se Presidenti Hinkli na kishte kërkuar ta lexonim atë përsëri, pavarësisht sa herë ne e kishim bërë këtë tashmë.

“Po pse?” pyeti djali. “Ne e kemi lexuar çdo fjalë dhe çfarë ka më tepër për të mësuar përveç asaj që kemi lexuar tashmë?”

Pas disa çastesh qetësie, dikush përmendi boronicat. “Ju kujtohet kur ne menduam se i kishim mbledhur gjithë boronicat? Por kur ne u kthyem, kishte gjithmonë më shumë boronica – gjithmonë! Pavarësisht sa herë shkuam ne, pavarësisht sa shpesh, gjithmonë do të kishte boronica pranë vileve.”

Ne e kuptuam menjëherë lidhjen. Njësoj si ferma aty pranë dhe furnizimi i saj i bollshëm me boronica të shijshme, Libri i Mormonit është një burim i vazhdueshëm i ushqimit shpirtëror me të vërteta të reja për t’u zbuluar. Kështu ne filluam ta lexonim edhe një herë Librin e Mormonit.

Ndërsa pranova sfidën e profetit, unë lexova gjëra që i kisha lexuar shumë herë më parë në Librin e Mormonit, por i pashë me një sy tjetër ose i kuptova se si viheshin në zbatim për rrethana ose sfida të reja. Unë e di se çdo herë që ne e lexojmë sinqerisht Librin e Mormonit, ne mund të marrim mendime të reja dhe të afrohem më pranë me Shpëtimtarin. ■
Suelen S. Uailer, Xhorxha, SHBA

UNË NDIIEVA SE DUHET TË VIJA

Dy vite e gjysmë pas pagëzimit tim në Buenos-Ajres, në Argjentinë, ende më duket sikur më tingëllojnë në vesh fjalët e njërit prej misionarëve që më kishte dhënë mësim: “Unë e di se ti je një misionar”. M’u kujtua edhe përgjigja e fuqishme që mora kur u luta për të ditur nëse ndjenja që më kishte përshkuar zemrën, ishte njëmend e vërtetë. Në moshën 20-vjeçare, unë e dija se duhet të përgatitesha për një mision.

Por si mund të isha një misionar? Unë nuk i ngajaja fare të rinjve engjëllorë që më mësuan ungjillin. Dhe si mund ta lija punën time? Ku do të jetoja pasi të kthehesha në shtëpi? Kishte qenë shumë e vështirë ta gjeja shtëpinë që kisha, megjithëse ishte thjesht një dhomë e vogël në anën e prapme të shtëpisë së dikujt.

Gjatë rrugës për në shtëpi një mbrëmje, këto ndjenja dhe dyshime më erdhën sërish në mendje. Kur arrita në shtëpi, u përpoqa të merrja një vendim. Unë vendosa të gjunjëzohesha dhe të bëja një lutje për ndihmë. Ndërsa veprova kështu, pata një përshtypje të fortë se duhet të shkoja të takoja Leandron, një mik që kishte qenë një burim i madh force për mua në çaste të trishtuara.

Por mendimi se do ta zgjoja në mesnatë bëri që unë ta kundërshtoja këtë ide. E dija se ai zgjohej herët në mëngjes që të shkonte në punë dhe nuk dëshiroja t’i trokisja në derë në atë orë. Unë luftova kundër mendimit, por vazhdova ta ndieja përshtypjen se duhet të shkoja ta takoja. Sërish,

Kur hyra, pashë Leandron të ulur në dhomën time. Shpirti ra mbi mua dhe mbeta pa frymë.

zgjodha ta shpërfillja atë.

Në vend të kësaj, unë vendosa të shëtisja në lagje për ajër të pastër. Megjithatë, kur u kujtova se e kisha lënë derën hapur, u ktheva për në shtëpi. Kur hyra, pashë Leandron të ulur në dhomën time. Shpirti ra mbi mua dhe mbeta pa frymë. Me një zë të mbytur disi nga emocioni, e pyeta atë: “Çfarë bën ti këtu?”

“Nuk e di”, tha ai. “Unë thjesht ndieva se duhet të vija të të shihja.”

I tregova atij rreth dyshimeve që kisha pasur për misionin. Ai ndau dëshminë e tij me mua dhe më nxiti. Pastaj më ndihmoi të plotësoja dokumentet e misionit, të cilat ia çova peshkopit tim mëngjesin vijues. Dy muaj më vonë, mora thirrjen për në misionin e Saltës në Argjentinë.

E di se miku im ishte një mjet në duart e Perëndisë atë natë dhe me gjithë zemër, e di që Ati Qiellor i dëgjon dhe u përgjigjet lutjeve që bëhen me një zemër të sinqertë dhe me synim të vërtetë. ■
Aldo Fabio Moraka, Nevada, SHBA



UNË DO TË VDES!

Kur punoja si infermiere në një pavion plot punë për shërimin pas ndërhyrjeve kirurgjikale, një ditë unë mora një telefonatë lidhur me një pacient të quajtur Bill, që sapo i ishte nënshtruar operacionit. Ai duhet të kishte shkuar në pavionin e reanimacionit, por ishte caktuar tek unë për shkak se ai pavion ishte plot.

Pacienti pas pak mbërriti tek unë bashkë me familjen e tij. U ndieva e lehtësuar kur pashë se ai ishte zgjuar, e dinte çfarë kishte ndodhur e ku ndodhej dhe nuk ishte në gjendje të dukshme vuajtjeje.

Pasi i mata pulsën, tensionin e gjakut e temperaturën dhe pasi i tregova atij e familjes për dhomën e tij, unë dola në korridor për të bërë një shënim në kartelën e tij. Sapo stilolapsi im preku letrën unë dëgjova

një zë të thoshte: “Kthehu në dhomën e tij”. Unë ndalova së shkruari dhe pashë prapa. Atje s’kishte njeri. Unë mendova se zëri ishte në imagjinatën time, kur papritmas e dëgjova atë për herë të dytë – veçse më fort.

Unë vrapova për te dhoma e Billit dhe pashë se qafa e tij ishte dyfishuar në përmasë dhe ai kishte probleme me frymëmarrjen. Duke menduar se arteria e tij e qafës kishte plasur, unë ushtrova trysni te qafa e tij me dorën time të djathtë ndërsa e përdora dorën time të majtë për të marrë në telefon kirurgun që kishte kryer ndërhyrjen. Kirurgu tha se ai do të dërgonte një ekip që ta merrte Billin sa më shpejt të ishte e mundur. “Dhe mos e hiq dorën prej andej!” tha ai.

Ndërsa vazhdoja t’i shtypja qafën, unë vura re një libër të njohur Kishe pranë shtratit të Billit. “Je anëtar i Kishës?” pyeta unë.

Ai u përpoq të pohonte me kokë dhe më pas më tha se ai ishte një punonjës ordinancash në tempullin e

Kirurgu tha se ai do të dërgonte një ekip që ta merrte Billin sa më shpejt të ishte e mundur. “Dhe mos e hiq dorën prej andej!” tha ai.

Atlantas në Xhorxhia. Më pas ai përpëlliti sytë duke lotuar dhe tha: “Unë do të vdes!”


Unë i thashë se nuk kishte për të vdekur, duke i thënë me vendosmëri: “Unë do të martohem në tempullin e Atlantës muajin që vjen dhe ti ke për të qenë atje”. Më pas mbërriti ekipi i kirurgjisë dhe e morën Billin me të shpejtë.

Nga entuziazmi i planeve të dasmës muajin që vinte, unë pothuajse e harrova Billin, që siç rezultoi kishte pasur reaksion nga mjekimi. Por ndërsa bashkëshortja e presidentit të tempullit më drejtoi për te dhoma e vulosjes ditën e martesës time, unë pashë një fytyrë të njohur: Bashkëshorten e Billit, Xhorxhian. Kur i thashë asaj se pas pak do të martohesha, ajo shkoi të gjente Billin. Pak çaste përpara se të fillonte ceremonia, dera u hap dhe ai hyri. Pas disa javësh me dhembje koke, të vjella dhe ndjesi lodhjeje, Billi ishte ndier mjaft mirë atë ditë për të udhëtuar për në tempull, pa e ditur se ishte dita e martesës time.

Dy vjet më vonë, bashkëshorti im dhe unë, u thirrëm për të punuar si punonjës ordinancash në tempullin në Neshvill të Tenesit. Kur arritëm në tempull për t’u veçuar, një zotëri i sjellshëm e mbajti derën hapur për mua dhe tha: “Mirëseerdhët në tempullin e Neshvillit!” Ishte Vëllai Bill.

Ne shërbyem së bashku për tri vite. Billi u tha të gjithëve se unë i kisha shpëtuar jetën, por unë e dija se atë e kishte shpëtuar Shpëtimtari. Gjatë procesit, Ai më kishte mësuar rëndësinë e të mbajturit vesh ndaj nxitjeve të Shpirtit. ■

Ramona Ros, Tenesi, SHBA



NDOSHTA NE DUHET TË LUTEMI

Në pranverën e vitit 1975, familja ime dhe unë, po jetonim në një fermë të bukur e të gjelbërt në zonën Rajnland-Falc të Gjermanisë Perëndimore. Gjatë kthimit në shtëpi nga kisha me makinë, një të diel me shi, ne nda luam për t'i hedhur një vështrim një automjeti që ishte rrokullisur përmbys në rripin e lagur të rrugës buzë një pylli. Brenda në pyll, tashmë ishte errësirë për shkak të çatisë së dendur të krijuar nga pemët dhe natës që po afronte.

Pasi e pamë automjetin e zhytur, ne u kthyem në makinën tonë dhe zbuluam se ajo kishte ngecur në baltë. Unë s'mund të ecja prapa, por mund ta ngisja makinën përpara – për t'u futur në pyll. Ne kishim kaluar më parë me makinë përgjatë pyllit dhe kishim zbuluar se shumë rrugë të pyllit ishin të lidhura mes tyre dhe do të na nxirrnin jashtë, kështu që unë vendosa të vazhdoja përpara në errësirë.

Shpejt e kuptova se kisha marrë vendimin e gabuar. Rruga e ngushtë dhe e lagur ishte e mbushur me gjurmë të thella balte nga makinat dhe ato të çonin larg e më larg brenda pyllit të errët. U përpoqa të shtoja shpejtësinë, duke pasur frikë që, nëse ndalohem, ne do të bllokohehim [në baltë]. Unë pashë një pikë të lartë përpara që dukej mjaft e qëndrueshme për të mbajtur peshën e një makinë. Plani im ishte që ta nxirrja makinën nga balta që t'i jepja vetes kohë për t'u menduar. Makina u çlirua dhe doli nga balta.

E fika makinën dhe dola jashtë. Me dritat e përparme të fikura, unë

I ndeza dritat e përparme sërish, mora elektrikun tonë të dorës dhe, pasi e kontrollova makinën, vendosa se gjëja më e mirë që mund të bëja ishte të kthehesha në pyll.

s'mund të shihja gjë prej gjëje. I ndeza dritat e përparme sërish, mora elektrikun tonë të dorës dhe, pasi e kontrollova makinën, vendosa se gjëja më e mirë që mund të bëja ishte të kthehesha në pyll dhe më pas të nxitoja drejt rrugës nga e cila erdhëm.

U ktheva sa më prapa në pyll që mundesha, i dhashë pak superxhiro motorit, u zgjata prapa për në rrugë dhe u zhyta thellë në baltë. Tani ishim vërtet në telashe. Jashtë makinës ishte kudo errësirë dhe qetësi. Brenda makinës bashkëshortja ime dhe unë, u ulëm me tri fëmijët tanë të tmerruar.

E pyeta bashkëshorten time për ndonjë ide. Pas një çasti ajo tha: "Ndoshta ne duhet të lutemi". Fëmijët u qetësuan pothuajse menjëherë. Unë bëra një lutje të përlur, por të

dëshpëruar për ndihmë. Ndërsa lutesha, një mendim më erdhi qartësisht në mendje: "Vendos zinxhirët e gomave".

Duke qëndruar 10 inç (25 cm) në baltë me fustanin e saj të së dielës, bashkëshortja ime e ëmbël, mbajti elektrikun e dorës ndërsa unë pas-troja gomat e pasme me duart e mia të zhveshura dhe vendosa zinxhirët. Me besim dhe siguri, ne u lutëm sërish dhe ndezëm motorin. Ngadalë ne e përshkuam me makinë baltën dhe dolëm përfundimisht në asfalt.

Nga entuziazmi i të qenit të lirë nga balta dhe errësira, unë pothuajse e harrova se kush na kishte ndihmuar të dilnim nga pylli. Bija jonë pesëvjeçare ma kujtoi kur tha: "Babi, Ati Qiellor vërtet u përgjigjet lutjeve, apo jo?" ■
Skot Edgar, Juta, SHBA



Të Gjithë e Njohin Bllekun

Nga Adam C. Olson

Revistat e Kishës

Për Honora “Bleku” Bonet-in, basketbolli ishte gjithçka që i interesonte. Në moshën 15-vjeçare, Blleku ishte një yll në ngritje në Polinezinë Franceze – një nga lojtarët më të mirë që luante për një nga ekipet më të mira në formacionin më të mirë për të rriturit në vend. Edhe pse pseudonimi i tij që një gabim drejtshkrimi i fjalës në anglisht *black [e zezë]*, nuk kishte asnjë gabim në talentin e tij.

Por ai dëshironte më shumë. Ai dëshironte të luante si profesionist në Europë. Dhe më shumë se gjithçka, ai dëshironte që të fitonte një medalje të artë në Lojërat e Paqësorit Jugor.

Honora “Bleku” dhe Miranda Boneti kanë qenë të angazhuar prej shumë kohësh me basketbollin në Tahiti.

Pengesa e vetme që dukej se i dilte përpara, ishte Kisha.

Një Djalë në Mision

Megjithëse skuadra për të cilën luante Blleku në atë kohë mbështetej nga Kisha, Blleku kishte pak interes për Kishën apo thirrjen e profetit që çdo i ri i denjë dhe i aftë të shërbente në një mision.

Ai i kishte thënë tashmë peshkopit të tij se nuk do të shkonte në mision. Ai nuk e kuptonte se si mund të luante si profesionist nëse largohej për dy vjet.

Për më tepër, Lojërat e Paqësorit Jugor – që mbaheshin çdo katër vjet – do të organizohehin gjatë misionit të tij dhe Federata e Basketbollit e Tahitit që e interesuar që ta vinte atë të luante për ekipin kombëtar. Ai më në fund do të kishte një mundësi që t’u jepte fund atyre fjalëve që i thoshte i ati sa herë që Bllekut fillonte t’i hipte vetja në qejf: “Të gjithë e njohin Bllekun, por ai nuk ka një medalje të artë”.

I ati i Bllekut, Zhan-Baptisti, i thoshte ato fjalë me një kuptim të mirë. Por ato e mërznin Bllekun. Ato ishin një kujtues që, edhe pse tifozët e basketbollit kudo në Tahiti e njihnin atë, ai nuk kishte një medalje të artë nga ndeshjet. I ati i tij kishte fituar një medalje të artë me ekipin e meshkujve gjatë Lojërave të para të Paqësorit Jugor.

Ishte misioni i Bllekut që të vërtetonte se ato fjalë ishin të gabuara. Ai nuk kishte kohë për ndonjë mision tjetër.



Dashuria e Bllekut për basketbollin ka qenë në të njëjtën kohë një provë dhe një bekim.





“Lumturia vjen nga jetesia sipas mënyrës si dëshiron Zoti që ju të jetoni.”

Presidenti Tomas S. Monson, “Përgatitja Sjell Bekime”, *Liahona*, maj 2010, f. 67.

Një Ndryshim Mendjeje, një Ndryshim Zemre

Pavarësisht ndjenjave të tij rreth një misioni, Blleku gjithsesi merrte pjesë në aktivitetet e Kishës. Në një vallëzim të Kishës, kur ishte 16 vjeç, Blleku mori guximin për t'i kërkuar Miranda Mariteraxhit që të vallëzonin. Miranda ishte një lojtare e mirë basketbolli gjithashtu – me ëndrra që të fitonte medaljen e saj të artë. Edhe i ati i saj kishte qenë në ekipin e parë fitues të medaljes.

Pak sekonda pasi ai i kërkoi të vallëzonin, kënga mbaroi. Kështu që ata vallëzuan gjatë këngës vijuese, që rezultoi të ishte e fundit për atë mbrëmje. Në atë kohë, Blleku nuk dëshironte që vallëzimi të mbaronte.

Blleku nuk kishte planifikuar të martohej në tempull e as madje të martohej me një anëtare për aq sa kishte rëndësi. Por kjo filloi të ndryshojë ndërsa ai arriti ta njihje Mirandën më mirë gjatë dy viteve vijuese. Një ditë në shtëpinë e saj, atij ia tërhoqi vëmendjen diçka që ajo kishte bërë te Të Rejat. Aty lexohej: “Unë do të martohem në tempull”.

Interesi i Bllekut për Mirandën dhe zotimi i saj i përkushtuar ndaj martesës në tempull qenë të mjaftueshëm për ta bërë atë t'i rishqyrtonte planet e tij. Ai vendosi që të fillonte ta merrte Kishën seriozisht. Vendimet e tij e çuan në veprime që e lejuan Frymën e Shenjtë të vepronte në jetën e tij.

Vendimi

Një nga ato vendime që të përgatitej për të marrë një bekim patriarkal në moshën 18-vjeçare. Kur patriarku tha gjatë bekimit se Blleku do të shërbeonte në një mision dhe do të martohej në tempull, ai ndieue Shpirtin. “E dija se kjo është ajo që Perëndia dëshironte që unë të bëja”, tha ai.

Edhe pse ekipi kombëtar dukej sikur kishte mundësi për të fituar medalje, Blleku vendosi, me mbështetjen e familjes së tij, se ai do të vendoste atë që dëshironte Perëndia përpara asaj që dëshironte ai. Vendimi nuk qe i lehtë. Presioni për të luajtur ishte i madh. Dhe ai shpejt mësoi që vendimi i tij për t'iu nënshtruar vullnetit të Perëndisë do të vihej në provë më shumë se një herë.

Pasi kishte shërbyer si misionar në Tahiti për një vit, federata e basketbollit i kërkoi nëse ai mund të kthehej në ekip që të merrte pjesë në ndeshje vetëm për një muaj.

Presidenti i misionit i Bllekut, i shqetësuar për ndikimin që do të kishte përvoja mbi aftësinë e Bllekut që të kthehej dhe të shërbente, u ndie i frymëzuar që t'i thoshte atij: “Ti mund të ikësh nëse dëshiron, por ti nuk mund të kthehesh”.

Blleku e dëshironte atë medalje, por ai nuk e dëshironte atë mbi çdo gjë tjetër. Misioni i tij kishte qenë i mrekullueshëm. Ai nuk qe i gatshëm të hiqte dorë nga viti i tij i fundit, madje as për basketbollin.

Blleku qëndroi.

Ekipi e fitoi medaljen e artë.

Rrethana të Ndryshme, Vendim i Njëjtë

Pasi Blleku e përfundoi misionin e tij me nder, ai u martua me Mirandën në tempullin e Papitit në Tahiti dhe ata krijuan një familje. Ai nisi të luante përsëri për ekipin kombëtar.

Miranda po luante si sulmuese kryesore në ekipin kombëtar të grave dhe po përgatitej për Lojërat e Paqësorit Jugor.

Megjithatë, ndërkohë që lojërat afroheshin, çifti filloi të ndiente fuqishëm se ata duhet të kishin një fëmijë të dytë.

Me ndeshjet e ardhshme që ishin më pak se një vit larg, do të kishte qenë e lehtë ta shtynin një fëmijë tjetër aq kohë sa të mjaftonte që Miranda të luante. Ekipi i vajzave kishte shumë mundësi për të fituar medalje.

Por çifti kishte mësuar nga përvoja se nënshtrimi i vullnetit të tyre ndaj Perëndisë sillte





bekime më të mëdha se ç'mund të dëshironte çdokush nga ndjekja e vetë dëshirave të tyre. Pas studimit dhe lutjeve të kujdesshme, ata vendosën të vinin familjen e tyre të parën.

Në vitin 1999, ndërsa Miranda ishte tetë muajshe shtatzënë, ekipi i femrave fitoi medaljen e artë.

Të Gjithë e Njohin Bllekun

Blleku dhe Miranda kanë qenë në gjendje të luanin basketboll në nivelet më të larta në Polinezinë Franceze gjatë dhjetëvjeçarit të fundit – duke fituar kampionate në ligën kombëtare e kupa turnesh si dhe kanë luajtur me ekipin kombëtar gjatë ndeshjeve të viteve 2003 dhe 2007.

Në ndeshjet e vitit 2011, morën pjesë të dy, veçse këtë herë Blleku ndodhej atje në rolin e trajnerit të ekipit të meshkujve. Ndërsa Miranda dhe ekipi i femrave fituan medaljen e artë, ekipi i meshkujve fitoi medaljen e bronzit, duke mos e arritur përsëri ëndrrën e Bllekut për medalje të artë.

Blleku ndonjëherë vriste mendjen se si do të kishte qenë jeta e tij nëse ai do të kishte

bërë atë që dëshironte në vend të asaj që dëshironte Perëndia.

“Unë ndoshta do të kisha një medalje të artë”, tha ai. “Ndoshta do të kisha luajtur si profesionist, ndoshta jo.”

Por çifti nuk pendohet për vendimet që ka marrë. Ata nuk janë të sigurt se si mund të kishin qenë më të lumtur.

“U martova në tempull”, tha Blleku. “Unë kam një bashkëshorte të shkëlqyer, katër fëmijë të bukur dhe jam ende në Kishë. Vetëm basketbolli nuk do mund të më jepte asgjë nga këto. Ato janë bekime që kanë ardhur, sepse e vumë Zotin të parin.”

Vënia e Zotit në radhë të parë nuk e ka ndaluar ngacmimin e të atit, por i ka dhënë atyre fjalëve një kuptim të ri. Pak vite më parë, kur federata po merrte në konsideratë t'i planifikonte ndeshjet e ligës të dielave, presidentët e klubit u takuan për të diskutuar rreth kësaj. Dikush pyeti: “A e pyetët Bllekun?”

Propozimi u rrëzua.

Për shkak se Blleku e ka vënë Zotin të parin, jo vetëm që të gjithë e njohin Bllekun – ata e dinë se çfarë beson ai. ■

Për Bllekun dhe Mirandën, sukcesi në sportin e tyre ka qenë një përparësi më e vogël se sukcesi në familjen e tyre.

“Përse duhet të shkoj në seminar kur thjesht mund t’i studioj shkrimet e shenjta në mënyrë të pavarur?”

Ju do të keni gjithë pjesën tjetër të jetës tuaj për t’i studiuar shkrimet e shenjta më vete, kështu që, nëse është i disponueshëm për ju, përfitoni nga mundësia për t’i studiuar shkrimet e shenjta në seminar me mësues dhe shokë të shkëlqyer tani.

Nxënia dhe studimi nën drejtimin e një mësuesi të mirë ju ndihmon të fitoni mprehtësi të re për shkrimet e shenjta që ju nuk mund t’i keni kuptuar me të vërtetë më parë. Mësuesi mund të ndajë me ju mësimet nga profetët dhe udhëheqës të tjerë të Kishës që ju japin një kuptueshmëri më të mirë të shkrimeve të shenjta.

Gjithashtu, është gjithmonë më e kënaqshme të mësosh me klasën. Ju do të keni mundësi të flisni rreth gjërave që zbuloni ndërsa lexoni. Shokët tuaj të klasës mund të kenë pasur përvoja që i kanë bërë disa shkrime të parapëlqyerat e tyre. Të dëgjuarit e përvojave mund t’i bëjë shkrimet që t’ju duken më të gjalla. Dhe ngaqë ju e studioni ungjillin me të tjerët, ju mund të gëzoni këtë bekim të premtuar: “Kudo që dy a tre janë mbledhur së bashku në emrin tim, . . . atje do të jem unë në mes tyre” (DeB 6:32).

Seminari ndërton gjithashtu një strukturë për studimin tuaj. Ju nxiteni të lexoni me një ritëm të caktuar, që ju ndihmon të përfundoni çdo libër të shkrimeve. Ju keni mundësinë për të diskutuar dhe për t’i mësuar përmendësh vargjet e mjeshtërisë së shkrimeve të shenjta. Ju mund të siguroheni që do të fitoni më shumë prej shkrimeve të shenjta duke ndjekur seminarin sesa me ndonjë mënyrë tjetër gjatë kësaj kohe të jetës suaj.

Miq të Rinj, Ide të Reja



Në seminar ju takoni shokë të rinj dhe ju bëheni të afërt për njëri-tjetrin, si një familje. Ju mësoni shumë gjëra të reja që nuk do i dinit nga vetja. Është zbatimëse dhe shumë shpirtërore. Ai të siguron se ju e nisni ditën siç duhet. Nëse nuk merrni pjesë tani, fillojeni dhe do t’ju ndryshojë jetën.

Katerina B., 16 vjeçe, Kaliforni, SHBA

Lumturia



Seminari hap ditën time. Ai më bën njeri më të lumtur dhe më të gatshëm për të diskutuar rreth ungjillit me njerëz të tjerë. Ne i diskutojmë më në thellësi shkrimet, kështu që unë kuptoj më shumë.

Madi S., 15 vjeçe, Kolorado, SHBA

Kombinim i Përsosur



Seminari është një përvojë lartësuese. Ndonjëherë nuk mjafton thjesht të studiosh më vete. Studimi vetjak dhe seminari janë një kombinim i përsosur.

Mësuesit janë të mahnitshëm dhe, nëse keni ndonjë pyetje, mësuesit dhe shokët tuaj të klasës mund t’ju ndihmojnë të merrni përgjigje.

Douzon D., 15 vjeç, Ajdaho, SHBA

Më Shumë Kuptueshmëri



Kur i studioj shkrimet e shenjta vetëm, unë nuk argëtohem aq shumë sa kur i studioj me të tjerët. Për më tepër, ne mund të mësojmë ide interesante nga të tjerët kur i studiojmë shkrimet e shenjta së bashku. Gjatë seminarit unë kam mësuar rreth shumë historive interesante dhe unë di më shumë për ngjarjet e shkrimeve të shenjta që e bën studimin shumë më emocionues! Unë jam e gëzuar që vendosa të ndjek seminarin.

Rebeka M., 16 vjeçe, Shlesvig-Holshtajn, Gjermani

Përgjigjet symojnë të japin ndihmë dhe këndvështrim, jo si deklarime zyrtare të doktrinës së Kishës.

Dëshmi më e Fortë



Së pari, Zoti thotë se kudo që dy a tre njerëz janë mbledhur në emrin e Tij, Ai do të jetë në mes tyre (shih Mateo

18:20; DeB 6:32). Të ndierit e Shpirtit të Tij mund të na ndihmojnë të meditojmë për atë që Ai ka bërë për ne. Së dyti, kur i studiojmë shkrimet e shenjta me të tjerët, ne mund të kuptojmë më mirë atë që është shkruar. Ndërsa i mbajmë vesh të tjerët, mund të dëgjojmë diçka që nuk e kemi dalluar vetë dhe e njëjta gjë mund të ndodhë me të tjerët kur ne ndajmë njohurinë tonë. Së treti, kur shkoj në seminar, dëshmia ime forcohet. Seminari është një mundësi për të ndarë dëshmitë tona dhe për t'i dëgjuar dëshmitë e njerëzve të tjerë. Kjo na ndihmon të qëndrojmë në shtegun e drejtë.

Dmitri G., 16 vjeç, Dnipropetrov'sk, Ukrainë

Të Mësosh nga të Tjerët



Vajtja në seminar është një domosdoshmëri për mua. Mësuesi im i përkushtuar, jo vetëm që jep mësim dhe

shpjegon të vërtetat që gjenden në shkrimet e shenjta, por unë mësoj kaq shumë edhe nga diskutimet tona në klasë. Studentët e tjerë tregojnë përvojat e tyre rreth gjërave që kanë mësuar dhe ata më kanë ndihmuar mua të fitoj më shumë njohuri rreth ungjillit dhe Shpëtimtarit e Shlyerjes së Tij. Nuk është e mjaftueshme të studioj më vete, pasi unë i kam gjetur disa nga përgjigjet për problemet e mia nga diskutimet në klasë. Unë mund të dëshmoj se seminari luan një rol jetësor në ushqyerjen e dëshmisë time për Kishën e vërtetë të Jezu Krishtit.

Denzel J., 15 vjeç, Samoa Perëndimore

Drita dhe e Vërteta



Kur shkoj në seminar, unë kërkoj dritën e të vërtetën dhe marr mbi vete gjithë armatimin e Perëndisë (shih DeB

27:15–18). Ai armatim më ndihmon të dalloj zërin e Tij në të gjitha kohët dhe në të gjitha vendet. Studimi i përditshëm i shkrimeve të shenjta e forcon besimin e dëshminë time dhe më ndihmon të jem e fortë në sprovat e mia. Pjesëmarrja në seminar është një nga mënyrat më të mira për të gjetur dritën e të vërtetën dhe për të studiuar shkrimet e shenjta e për të medituar.

Noemi M., 17 vjeçe, Puebla, Meksikë

Tri arsye

Së pari, unë marr pjesë në seminar sepse unë dua të shërbej në një mision. Misionarët duhet të ngrihen herët në mëngjes dhe të studiojnë ungjillin në mëngjes. Pjesëmarrja në seminar më ndihmon të zhvilloj një zakon të mirë të zgjimit herët në mëngjes. Së dyti, në mëngjes, ne jemi mendjekthjellët, kështu ne mund të përqendrohemi tek nxënia dhe studimi. Është gjë e mençur t'i përdorësh orët më të mira të ditës për të mësuar rreth Perëndisë. Së treti, nëse

unë studioj më vete, unë nuk mund të kem një kuptueshmëri aq të thellë sa e ka mësuesja ime. Me udhëzimin dhe mësimin e saj, unë mund të mësoj shumë më tepër sesa mundem të mësoj vetë.

H. Çen Juan, 16 vjeç, T'ai-çung, Tajvan



BEKIMET E SEMINARIT

“Unë e njoh fuqinë që vjen nga përfshirja në programet e seminarit dhe institutit. Kjo e ka përmirësuar jetën time

dhe unë e di se do të bëjë të njëjtën gjë për ju. Kjo do të vendosë një strehë mbrojtjeje rreth jush për t'ju mbajtur të lirë nga tundimet dhe sprovat e botës. Të kesh një njohuri për ungjillin është një bekim i madh. Dhe unë nuk di ndonjë vend më të mirë ku të rinjtë e Kishës të fitojnë një njohuri të veçantë të gjërave të shenjta sesa në programet e institutit dhe seminarit.”

Plaku L. Tom Perry, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, “Receive Truth”, Ensign, nëntor 1997, f. 61–62.

PYETJA E RADHËS

“Si t’ia shpjegoj mikut tim se të thyesh ligjin e dëlirësisë është një ide e gabuar?”

Parashtrojeni përgjigjen tuaj deri më 15 maj 2012, në adresën liahona.lds.org, me postë elektronike në adresën liahona@ldschurch.org, ose me postë të thjeshtë në adresën:

Liahona, Questions & Answers 5/12
50 E. North Temple St., Rm. 2420
Salt Lake City, UT 84150-0024, USA

Përgjigjet mund të redaktohen lidhur me gjatësinë apo qartësinë.

Duhet të përfshihen të dhënat dhe leja si vijon: 1) emri i plotë, 2) data e lindjes, 3) lagjia ose dega, 4) kunji ose distrikti, 5) leja juaj me shkrim dhe, nëse jeni nën moshën 18 vjeç, leja me shkrim e prindit tuaj (postimi elektronik pranohet) për botimin e përgjigjes dhe të fotografisë tuaj.

PËRSE DUHET TA NDJEKIM Seminarin?

MERRNI PJESË NË SEMINAR


Seminari do t'ju ndihmojë të kuptoni dhe të mbështeteni tek mësimet dhe Shlyerja e Jezu Krishtit. Ju do të ndieni Shpirtin e Zotit ndërsa mësoni t'i doni shkrimet e shenjta. Ju do të përgatiteni për tempullin dhe për shërbimin misionar.

Të rinj e të reja, unë ju kërktoj juve të merrni pjesë në seminar. Studiojini për ditë shkrimet tuaja të shenjta. Dëgjojini me kujdes mësuesit tuaj. Zbatojeni me lutje atë që mësoni."

Presidenti Thomas S. Monson,
"Participate in Seminary",
seminary.lds.org.

Cila mendoni ju, është gjëja më e rëndësishme që një student mund të fitojë nga seminari dhe instituti? Kur një grup studentësh të seminarit ia bënë të njëjtën pyetje Komisionerit të Sistemit Arsimor të Kishës, Plakut Paul V. Xhonson, të Të Shtatëdhjetëve, ai u përgjigj se gjëja më e rëndësishme që ju mund të fitoni është "dëshmia e vërtetë se Jezusi është Krishti. Të kuptuarit që njohuria e vërtetë është njohuria shpirtërore. Është ajo që na vjen përkatësisht në shpirtirat tanë nga Fryma e Shenjtë. Kjo është e vërteta më e fuqishme, gjëja më e fuqishme që mund të mësohet nga seminari dhe instituti. Ajo nuk ndryshon vetëm atë që dini, ajo ndryshon atë që jeni dhe ndryshon mënyrën se si e kuptoni botën. Dhe ky lloj arsimimi më i lartë ju ndihmon që ta bëni të plotë llojin tjetër të arsimimit" ("A Higher Education", *New Era*, prill 2009, f. 15).

Plaku Xhonson është një nga Autoritetet e shumta të Përgjithshme që kanë folur për bekimet e mrekullueshme që vijnë nga pjesëmarrja në seminar dhe institut. Kështu, nëse jeni duke vrarë mendjen se përse duhet të shkoni në seminar, këtu ka më shumë arsye të mira nga profetët dhe apostujt.



NDËRTONI NJË THEMEL PËR LUMTURI DHE SUKSES

"Programet e seminarit do t'ju ndihmojnë ju si një i ri ose e re që të ndërtoni një themel për lumturinë dhe suksesin në jetë."

Plaku Richard G. Scott, i Kuoromit të Dymbëdhjetë Apostujve, "Now Is the Time to Serve a Mission!" *Liahona*, maj 2006, f. 88.





MËSOJINI TË VËRTETAT E UNGJILLIT

“Unë uroj që çdo djalë dhe vajzë të mund të shkojë në seminar, pasi ai është vendi ku ata i mësojnë shumë të vërteta të ungjillit. Seminari është vendi ku shumë prej tyre i sistemojnë idealet në mendjet e tyre rreth asaj që do të bëjnë dhe ata shkojnë në misione.”

Presidenti Spencer W. Kimball (1895–1985), “President Kimball Speaks Out on Being a Missionary”, *New Era*, maj 1981, f. 49.

JEPINI PËRPARËSI

“Studentë, nëse ju keni vlera të përcaktuara, ju nuk do të ngurroni që të hiqni dorë nga një orë mësimore me zgjedhje, që mund t’ju bëjë jetën zbavitëse, përpara një ore mësimore që udhëzon, e cila mund ta mbajë fort themelin e vërtetë të jetës.

Pastaj, pasi të jeni regjistruar, merrni pjesë, studioni dhe mësoni. Bindini miqtë tuaj të bëjnë të njëjtën gjë. Ju nuk do të pendoheni kurrë për të; këtë jua premtoj.”

Presidenti Boyd K. Packer, President i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, “Agency and Control”, *Ensign*, maj 1983, f. 67.



FTOJINI BEKIMET NË JETËN TUAJ

“Unë jam mirënjohës për sistemin e seminarit në Kishë dhe për programin e Kishës për institutin. Unë dua ta nxis çdo nxënës të shkollës së mesme këtu që të përfitojë nga programi i seminarit. Jeta juaj do të bekohet më shumë nëse e bëni këtë.”

Presidenti Gordon B. Hinckley (1910–2008), “Excerpts from Recent Addresses of President Gordon B. Hinckley”, *Ensign*, dhjetor 1995, f. 67.

ZBULONI TRI GJËRA QË SEMINARI MUND TË BËJË

“Ka tri gjëra të fuqishme që seminari mund të bëjë. Së pari, ai i bashkon të rinjtë që kanë të njëjtat vlera të përbashkëta. Të rinjve u pëlqen të jenë me të tjerë që kanë të njëjtin besim me ta dhe që i duan shkrimet e shenjta. Së dyti, ai i bashkon të rinjtë me një mësues që ka një dëshmi dhe ata mund ta ndiejnë fuqinë e asaj dëshmie ndërsa lind. Së treti, seminari i mban të rinjtë të interesuar për shkrimet e shenjta.”

Presidenti Henry B. Eyring, Këshilltar i Parë në Presidencën e Parë, “A Discussion on Scripture Study”, *Liahona*, korrik 2005, f. 11.

DIPLOMOHUNI NË SEMINAR

“Merrni pjesë rregullisht në seminar dhe diplomohuni. Udhëzimi në seminar është një nga përvojat më domethënëse shpirtërore që një i ri [dhe e re] mund të ketë.”

Presidenti Ezra Taft Benson (1899–1994), “To the ‘Youth of the Noble Birthright’”, *Ensign*, maj 1986, f. 44; “To the Young Women of the Church”, *Ensign*, nëntor 1986, f. 82.





SEMINARI në Xhunglat e Ekuadorit

Në një xhungël të largët, seminari po bën një ndryshim të madh për këta të rinj.

Nga Xhoshua J. Perki

Revistat e Kishës

Terreni ndryshon shpejt në xhunglën e Amazonës në Kuiton Lindore të Ekuadorit, përtej vullkaneve dhe maleve të Andeve. Atje do të gjeni pyje të dendur, lumenj të bollshëm, majmunë, tukanë e madje edhe delfinë rozë.

Ju do të gjeni edhe një qytet të quajtur Puerto-Fransisko de Orelana. Ai është shumë ndryshe nga, epo mirë, nga gjithçka tjetër në Ekuador. Pesëmbëdhjetë vjet më parë, kishte relativisht pak njerëz në zonë. Por zbulimi i naftës sollti industrinë, njerëz që kërkonin punë, dhe anëtarë të Kishës.

Seminari në një Degë të Vogël

Pak prej të rinjve, si Oskar R., ishin tashmë anëtarë kur u krijua dega, por pjesa më e madhe janë të kthyer në besim prej pak kohësh. Dhe ata janë entuziastë dhe të emocionuar rreth Kishës. “Ne jemi të fortë”, thotë Oskari.

Në shtator të 2010–ës, vetëm një vit pasi që krijuar, dega filloi një program seminari. “Kur ne nisëm të mbledheshim në fillim disa vite më parë”,

tha Oskari “kishte shumë pak prej nesh. Unë isha i riu i vetëm. Por ne vazhduam të shtoheshim.

Shpejt ne patëm 6, pastaj 10 dhe tani akoma më shumë të rinj.”

Duke qenë se disa nga të rinjtë shkojnë në shkollë në mëngjes dhe të tjerët pasdite, ata kanë organizuar dy orare për klasën e seminarit – një në mëngjes nga ora 8:00 deri në orën 9:00 dhe një pasdite nga ora 16:30 deri në orën 17:30.

Mund të mos ketë shumë të rinj në program, por për ata të rinj që marrin pjesë, seminari u ka ndryshuar jetën.

Përse të Shkoni?

“Seminari është një bekim i madh për mua”, thotë Luis V., një i kthyer i ri në besim. “Ai më ndihmon mua të bëhem një misionar i mirë. Unë kam përballuar shumë sfida dhe tundime që kur jam bashkuar me Kishën, por kam qenë në gjendje të mbaj veten të fortë sepse unë e di se po bëj atë që është e drejtë.”

Dhe nuk është vetëm Luisi që ndihet në atë mënyrë. “Unë kam qenë anëtare e kishës për shumë pak kohë”, thotë Ariana J., “por unë kam marrë pjesë në seminar që kur jam pagëzuar. Jam e lumtur që e ndjek, sepse po mësoj shumë gjëra të vërteta lidhur me ungjillin e Jezu Krishtit që e mbushin zemrën time me shpresë dhe mendjen time me kuptim.”

Seminari i forcon të rinjtë njësoj si këta të rinj në Ekuador, shumë prej të cilëve janë të kthyer në besim kohët e fundit.



Pjesëmarrja në seminar e ka ndihmuar Arianën të vendosë një themel të fortë në ungjill. “Për mua, është një bekim të jem pjesë e këtyre orëve mësimore”, thotë Ariana. “Ato më forcojnë shpirtin dhe më ndihmojnë të përgatitem në mënyrë që një ditë të mund të jem bashkëshorte, nënë dhe udhëheqëse e mirë në Kishë dhe ndoshta një misionare me kohë të plotë.”



Vëllai i Arianës, Xherardo, ndihet njësoj. “Unë jam mirënjohës që seminari është bërë një pjesë e rëndësishme e jetës sime”, thotë ai. “Ai po më përgatit që të shërbej në një mision një ditë. Atje unë kam mësuar rreth plani të shpëtimit që Perëndia ka përgatitur për mua. Çdo orë mësimore që ndjek, më jep shpresë që unë mund të trashëgoj mbretërinë çelestiale dhe më jep siguri se unë e kam marrë ungjillin e Jezu Krishtit.”

Xherardo është shumë i lodhur ndonjëherë gjatë orës mësimore. Atij i duhet të çojë së pari vëllanë e tij të vogël në shkollë e më pas të kthehet në shtëpi shpejt për të marrë motrën në mënyrë që të mund të shkojnë në seminar. Por ai nuk e ka problem.

“E gjitha kjo është diçka shumë e re për mua, por unë jam plot me lumturi”, thotë Xherardo. “Unë e di se jam në shtegun e duhur që do të më japë mundësinë të shoh përsëri Atin tim Qiellor. Shpirti i Shenjtë ma jep këtë siguri. Unë thjesht duhet të bëj një përpjekje dhe të ngulmoj deri në fund.”

S’ka Pse të Jemi në Siklet

Për Uollter A., seminari ishte fillimisht pak frikësues. “Unë isha në siklet herën e parë që shkova”, thotë ai. “Por kur hyra në klasë, u ndieva i veçantë sepse e ndieva dashurinë që ndihet kur studion shkrimet e shenjta. Dhe kur u largova, u ndieva i forcuar me lumturi në zemrën time për atë që kisha mësuar. Një nga bekimet më të mëdha që Ati Qiellor ka për të rinjtë, është seminari.”

“Kisha e Jezu Krishtit e Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme e ka ndryshuar jetën time”, thotë Abel A., i cili po përgatitet gjithashtu për të shkuar në mision. “Unë po mësoj rreth mësimëve të profetëve. E dua Jozef Smithin. Ai u tregua trim kur bëri të ndodhë Rivendosja e Kishës së vërtetë pavarësisht nga gjithë problemet që kjo i shkaktoi atij. Unë dua të bëhem trim siç qe ai.”

Shumë të rinjve u duhet të bëjnë sakrificë që të marrin pjesë në seminar. Nuk është gjithmonë e lehtë, por për të rinjtë në Puerto-Fransisko de Orelana në Ekuador, ia vlen përpjekja.

“Kur mendoj rreth të vazhduarit përpara, siç thuhet në shkrimet e shenjta”, shpjegon Abeli, “unë mendoj se kjo do të thotë që të vendosim përparësitë tona për jetën. Seminari është një prej tyre. Ashtu siç ma ka ndryshuar mua jetën, ai mund të bëjë të njëjtën gjë për të rinj të tjerë.”

Edhe në vendet më të largëta të një xhungle në Ekuador, Kisha e Jezu Krishtit dhe programi i saj i seminarit të të rinjve po ua lulëzon dhe ndryshon jetën atyre që zgjedhin t’ia lejojnë këtë. ■



ÇFARË VJEN PAS SEMINARIT?

Diplomimi në seminar nuk është fundi i studimeve tuaja fetare. Ka diçka tjetër të mrekullueshme të përgatitur për ju.

Nga Dejvid A. Eduards

Revistat e Kishës

Në seminar ju studioni shkrimet e shenjta dhe takoheni me moshatarë të tjerë rregullisht. Ju ndiheni të mirëpritur dhe mund të ndieni Shpirtin. Kështu, kur e keni përfunduar seminarin, a u vjen fundi këtyre përvojave? Absolutisht jo.

Programi i kishës për institutin është hapi vijues dhe juve do t'ju pëlqejë shumë. Qoftë nëse ju do të shkoni në universitet apo jo, ju mund të vazhdoni të mësoni rreth ungjillit, të përgatiteni për një mision dhe martesë në tempull dhe të ndani përvojat me të tjerë të moshës tuaj.

Këtu keni disa përgjigje për pyetjet kryesore rreth institutit. Ju mund të gjeni më shumë në adresën institute.lds.org.

Çfarë është instituti?

Instituti përbëhet nga orë mësimore rreth ungjillit, duke përfshirë orë mësimore mbi shkrimet e shenjta, mësimet e profetëve dhe përgatitjen për një mision ose martesën në tempull. Në disa institute ju mund të zgjidhni mes orëve të shumta mësimore.

Kush mund të marrë pjesë?

Të gjithë të rinjtë beqarë në moshë madhore nxiten fuqimisht që të marrin pjesë në orët mësimore të institutit. Mund të marrë pjesë çdokush – i



FAKTE RRETH INSTITUTIT

Numri i studentëve:
mbi 350.000

Numri i vendeve: mbi 2.500

Numri i kurseve në dispozicion: 15 kurse bazë, plus disa kurse të tjera me zgjedhje

Klasa e parë e institutit:
Moskou, Ajdaho, SHBA (1926)

Klasa e parë e institutit jashtë Shteteve të Bashkuara dhe Kanadasë:
Meksikë (1959)

Qëllimi i institutit: Të ndihmojë të rinjtë në moshë madhore që t'i kuptojnë dhe të mbështeten tek mësimet dhe Shlyerja e Jezu Krishtit, të kualifikohen për bekimet e tempullit, si dhe të përgatiten vetë, të përgatisin familjet e tyre dhe të tjerë për jetën e përditshme me Atin e tyre në Qiell.

martuar apo beqar – nga mosha 18 deri 30 vjeç.

Ku mund ta gjej institutin?

Disa zona i kanë ndërtesat e institutit pranë kolegjeve dhe universiteve. Në zona të tjera, orët mësimore zhvillohen në ndërtesat e Kishës ose vende të tjera. Lidhuni me peshkopin ose presidentin tuaj të degës që të mësoni rreth programit të institutit në zonën tuaj, ose shkoni tek adresainstitute.lds.org që të gjeni një institut pranë jush.

Pse duhet t'i ndjek orët mësimore të institutit?

Presidenti Tomas S. Monson ka thënë: “Bëjeni pjesëmarrjen në institut një përparësi. . . . Mendoni për të! Do të bëni miq, do të ndieni Shpirtin dhe do t'ju forcohet besimi. Unë ju premtoj se, ndërsa merrni pjesë në institut dhe i studioni shkrimet e shenjta me zell, fuqia juaj për të shmangur tundimin dhe për të marrë drejtim nga Fryma e Shenjtë në gjithçka që bëni do të rritet” (institute.lds.org, 21 prill 2009). ■



2 Timoteut 3:16-17

Apostulli Pal dha mësim rreth mënyrës se si e bekojnë shkrimet e shenjta jetën tonë.



Të Gjitha Shkrimet e Shenjta

“Kur dëshirojmë të flasim me Perëndinë, ne lutemi. Dhe kur dëshirojmë që Ai të na flasë, ne hetojmë shkrimet e shenjta; pasi fjalët e Tij janë folur përmes profetëve të Tij. Ai më pas do të na mësojë ne ndërsa dëgjojmë nxitjet e Shpirtit të Shenjtë.

Nëse nuk e keni dëgjuar zërin e Tij t’ju flasë kohët e fundit, kthehuni në Kishë dhe lexojini shkrimet e shenjta përsëri. Kjo është ajo që do të na ndihmojë shpirtërisht.”

Plaku Robert D. Hales, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, “Holy Scriptures: The Power of God unto Our Salvation”, *Liahona*, nëntor 2006, f. 26–27.

Veprat e Mira

Çfarë lloj veprash të mira ju përgatisin shkrimet e shenjta që të bëni? Në vijim janë disa prej atyre më të qartave. A mund të mendoni të tjera? Shkruani rreth tyre në ditarin tuaj.

- Shërbimi si misionar me kohë të plotë
- Përmeshja e thirrjeve në Kishë (të tilla si presidencat e kuorumeve dhe klasave)
- Mësimdhënia e ungjillit
- Ndarja e dëshmisë
- Ndarja e ungjillit
- Dhënia e përgjigjeve për pyetjet e miqve rreth Kishës

Korrigjimi

Fjala e lashtë greke e përdorur në Bibël me kuptimin e plotë të fjalës do të thotë të sillësh sërish ashtu siç duhet. Kështu që shkrimet e shenjta ndihmojnë që t’ju mbajnë në vijë të drejtë dhe që të ndiqni shtegun e ngushtë e të ngushtuar (shih 2 Nefi 9:41).

16 I gjithë Shkrimi është i frymëzuar nga Perëndia dhe i dobishëm për mësim, bindje, ndreqje dhe për edukim me drejtësi, **17** që njeriu i Perëndisë të jetë i përkryer, tërësisht i pajisur për çdo vepër të mirë.

Qortimi

Qortimi – heqja e vërejtjes, ndëshkimi, “heqja e veshit”, ose korrigjimi, zakonisht në një mënyrë të sjellshme.

I mobilizuar

I mobilizuar – i përgatitur, i pajisur.



Doktrina

“Doktrina e vërtetë, kur kuptohet, ndryshon qëndrimin dhe sjelljen. Studimi i doktrineve të ungjillit do ta përmirësojë sjelljen më shpejt sesa një studim i sjelljes mund ta bëjë atë.”

Presidenti Boyd K. Packer, Presidenti i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, “Do Not Fear”, *Liahona*, maj 2004, f. 79

Shënim i redaktorëve: Kjo faqe nuk është e thënë të jetë një shpjegim tërësor i vargut të përzgjedhur të shkrimit të shenjtë, por vetëm një pikënisje për studimin tuaj vetjak.



MOS U RRËZONI

Parandalojini problemet e mëdha më vonë duke ndrequr problemet e vogla tani.

Nga Adam C. Olson
Revistat e Kishës

KONTROLLET SHPIRTËRORE



“Ne duhet të bëjmë kontrolle shpirtërore të vazhdueshme të vetes për të përcaktuar se ku kemi nevojë të përmirësohemi.

Zakonisht ne i kuptojmë këto defekte të vogla me ndihmën e Shpirtit të Shenjtë. . . . Ne kemi nevojë të dëgjojmë me kujdes atë që po na mëson Shpirti, udhëheqësit e Kishës, njerëzit e dashur, kolegët dhe miqtë.”

Plaku Marcos A. Aidukaitis, i Të Shtatëdhjetëve, “Honesty in the Small Things”, *Ensign*, shtator 2003, f. 30.

Andreit i kanë pëlqyer shumë aeroplanët që kur ishte i vogël. Por ndërkohë që ka shumë që ëndërrojnë të fluturojnë, Andrei nuk mendon të fluturojë me aeroplanë; ai interesohet për ndërtimin e aeroplanëve. Ky 16-vjeçar nga Rumania po studion për t'u bërë mekanik aeroplanësh.

Në Rumani adoleshentët mund të zgjedhin të ndjekin një shkollë të mesme për t'u përgatitur për universitetin ose të ndjekin një shkollë profesionale. Për shkak të dashurisë së Andreit për aeroplanët, vendimi i tij për të ndjekur shkollën profesionale të aviacionit qe i lehtë.

Mekanikët e aeroplanëve nuk bëjnë thjesht rregullimin e aeroplanëve që janë prishur. Një nga gjërat më të rëndësishme që bëjnë ata është që ata i kontrollojnë dhe i mirëmbajnë aeroplanet në mënyrë që të mos prishen. Ata kontrollojnë rregullisht gjithçka në një aeroplan, që nga helikat deri tek rrotat e zbritjes si dhe çdo pjesë tjetër.

“Mund të jetë e vështirë të gesh problemin e vogël që mund të shkaktojë rrëzimin e një avioni”, thotë Andrei. “Por ta gesh është shumë më e lehtë sesa të përpiqesh ta montosh të gjithë avionin sërish.”

Të pasurit e një programi të rregullt mirëmbajtjeje dhe kundërshtimi


për ta shpërfillur atë janë të rëndësishme – edhe për aeroplanët edhe për anëtarët e Kishës – në mënyrë që të gjenden dhe të ndreqen problemet përpara se të bëhen një kërcënim mekanik apo shpirtëror për jetën.

Mirëmbajtja Shpirtërore

Andrei jeton në Bukuresht, një qytet me pothuajse dy milionë njerëz. Sidoqoftë, Kisha është relativisht e re në Rumani dhe ka vetëm aq anëtarë sa për të krijuar dy degë në Bukuresht. Andrei dhe familja e tij jetojnë larg nga anëtarët e tjerë të degës së tyre. Andrei e ndien ndikimin e botës rreth tij në shkollë dhe mes miqve të tij. Ai e di sa e thjeshtë do të ishte të rrëzohej – nga ana shpirtërore – nëse ai nuk e mban gjallë mirëmbajtjen e rregullt shpirtërore.

Jeta mund të jetë e ngarkuar. Përkrah kohës që Andrei kalon me mësimet e shkollës, futbollin dhe kompjuterin, ai gjen kohë për t'u lutur, për të agjëruar, për të studiuar shkrimet dhe për të përmbushur përgjegjësitë e tij si prift. Ai sigurohet edhe që të “shkojë” në seminar, gjë të cilën ai e bën përmes internetit për shkak të largësisë.

Bërja e këtyre gjërave është pjesë e mirëmbajtjes së rregullt shpirtërore që ndihmon për t'i gjetur dhe ndrequr dobësitë përpara se ato të çojnë



në një rrëzim të natyrës shpirtërore kërcënues për jetën.

“Ka disa gjëra që ju thjesht duhet t’i bëni rregullisht – duke krijuar një zakon”, thotë ai. “Ju nuk mund ta lejoni jetën t’ju marrë përpara.”

Rrëzimet Shpirtërore

Andrei ka mësuar se, nëse ne nuk e kryejmë mirëmbajtjen shpirtërore rregullisht, forca të tilla si stresi ose trysnia e moshatarëve mund ta mposhtin qëndresën tonë ndaj tundimit. Kur kjo ndodh, nuk duhet shumë kohë përpara se ne të humbasim drejtimin, kontrollin dhe përfundimisht fuqinë tonë shpirtërore.

Ashtu si një aeroplan pa fuqi do të nisë të bjerë, kur mëkatojmë, ne humbasim fuqinë shpirtërore dhe biem, duke rritur largësinë tonë nga qielli dhe duke shkuar herët apo vonë drejt një rrëzimi shpirtëror.

Ndërkohë që është e mundur që Shlyerja e Shpëtimtarit të na ndreqë përsëri pasi të rrëzohemi, është shumë më mirë të mbështetemi në fuqinë e Tij që të na ndihmojë ta ndreqim problemin kur është i vogël – përpara se të shkaktojë një gjëmë shpirtërore.

Rreziku i Shpërfilljes

Mendimi i shpërfilljes të mirëmbajtjes mekanike në një aeroplan nuk i

ka shkuar kurrë në mendje Andreit. Shpërfillja nuk është një alternativë. “Ka ligje për këtë”, thotë ai. Por nëse ai *vërtet* do ta shpërfillte mirëmbajtjen – vetëm një herë – ai e pranon se “ndoshta nuk do të ndodhte asgjë”.

Ndoshta problemi më i madh me shpërfilljen nuk është që aeroplani do të rrëzohet menjëherë por që nuk do të rrëzohet. “Nëse asgjë e keqe nuk ndodh kur unë të shpërfill sot, unë do të tundohem më lehtë për të shpërfillur të nesërmen”, thotë ai.

Kur mirëmbajtja shpërfilllet rregullisht, forcat dhe tensioni i ushtruar mbi aeroplan – ose mbi ne – do të bëjë që diçka të shkojë keq herët a vonë. “Përfundimisht ne do të rrëzohemi”, thotë ai.

Kjo është arsyeja përse Perëndia na ka dhënë edhe neve ligje për mirëmbajtjen e rregullt shpirtërore. “Ju do të mblidheni [në kishë] *shpesh*” (3 Nefi 18:22; theksimet shtuar). Lutuni *gjithmonë* (shih 3 Nefi 18:19). Kërkojini shkrimet *me zell* (shih 3 Nefi 23:1–5). “Virtyti duhet t’i stolisë mendimet e

tua *pa pushim*” (DeB 121:45; theksimet shtuar). Vizitoheni tempullin *rregullisht*.¹

Mbajtja e këtyre ligjeve dhe kryerja e mirëmbajtjes së rregullt shpirtërore do të bëjnë që të fluturojmë në shtegun e duhur.

“Një aeroplan është ndërtuar që të ngrihet nga toka, që të largohet nga bota”, thotë Andrei. “Kjo është ajo çka Ati Qiellor dëshiron për ne. Me mirëmbajtje të rregullt, ne do të arrijmë të sigurt atje ku dëshirojmë të shkojmë – përsëri në qiell.” ■

SHËNIM

1. Shih Tomas S. Monson, “Tempulli i Shenjtë Një Fener për Botën”, *Liahona*, maj 2011, f. 92.

**“Analizoni veten tuaj a jeni në besim”
(2 Korintasve 13:5).**

LISTA E KONTROLLIT PËR MIRËMBAJTJEN SHPIRTËRORE

Mekanikët e aeroplanëve kanë shpesh një listë kontrolli të gjërave që duhet t’i shqyrtojnë rregullisht. Udhëheqësit e kishës kanë këshilluar që të bëjmë kontrollet tona të rregullta shpirtërore.¹ Këto janë disa nga pyetjet që mund t’ju ndihmojnë të analizoni shëndetin tuaj shpirtëror herë pas here. Nëse jeni të shqetësuar për ndonjë nga përgjigjet tuaja, flisni me prindërit tuaj ose me peshkopin apo presidentin e degës.

- A lutem rregullisht dhe singërisht?
- A ushqehem me bollëk me fjalën e Perëndisë në shkrimet shenjta dhe mësimet e profetëve të gjallë?
- A e mbaj ditën e Shabatit të shenjtë dhe a i ndjek mbledhjet e Kishës rregullisht?
- A agjëroj dhe a e paguaj të dhjetën dhe ofertën me vullnet të plotë?
- A jam i gatshëm t’i fal të tjerët?
- A gjej rregullisht mënyra për t’u shërbyer të tjerëve?
- A e kujtoj Shpëtimtarin gjatë gjithë kohës dhe a e ndjek shembullin e Tij?
- A i mbaj mendimet dhe fjalorin tim të pastër?
- A jam i ndershëm në të gjitha gjërat?
- A i bindem Fjalës së Urtësisë?

SHËNIM

1. Shih Joseph B. Wirthlin, “True to the Truth”, *Ensign*, maj 1997, f. 17.

STUDIOJINI SHKRIMET E SHENJTA

Lëreni seminarin t'ju shndërojë.

(Shih 1 Nefi 19:23.)



Koha për të Biseduar

*“Unë do t'i nderoj prindërit e mi dhe do të bëj pjesën time për të forcuar familjen”
(Standardet e Mia Ungjillore).*



Nga Hilari Uotkins Lemon

Bazuar mbi një histori të vërtetë

“Mirë pra, të gjithë. Le të kemi kohën për të biseduar”, thirri Mami.

Xhozi mezi e kishte pritur kohën e bisedës gjatë gjithë ditës. Çdo mbrëmje, Xhozi dhe dy vëllezërit e saj të vegjël, Beni dhe Uesi, mblihdeshin në dhomën e ndenjjes me Mamin dhe Babin për të folur rreth asaj që po ndodhte në jetën e tyre.

Sonte Babi kishte thënë se ai do ta ndihmonte Xhozin të ushtrohej me skenarin për njoftimet e mëngjesit. Leximi i lajmërimeve të mëngjesit qe një privilegj i veçantë në shkollën e Xhozit. Të nesërmen Xhozi do të vendoste një pjesë të shkurtër të këngës së saj të parapëlqyer në altoparlantët e shkollës dhe do të përdorte mikrofonin për të lajmëruar aktivitetet e asaj dite dhe menunë e drekës.

Xhozi vrapoi për te dhoma e ndenjjes, e emocionuar që do të bënte prova me skenarin.

“Ja tek është lajmëruesja jonë e famshme!” Kështu tha Babi kur

Xhozi u hodh në divan ngjitur me të. “Si po ndihesh për nesër?”

“Jam e emocionuar por pak në siklet. Kam frikë se do të bëj ndonjë lëmsh përpara të gjithë shkollës”, tha Xhozi.

“Kjo është arsyeja pse ne ushtrohemi”, tha Babi. “Vazhdo lexo përgjatë skenarit dhe unë do të dëgjoj për vendet që mund të përmirësosh.”

“Faleminderit, Babi”, tha Xhozi.

Ajo dhe Babi e përsëritën skenarin kaq herë sa që Xhozi nuk i numëronte dot. Më pas Xhozi u ngrit në këmbë dhe interpretoi skenarin e saj edhe një herë të fundit për familjen. Mami dhe Babi brohoritën. Beni toku duart me të dhe Uesi buzëqeshi dhe duartrokiti.

Xhozi shkoi në shtrat e lumtur dhe me vetëbesim.

Të nesërmen gjithçka shkoi vaj. Edhe pse ishte në siklet, Xhozi buzëqeshi kur dëgjoji muzikën e saj të vihej në altoparlantët e shkollës. Ajo ishte e gëzuar që ishte ushtruar për skenarin me Babin dhe ajo e lexoi ngadalë dhe qartësisht pa asnjë gabim.

“Bëre një punë të shkëlqyer”, tha Znj. Bllejk, zëvendës drejtoresha.

Në mbarim të orëve të shkollës, Xhozi qëndroi në radhën për në autobus. Një djalë më i madh u kthye nga ajo dhe e pyeti: “Ti je ajo vajza që i lexoi lajmërimet sot?”

Xhozi buzëqeshi. “Po”, tha ajo.

“Pse zgjodhe atë këngë?” pyeti djali. “Ishte një këngë budallaqe.

Ti i prishe fare lajmërimet e mëngjesit.” Pastaj ai e fyeu dhe qeshi me shokët e tij.

Xhozi u ul vetëm në sediljen e përparme të autobusit. Ajo ndieua të përziera në stomak.

Kur Xhozi u kthye në shtëpi, e gjeti Mamin duke luajtur me Uesin.

“Mami e di që nuk ka ardhur ende koha për të biseduar, por unë po vrisja mendjen nëse mundem gjithsesi të flas me ty tani”, tha Xhozi.

“Patjetër Xhozi”, tha Mami. “Çfarë ndodhi? Shkoi ndonjë gjë keq me lajmërimet e mëngjesit?”

“Jo”, tha Xhozi. “Gjithçka që e përsosur. Të paktën kështu m’u duk mua, derisa një djalë më tha se zgjodha një këngë budallaqe. Ai gjithashtu më fyeu rëndë.”

Mami ceku dyshtemenë pranë saj. Xhozi përfitoi për t’u ulur. Mami i dha një përqafim të madh. Xhozi dhe Mami biseduan për çdo gjë që ndodhi atë ditë, duke përfshirë dhe komplimentin e Znj. Bllejk.

“Më vjen keq që ai djali dhe shokët e tij qenë të pasjellshëm me ty”, tha Mami. “Por me sa duket njerëz të tjerë për të cilët ke respekt si Znj. Bllejk, qenë shumë të kënaqur me mënyrën si i lexove ti lajmërimet. Babi dhe unë jemi shumë krenarë për ty. Ti punove fort dhe ia vlejti!”

Xhozi e përqafoi Mamin përsëri. “Faleminderit Mami”, tha Xhozi. “Unë ndihem shumë më mirë.” Xhozi ishte e gëzuar që çdo kohë mund të jetë koha për të biseduar. ■



“A”sgjë nuk është më rëndësishme për marrëdhënien mes pjesëtarëve të familjes sesa komunikimi i hapur e i sinqertë.”

Plaku M. Russell Ballard, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, “Like a Flame Unquenchable”, *Liahona*, qershor 1999, f. 103.





TË BISEDOJMË SË BASHKU

Këto janë disa sugjerime për të pasur “kohën për të biseduar” në vetë familjen tuaj:

- Kërkojuni prindërve tuaj të caktojnë pak minuta çdo ditë që

familja juaj të bisedojë së bashku. Ajo mund të jetë gjatë një vakti ose në një çast të caktuar të ditës.

- Sigurohuni që secili të ketë radhë për të folur e për të dëgjuar.

Përfshijini të gjithë!

- Kini respekt për mendimet e pjesëtarëve të familjes tuaj. Sigurohuni që secili të ndiejë që ai ose ajo është i/e rëndësishëm/me.

LOJËRA BASHKËBISEDIMI

Ju nevojiten disa ide për kohën për të biseduar? Proveni këto lojëra:

Hedhja e Qeses me Kokrriza: Nëse familja juaj është e madhe në numër ose ka probleme me respektimin e radhës, përdorni një qese me kokrriza për të treguar se kush ka radhën që të flasë. Pasi personi që ka qesen me kokrriza thotë atë çka ai ose ajo dëshiron të thotë, hidhjeni qesen me kokrriza një pjesëtar tjetër të familjes që të marrë radhën për të folur.

Intervistuesi: Ndahuni në grupe me nga dy dhe bëni me radhë sikur jeni intervistues. Mendoni disa pyetje për bashkëpjesëmarrësin tuaj dhe më pas bëjani atij ose asaj pyetjet. Ju mundeni madje të përdorni një mikrofon të vërtetë ose regjistrues zëri për intervistat tuaja.

Çfarë do të bëje? Me radhë bëjini familjes suaj pyetje të ndryshme që fillojnë me “Çfarë do të bëje . . . ?” Disa shembuj janë “Çfarë do të bëje nëse do të humbje rrugën?” dhe “Çfarë do të bëje nëse do të kishe mundësi të shkoje kudo në botë?”



NDIHMË PËR PRINDËRIT: KOHA NJË E NGA NJË

Sado zbatimëse që është të bisedosh si familje, është e rëndësishme edhe që prindërit dhe fëmijët të kalojnë kohë një e nga një me njëri-tjetrin. Përfitonin nga momentet gjatë ditës për të qëndruar me fëmijët tuaj veçmas. Ftojini fëmijët një e nga një që t’ju ndihmojnë të mbaroni një punë të zakonshme shtëpie, t’ju shoqërojnë për të kryer një porosi, ose të bisedojnë me ju në dhomën tuaj për disa minuta. Vetëm pak çaste mund të çojnë në biseda kuptimplotë.



Ai Këputi LIDHJET E VDEKJES



Nga Plaku Patrik Kiëron
i Të Shtatëdhjetëve

“Ata kanë jetë të përjetshme nëpërmjet Krishtit, i cili ka këputur lidhjet e vdekjes” (Mosia 15:23).

Një natë kur fëmijët tanë ishin më të vegjël, ne ishim duke lexuar shkrimet e shenjta si familje. Ne lexuam rreth Shpëtimtarit dhe biseduam për mënyrën se si Ai nuk bëri kurrë ndonjë gabim.

Më vonë atë natë gruaja ime e vuri bijën tonë trevjeçare, Suzin, në shtrat. Suzi pa nga e ëma dhe tha: “Mami, Jezusi në të vërtetë e bëri një gabim”.

“Çfarë do të thuash?” e pyeti e ëma.

“Ai këputi diçka”, tha Suzi.

Disi në mëdyshje, e ëma e pyeti: “Çfarë këputi Ai?”

“Jezusi këputi lidhjet e vdekjes”, u përgjigj Suzi.

Gruaja ime e kuptoi se ajo dhe Suzi e kishin kënduar këngën e Fillores “On a Golden Springtime” [“Gjatë një Pranvere të Bukur”] shumë herë dhe Suzi i kishte mësuar fjalët “Gjatë një pranvere të bukur, Jezu Krishti u zgjua dhe nga varri ku shtrihej u largua, lidhjet e vdekjes Ai këputi”¹. E ëma e Suzit i shpjegoi asaj se këputja e lidhjeve të

vdekjes do të thotë se Jezu Krishti u ringjall në mënyrë që ne të gjithë të jetojmë përsëri pasi të vdesim.

Ajo bisedë na ka dhënë mua dhe gruas sime mundësi të shumta për t’u dhënë mësim bijave tona Lizit, Suzit dhe Emës, rreth asaj që do të thotë vërtet Shlyerja për secilin prej nesh. Suzi kishte të drejtë: Jezusi me të vërtetë i këputi lidhjet e vdekjes. Por ky nuk ishte një gabim. Ishte dhurata më e madhe që Ai mund të na bënte! (Shih Doktrina e Besëlidhje 14:7.)

Shpëtimtari vdiq dhe u ringjall që ne të mund të jetojmë përsëri me Atin tonë Qiellor dhe familjet tona sipas drejtësisë tonë. Nëse jemi të denjë, ne mund të gëzojmë bekimet e pavdekshmërisë dhe të jetës së përjetshme një ditë. Unë jam mirënjohës që Jezusi këputi diçka – lidhjet e vdekjes! ■

SHËNIM

1. “On a Golden Springtime”, *Children’s Songbook*, f. 88.



Këtë mësim dhe veprimtari mund ta përdorni për të mësuar më shumë mbi temën e Fillores këtë muaj.

JEZU KRISHTI

Më Mëson të Zgjedh të Drejtën

Për Tanerin, Pashka nuk do të ishte e njëjta këtë vit. Gjyshi i tij kishte vdekur dhe Taneri ishte i trishtuar se nuk do ta ndante përsëri me të këtë kohë të veçantë.

Por gjatë Fillores, Tanerit iu kujtua se arsyeja pse ne e festojmë Pashkën është sepse Jezu Krishti jeton! Kur Ai u ringjall, shpirti i Tij u bashkua përgjithmonë me trupin e

Tij, për të mos e përjetuar më kurrë vdekjen. Taneri mësoi se për shkak se Jezu Krishti u ringjall, të gjithë do të ringjallen një ditë, duke përfshirë edhe gjyshin e tij!

Një këngë Pashke e mbushi Tanerin me lumturi ndërsa ai këndoi: “Jezusi është ngritur, Jezusi miku ynë. Zemrat na mbushen me gëzim; Ai sërish

jeton.”¹ Taneri dëshironte t’ua thoshte të gjithëve këtë lajm të mirë. Ai vendosi që përpara Pashkës, të vendoste buqeta të vogla me lule pranvere në pragjet e dyerve të fqinjëve me shkrime të shenjta rreth Ringjalljes së Jezu Krishtit. Ai përfytyroi buzëqeshjet në fytyrat e tyre kur ata të gjenin dhuratën e tij mëngjesin e Pashkës. ■

SHËNIM

1. “Jesus Has Risen”, *Children’s Songbook*, f. 70.



Këngët dhe Shkrimet e Shenjta

- Gjoni 13:15
- Këngë sipas dëshirës suaj rreth Jezu Krishtit
- Këngë të sugjeruara nga *Liahona*: “Ai Vdiq Që Ne të Mund të Jetojmë Përsëri” (*Liahona*, prill 2005 f. M13), “Hosana Pashkës” (*Liahona*, prill 2003 f. M8)

Aktivitetet ZTD Në cilin vend të Botës?

Pasi Jezus Krishti u ringjall, Ai vizitoi jo vetëm njerëzit përreth Jerusalemit, por edhe njerëzit e drejtë në kontinentin amerikan gjithashtu. Së bashku me familjen, lidh secilën figurë me vendin ku ndodhi (Jerusalem ose kontinenti amerikan) duke hequr një vijë të drejtë. Lexoji me radhë shkrimet e shenjta që të mësosh më shumë rreth asaj që ndodhi te figurat.



Jezusi bekon fëmijët
3 Nefi 17:11–25




Jezusi i shfaqet Maria Magdalenës
Gjoni 20:14–18



Jezusi jep mësim në kontinentin amerikan
3 Nefi 11:8–11



Jezusi ngjitet në qiell
Veprat e Apostujve 1:9–11



Jezusi iu shfaqet njerëzve të drejtë
3 Nefi 11:1–8



Jezusi iu tregon plagët e Apostujve të Tij
Lluka 24:36–40







Jezusi kërkon analet e nefitëve
3 Nefi 23:7–13



Jezusi u shfaqet Apostujve të Tij
Mateu 28:16–20

Vetëm Ti

Ti mund t'i bësh vetë buqetat e tua të Pashkës si Taneri. Përdor një copë katrore të një letre të bardhë ose me ngjyrë dhe ndiq hapat më poshtë. Mbusheni konin me lule të vogla ose qerasje për t'i bërë një surprizë një shoku/shoqeje ose një pjesëtari të familjes!



Kontinenti amerikan





Përpiqem t'Jem si Jezusi

E thjeshtuar

Me zotim ♩ = 104-116

Teksti dhe Muzika nga Janice Kapp Perry

1. Për - pi - qem t'jem si Je - zu - si; U - dhët e Tij
(2. T'du) - a t'a - fër - min për - pi - qem; Miq - ve më-soj

un' po ndjek. _____ Për - pi - qem t'tre - goj da -
t'u shër - bej. _____ Vësh - troj për di - tën e

shu - ri, në gjith - çka që bëj dhe them. _____ Nganj' -
g'zi - mit, kur Je - zu - si së - rish vjen. _____ Për -

© 1980 nga Janice Kapp Perry. I rezervohen të gjitha të drejtat.
Kjo këngë mund të kopjohet për t'u përdorur me raste në kishë ose në shtëpi, jo për tregti.
Ky shënim duhet të përfshihet në çdo kopje që bëhet.

her' un' tun - do - hem t'ga - bu - a-rën t'zgjedh, Por pro - voj t'bi -
pi - qem t'i kuj - toj më - si - met e Tij. A - të - her' n'me -

ndem kur zër' i u - lët i qet' m'pëshp' - rit: "Du - hu-ni ju, siç Je -
ndi - me më vjen i Shenj-ti Shpirt' që thot':

zu - si ju do. Mi - rë - si t'shfa - qësh në gjith - çka, pro -

vo. Fis - nik, i për - ze - mërt n've - prim e n'me - ndim, Se

k'to na më - soi Je - zu - si." 1. _____ 2. T'du - si." _____

Motra në Emër dhe Besim

Nga Hedhër Rigli

Revistat e Kishës

Maria dhe Diana D. nuk janë vetëm motra; ato janë edhe shoqe të ngushta. Diana është 10 vjeçe dhe Maria mbushi 12 vjeç gushtin e shkuar. Ato jetojnë në Rumani, ku ka rreth 3.000 anëtarë të Kishës. Ato e mbajnë të fortë besimin e tyre te Jezu Krishti duke shkuar në kishë, duke lexuar shkrimet e shenjta dhe duke u lutur.

“Në kishë unë kam mësuar të kem besim në Perëndi”, thotë Maria. Një ditë ajo kishte një provim, kështu që iu lut Atit Qiellor në emër të Jezu Krishtit për ndihmë. Kur mori një notë të mirë, ajo u ndie sikur Ati Qiellor e kishte ndihmuar.

Diana thotë se Libri i Mormonit e ndihmon atë të ketë besim. “Çdo ditë që e lexoj Librin e Mormonit, dita ime shkon mirë”, thotë ajo. Historia e saj e preferuar nga shkrimet e shenjta është historia e Jozef Smithit. “Ai u lut dhe Perëndia e Jezu Krishti e ndihmuan atë”, thotë ajo. ■



ÇOKOLLATA

Ëmbëlsira e parapëlqyer e të dyja motrave është çokollata: Marias i pëlqen keku me çokollatë dhe Dianës i pëlqen torta me çokollatë.

KËNGA E PARAPËLQYER

Maria dhe Diana luajnë të dyja në piano. Kënga e parapëlqyer e Marias është "Love One Another" ["Duajeni Njëri-Tjetrin"]. Ajo flet rreth urdhërimit të Jezusit që t'i duam të tjerët. Diana mund ta luajë atë pothuajse përsosmërisht, por fundi është pjesa më e vështirë, thotë ajo.



UNË E DUA TEMPULLIN

Edhe Maria edhe Diana dëshirojnë të martohen në tempull një ditë. Ato jetojnë në Distriktin e Tempullit të Kievit në Ukrainë.

Kur Diana të jetë më e madhe, ajo do të shkojë në tempullin e Kievit në Ukrainë që të bëjë pagëzime për të vdekurit. Maria tani është e rritur mjaftueshëm që të shkojë. Tempulli është rreth 500 milje (805 km) larg.

FAMILJA NË RADHË TË PARË

Maria dhe Diana i duan prindërit e tyre. "Mami na bën të ndihemi më mirë kur sëmuremi", thotë Maria. "Babi na çon në shkollë", thotë Diana.



HIMNET

Himni i parapëlqyer i Dianës është "Larg, Larg Atje n'Fushat e Judes", që rrëfen rreth lindjes së Jezu Krishtit. Anëtarët në Rumani përdorin librin e gjelbër të himneve të Kishës. "Imnuri" do të thotë "himne" në rumanisht.



Plaku Riçard G. Skot, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, shpreh disa mendime mbi këtë temë.

Çfarë mund të bëj që të ndjek planin që ATI QIELLOR ka për mua?



Mësoni rreth planit të madh të lumturisë duke studiuar shkrimet e shenjta.



Dëgjojeni zërin e profetëve të tanishëm dhe të kaluar.



Bindjuni ndjenjave brenda jush që vijnë si nxitje nga Fryma e Shenjtë.



Kur është e nevojshme, kërkoni këshillë dhe udhëzim nga prindërit dhe udhëheqësit tuaj të priftërisë.

Nga "The Joy of Living the Great Plan of Happiness", Ensign, nëntor 1996, f. 75.

STANDARDET E MIA TË UNGJILLIT

Unë do të ndjek planin e Atit Qiellor për mua.

Unë do të kujtoj besëlidhjen time të pagëzimit dhe do të dëgjoj Frymën e Shenjtë.

Unë do të zgjedh të drejtën.

Unë e di se mund të pendohem kur bëj një gabim.

Unë do të jem i ndershëm me Atin Qiellor, me të tjerët dhe me veten time.

Unë do t'i përdor me nderim emrat e Atit Qiellor dhe Jezu Krishtit.

Unë nuk do të betohem ose të përdor fjalë të ndyra.

Unë do të bëj në ditën e Shabatit ato gjëra që do të më ndihmojnë të ndihem pranë Atit Qiellor dhe Jezu Krishtit.

Unë do të nderoj prindërit e mi dhe do të bëj pjesën time për të forcuar familjen time.

Unë do ta mbaj mendjen dhe trupin tim të shenjtë dhe të pastër dhe nuk do të marr gjëra që janë të dëmshme për mua.

Unë do të vishem me thjeshtësi për të treguar respekt për Atin Qiellor dhe për veten time.

Unë do të lexoj dhe do të shikoj vetëm gjëra që janë të pëlqyeshme për Atin Qiellor.

Unë do të dëgjoj vetëm muzikë që është e pëlqyeshme për Atin Qiellor.

Unë do të kërkoj miq të mirë dhe do t'i trajtoj të tjerët me mirësi.

Unë do të jetoj tani për të qenë i denjë për të shkuar në tempull dhe të bëj punën time për të patur një familje të përjetshme.

FËMIJË I PERËNDISË JAM

*Unë e di se Ati Qiellor më do dhe unë e dua Atë.
Unë mund t'i lutem Atit Qiellor çdo kohë dhe kudo.
Po përpiqem të kujtoj dhe të ndjek Jezusin.*

Të Kuptojmë Gëzimin e Pashkës


Bazuar mbi një histori të vërtetë





Gjurmët e Këmbëve të Pashkës

Jezu Krishti bëri punë të rëndësishme në vende të veçanta gjatë ditëve përpara se të kryqëzohej dhe ringjallej. Ndiq gjurmët e këmbëve për të zbuluar se ku shkoi dhe çfarë bëri Ai.



2. Jezusi hyri në Jerusalem mbi një gomar. Shumë njerëz u lumturuan kur e panë Atë.

6. Jezusi u ringjall.

5. Jezusi u kryqëzua.

1. Jezusi u dha mësim njerëzve mbi një kodër të quajtur Mali i Ullinjve.

3. Jezusi shëroi njerëzit e sëmurë në tempull.

4. Në Kopshtin e Gjetsemanit, Jezusi iu lut Atit Qiellor dhe vuajti për mëkatet tona.

Trajnimi i Udhëheqjes Mbarëbotërore Nënvizon Rrugën Drejt Rritjes së Vërtetë

Nga Hedhër Uaitëll Rigli

Lajme dhe Ngjarje të Kishës

Udhëheqësit e Kishës shpjeguan rëndësinë e “rritjes së vërtetë” dhe mënyrën për ta arritur këtë gjatë Mbledhjes për Trajnimin e Udhëheqjes Mbarëbotërore, më 11 shkurt 2012.

Presidenti Diter F. Uhtdorf, Këshilltar i Dytë në Presidencën e Parë, anëtarët e Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, Presidenca e Të Shtatëdhjetëve dhe presidencat e organizatave ndihmëse të Kishës morën pjesë në udhëzimin për udhëheqësit e Kishës në të gjithë botën.

“Në termat e Kishës, *rritja* mund të përcaktohet si ‘anëtarët e rinj’. . . . Megjithatë, *rritja e vërtetë* përcaktohet si ‘rritja e numrit të anëtarëve aktivë’”, shpjegoi Presidenti Uhtdorf.

Plaku M. Rasëll Ballard, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, shtoi: “Rritja ndodh kur kthimi vetjak për gjatë gjithë jetës në ungjill çon në rritjen e besnikërisë të secili individ dhe familje”.

Ajo rritje e besnikërisë përfshin gjëra që nuk mund të maten lehtësisht, të tilla si lutja e përditshme, studimi i shkrimeve të shenjta, mbrëmja familjare, dashuria në shtëpi dhe përvojat vetjake me Shlyerjen, tha Presidenti Uhtdorf.

“Shumë shpesh ne e ndërlikojmë bukurinë dhe thjeshtësinë e ungjillit të Jezu Krishtit me lista të pafundme të pritshmërive tepër të përpikta”, tha ai. “Megjithatë, kur përqendrohemi te qëllimi i ungjillit, pjesa më e madhe e pështjellimit zhduket.”

Pjesa më e madhe e transmetimit është përqendruar në doktrinat dhe parimet kyçe, që sigurojnë përgjigjet e pyetjeve “përse”.

“Pyetjet e duhura rreth qëllimit të ungjillit do të na drejtojnë te vendimet e duhura rreth asaj se kujt i zbatohen, çfarë duhet bërë për të, kur duhet t’i bëjmë ato gjëra, përse duhet t’i bëjmë ato gjëra, dhe si duhet t’i bëjmë”, tha Presidenti Uhtdorf.

Martesa dhe Familja në Planin e Shpëtimit

“Kisha përbëhet nga familjet”, tha Presidenti Bojd K. Paker, President i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve. “Lagjet dhe kunjët janë atje për të mbështetur familjet. Kur ne flasim për familjet, atëherë ne shohim rritjen e vërtetë në Kishë.”

Ai shpalli se çdo bashkëshort e atë duhet të jetë një person që mban dhe përdor priftërinë në shtëpinë e tij, duke kryesuar mbi familjen e tij në drejtësi. Në mënyrë të ngjashme, tha ai, udhëheqësit e priftërisë duhet të drejtojnë me denjësi – megjithëse detyrat brenda priftërisë ndryshojnë, çdo mbajtës i denjë i priftërisë ka aq përgjegjësi për priftërinë sa dhe një mbajtës tjetër (shih DeB 1:20).

Plaku Rasëll M. Nelson, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, theksoi se bashkëshortët dhe bashkëshortet, etërit dhe nënat, duhet të ndërtojnë një marrëdhënie dashurie, pendimi dhe lutjeje për të forcuar e mbrojtur me sukses familjen, që “është thelbësore në planin e Krijuesit për destinacionin e përjetshëm të fëmijëve të Tij” (“Familja: Një Proklamata Drejtuar Botës”, *Liahona* dhe *Ensign*, nëntor 2010, f. 129).

“Në shkrimet e shenjta është bërë tri herë paralajmërimi që e gjitha bota do të shkatërrohet tërësisht në kthimin e Zotit, nëse disa kushte të caktuara nuk janë të përshtatshme”, tha ai. “Në secilën rrethanë ai paralajmërim lidhet me gjendjen e familjes njerëzore pa ordinancat vulosëse të tempullit. Pa këto ordinanca të ekzaltimit, lavdia e Perëndisë nuk do të ishte përmbushur.”

Arritja e atij qëllimi përfundimtar – jetës së përjetshme dhe ekzaltimit për të gjithë fëmijët e Perëndisë – kërkon që rritja e vërtetë të ndodhë në shtëpitë, në lagjet e degët tona dhe në të gjithë Kishën.



Zbatimi i Ungjillit

Rritja dhe kthimi i vërtetë në besim vijnë nga zbatimi i ungjillit në jetën e përditshme. Në një diskutim me pyetje-përgjigje, Plaku L. Tom Peri dhe Plaku D. Tod Kristoferson, të Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, shpjeguan se qëllimi përfundimtar i ungjillit është t'i ndihmojë njerëzit të bëjnë dhe të mbajnë besëlidhjet e tempullit. Bindja ndaj besëlidhjeve, tha Plaku Kristoferson, mund ta ndryshojë njeriun e natyrshëm në një shenjtor me kalimin e kohës.

Të ndihmuarit e të tjerëve është një aspekt tjetër i rëndësishëm i zbatimit të ungjillit. Anëtarët janë përgjegjës secili individualisht dhe si Kishë për të ndihmuar që të shpëtojnë njerëzit në nevojë materiale dhe shpirtërore, thanë udhëheqësit.

Ne nuk duhet të ngurrojmë për t'i bashkuar përpjekjet tona me besimet dhe organizatat e tjera të drejtuara te shërbimi për t'u kujdesuar për të varfërit dhe nevojtarët, tha Plaku Kristoferson. Udhëheqësit e priftërisë duhet t'i drejtojnë këto përpjekje, por edhe anëtarët e misionarët duhet ta mbështesin atë rol.

Një grup diskutimi theksoi përqendrimin te shërbesa ndaj familjeve, te forcimi i mbajtësve të Priftërisë Melkizedeke dhe te dhënia e ndihmës për të ndërtuar besimin e dëshmitë e të rinjve. Plaku Ballard dhe Plaku Nil L. Anderson, të Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, ishin të pranishëm së bashku me Plakun Ronald A. Rasband të Presidencës së Të Shtatëdhjetëve; Elen S. Dalton, presidente e përgjithshme e Të Rejave; dhe

Plaku M. Rasëll Ballard, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, flet gjatë një grupi diskutimi të mbajtur si pjesë e Mbledhjes së Trajnimit të Udhëheqjes Mbarëbotërore në shkurt të 2012-ës.

Gjatë Mbledhjes së Trajnimit të Udhëheqjes Mbarëbotërore në shkurt, Presidenti Diter F. Uhtdorf, Këshilltar i Dytë në Presidencën e Parë, tha: “Gjëja e parë që duhet të bëjmë është të kuptojmë. Gjëja e dytë është që ta vëmë në veprim kuptueshmërinë tonë. . . . Nuk na vjen shumë në ndihmë dëgjimi i fjalës së Perëndisë nëse nuk e zbatojmë në jetën tonë atë që dëgjojmë.”

Ai i ftoi udhëheqësit e Kishës të bëjnë tri gjëra pas transmetimit për udhëheqjen dhe përgjatë shërbimit në thirrjet e tyre për të përfutur sa më shumë prej udhëzimit nga udhëheqësit e Kishës:

1. Veçmas dhe si këshill, plot lutje merrni parasysh udhëzimin që keni marrë dhe gjeni arsyen e shërbimit dhe shërbesës tuaj.
2. Pas medimit dhe diskutimit, përcaktoni disa veprime të veçanta që do të zotoheni për t'i vënë në zbatim. Veprimet duhet të jenë të posaçme për rrethanat dhe nevojat e secilës organizatë, lagjeje, kunji, familjeje ose individi.
3. Pasi t'i keni bërë këto zotime, ndiqini më tej zotimet dhe thirrjet për të cilat jeni përgjegjës në çdo mbledhje të këshillit tuaj.

Rozmari M. Uiksom, presidente e përgjithshme e Fillores.

Plaku Rasband tha se çdo udhëheqës ka nevojë të jetë më i përfshirë në kthimin e anëtarëve në aktivitet të plotë dhe Plaku Anderson theksoi se të rinjtë duhet të jenë më të përfshirë në riaktivizimin dhe forcimin e të rinjve të tjerë.

Arritja e Rritjes së Vërtetë

Rritja e vërtetë vjen ndërsa ne zbatojmë parimet e ungjillit në jetën tonë të përditshme, theksoi Presidenti Uhtdorf.

“Ndërsa i merrni parasysht këto tema, pyesni veten se përse bëni shërbim e shërbesë dhe si rezultat çfarë duhet të bëni në përgjegjësitë tuaja si individ dhe si këshill”, tha ai.

Mësoni më Shumë

Inividët mund të shohin, të dëgjojnë, të printojnë dhe të shkarkojnë material nga transmetimi në dhjetra gjuhë, duke shkruar te lds.org/study/other-addresses dhe duke klikuar në **Worldwide Leadership Training [Trajnimin e Udhëheqjes Mbarëbotërore].** ■

Kërkesa për Artikuj

Revista *Liahona* interesohet të lexojë për zakonet tuaja të Krishtlindjes:

- Si e feston sezonin [e Krishtlindjes] familja juaj?
- Cilat zakone janë të përbashkëta në kulturën tuaj?
- Çfarë zakonesh keni krijuar për të afruar veten dhe familjen tuaj më shumë me Shpëtimtarin?
- Çfarë përvojash të paharrueshme Krishtlindjeje – veçanërisht ato të lidhura me traditat – mund të na tregoni?

Ju lutemi, dërgojini kujtimet dhe idetë tuaja te *Liahona* deri më 1 qershor 2012, në liahona@ldschurch.org. ■

BibleVideos.LDS.org Është Dhuratë për Botën

Gjatë Takimit Shpirtëror të Presidencës së Parë për Krishtlindjen, udhëheqësit e Kishës paraqitën faqen e internetit “The Life of Jesus Christ Bible Videos” [“Videot nga Bibla për Jetën e Jezu Krishtit”], një “dhuratë” për botën.

BibleVideos.lds.org është një vend ku mbahen videot origjinale të shkurtra që përshkruajnë skenat nga jeta e Krishtit, duke i renditur nga profetizimi i engjëllit për lindjen e Krishtit deri te Ringjallja e Shpëtimtarit.

Presidenti Henri B. Ajring, Këshilltar i Parë në Presidencën e Parë, njoftoi për faqen gjatë takimit shpirtëror.

“Sikurse shkrimet e shenjta që këto video të shkurtra ndjekin me besim, ato mund t’ju duken të qeta”, tha ai. “Besimi juaj dhe Fryma e Shenjtë do të krijojnë emocionin që këto ngjarje botëndryshuese meritojnë.”

Materiali për videot po sigurohet nga filmimet e xhiruara në Studion e re Filmike të Kishës LDS Motion Picture Studio South në kompleksin universitar në Goshen të Jutas, ku xhirimi për Projektin e Bibliotekës për Shkrimet e Shenjta nga Dhiata e Re filloi në gusht të 2011-ës.

Projekti do të prodhojë më shumë se 100 video të shkurtra, duke përshkruar jetën e Krishtit, të marrë direkt nga teksti i versionit të mbretit Jakob të Biblës.

Faqja e internetit ka një strukturë që e bën më të lehtë shikimin nga pajisjet e mbartshme (p.sh telefonat smart) dhe është e disponueshme në anglisht (BibleVideos.lds.org), spanjisht (videosdelabiblia.org) dhe portugalisht (videosdabiblia.org). Një program iPad-i është gjithashtu i disponueshëm falas, duke ofruar një mënyrë të re për të përjetuar historitë e Biblës përmes shikimit, dëgjimit dhe prekjes. ■



Përfundimisht, afro 100 video që përshkruajnë skena nga Dhiata e Re për jetën e Krishtit do të jenë të disponueshme në faqen e internetit “The Life of Jesus Christ Bible Videos” [“Videot nga Bibla për Jetën e Jezu Krishtit”].

Plaku Kristoferson dhe Plaku Xhensen u Japin Mësim Anëtarëve në Argjentinë

Të shtunën, më 12 nëntor 2011, Plaku D. Tod Kristoferson, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, dhe Plaku Xhei E. Xhensen, i Presidencës së Të Shtatëdhjetëve, iu drejtuan rinisë, të rinjve në moshë madhore, udhëheqësve të priftërisë dhe anëtarëve në Salta të Argjentinës.

Gjithashtu të pranishëm ishin Plaku Mervin B. Arnold, President i Zonës Jugore në Amerikën e Jugut; bashkëshortja e tij, Devona; dhe Plaku Ruben Spiteil, Të Shtatëdhjetët Zonalë. Morën pjesë edhe bashkëshortja e Plakut Kristoferson, Kethi, dhe bashkëshortja e Plakut Xhensen, Lona.

Gati 1.300 të rinj dhe prindër morën pjesë në mbledhjen rreth vatrës, ku folën si Plaku Kristoferson ashtu edhe Plaku Xhensen. 10.000 anëtarë të tjerë në 70 qendra kунji në të gjithë Argjentinën e ndoqën përmes transmetimit.

Plaku Xhensen, i cili shërbeu më parë si President i Zonës Jugore në Amerikën e Jugut, tha: “Nëse nuk mbani mend asgjë nga ato që thashë, do doja që të kujtoni një frazë nga një profet, Presidenti Tomas S. Monson, për të cilin unë dëshmoj se është një profet i vërtetë i Perëndisë. Kjo është fraza: ‘Vendimet përcaktojnë fatin’.”

Ne kemi lirinë e zgjedhjes – aftësinë dhe privilegjin për të marrë vendimet – tha Plaku Xhensen, dhe me ato vendime ne zgjedhim fatin tonë.

Ai tregoi historinë e një miku i cili një natë ngau makinën në ndikimin e alkoolit dhe shkaktoi një aksident që u mori jetën dy njerëzve. Ai e krahasoi atë me historinë e zgjedhjes së tij dhe të bashkëshortes së tij për të shtyrë martesën, në mënyrë që ai të shërbente në një mision kur ishte i ri.

“Pas [kthimit tim] ne u martuan në tempull. Ne bëmë besëlidhjet, të cilat i kemi rinovuar çdo javë gjatë gjithë jetës sonë. Ne morëm një vendim që ka përcaktuar fatin tonë”, tha ai.

Motra Kristoferson vijoi, duke ndarë dëshminë e saj rreth bekimeve të mbajtjes së besëlidhjeve dhe Plaku Kristoferson e mbylli mbledhjen.

“E vetmja gjë për të cilën ju keni vërtet nevojë është dashuria dhe besimi”, tha Plaku Kristoferson. “Është besimi që na ndihmon në martesën, familjen, profesionin [dhe] punësimin tonë.”

Ai theksoi se urdhërimet na japin drejtim në jetën tonë dhe na ndihmojnë të marrim atë që është vërtet e rëndësishme.

Më pas ai i këshilloi edhe të rinjtë edhe prindërit e tyre që të bënin një zotim për të ndjekur këshillën që gjendet te broshura *Për Forcën e Rinisë*.

FOTOGRAFI NGA JAMES DALRYMPLE



“Kjo do t’i forcojë jashtëzakonisht fëmijët tuaj, edhe kur e gjejnë veten të vetmuar – duke ditur se prindërit veprojnë në përputhje të po këtyre parimeve”, tha ai.

Plaku Kristoferson e mbylli me një shprehje të dashurisë për anëtarët në Argjentinë, ku ai shërbeu në një mision pothuaj 50 vjet më parë.

Ndërsa në Salta, Plaku Kristoferson dhe Plaku Xhensen gjithashtu u takuan me misionarët vendorë dhe të rinjtë beqarë në moshë madhore, të cilëve iu shprehën dashurinë e Vëllezërve.

Për të lexuar më shumë për shërbesën e Apostujve të kohëve të sotme, vizitoni Prophets and Apostles Speak Today [Profetët dhe Apostujt Flasin Sot] në LDS.org. ■

Si Plaku Kristoferson ashtu dhe Plaku Xhensen iu drejtuan misionarëve nga Misioni Rezistensia i Argjentinës në fillim të muajit nëntor 2011.



Tempulli i Kecaltenangos në Guatemala, i dedikuar më 11 dhjetor 2011, nga Presidenti Diter F. Uhtdorf, është tempulli i 136-të i Kishës.

Dedikimi i Mbajtur për Tempullin Kecaltenango në Guatemala

Tempulli i Kecaltenangos në Guatemala u dedikua të dielën, më 11 dhjetor 2011, në tre sesione nga Presidenti Diter F. Uhtdorf, Këshilltar i Dytë në Presidencën e Parë. Seksionet e dedikimit u transmetuan për kongregacionet e Kishës brenda distriktit të tempullit.

“Çfarë tempulli i mrekullueshëm është”, tha Presidenti Uhtdorf në festimin kulturor të shtunën, ku interpretues të rinj nga kongregacionet e zonës kërcyen, kënduan dhe paraqitën një shfaqje pamore të historisë e kulturës së vendit. “Ka një shkëlqim të gjallë si një gur i çmuar dhe është një gur i çmuar për këtë zonë të këtij vendi.”

Tempulli i Kecaltenangos në Guatemala është tempulli i 136-të i Kishës në mbarë botën dhe i pesti në Amerikën Qendrore. Ky tempull do t’u shërbejë pothuajse 60.000 shenjtorëve të ditëve të mëvonshme.

Kisha Nis Punimet për Tempullin e Shtatë në Brazil

Më 15 nëntor 2011, Plaku Dejvid A. Bednar, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, kryesoi në ceremoninë e fillimit të punimeve për Tempullin e Fortalesas në Brazil, tempulli i shtatë i Kishës në Brazil.

“Ky tempull do të jetë një burim shprese, drite dhe besimi në Perëndi për të gjithë ata që vijnë dhe ecin këtu dhe në këtë fushë”, tha Plaku Bednar. “Ky qytet gjithmonë do të jetë më i mirë dhe ndryshe, për shkak të tempullit që do të ndërtohet këtu.”

Tempulli do të ndërtohet në Avenida Santos Dumont në Fortalesa, Kiara, Brazil. Presidenti Tomas S. Monson njoftoi ndërtimin e Tempullit Fortalesa në Brazil gjatë konferencës së përgjithshme të tetorit 2009. ■

Koncerti në Puerto-Riko Tërheq me Mijëra Njerëz

Më 18 dhjetor 2011, anëtarët e pesë kunjëve të Puerto-Rikos morën pjesë në një koncert për Krishtlindjen të mbajtur në Pazeo de las Artes [Pallatin e Arteve] në qytetin e Kaguas. Interpretuan përafërsisht 85 anëtarë të Kishës dhe morën pjesë 2.500 anëtarë të komunitetit.

Qendra e Re e Të Rinjve në Moshë Madhore është e Treta në Afrikë

Më 4 nëntor 2011, të rinjtë në moshë madhore të Kunjtit të Souetos në Afrikën e Jugut mbajtën aktivitetin e tyre të parë në një ndërtesë të re që do të përdoret vetëm si qendër për të rinjtë në moshë madhore.

Ekzistojnë më shumë se 140 qendra në të gjithë Europën dhe disa janë shpërndarë në të gjithë Shtetet e Bashkuara. Qendra në Soueto është e treta në Afrikë; dhe qendrat e tjera ndodhen në Republikën Demokratike të Kongos dhe Zimbabve.

Takimi i Pazakontë Nxit Pyetje

Një rrotull letre ishte zanafilla e aktivitetit të misionarëve për “Pyetjet për Perëndinë” në Nizhnie, Novgorod të Ruisë, më 9 tetor 2011.

Përgjatë disa orëve, më shumë se 150 njerëz ndaluan pranë dy tavolinave në një rrugë plot me njerëz, morën stilolapsat dhe shkruan pyetjet e tyre. Nga të gjitha pyetjet, 84 prej tyre u shkruan në një rrotull letre. Shumë njerëz shprehën dëshirën për një përgjigje nga misionarët e pranishëm.

Për të lexuar më shumë rreth kësaj dhe histori të tjera, ju lutemi, vizitoni news.lds.org. ■

Një Busull e Domosdoshme

Revista *Liahona* është një fener në këtë jetë. Me të, unë kurrë nuk do të humbas. Unë besoj se kushdo që i lexon revistat e Kishës mund të gjejë saktësisht atë për të cilën ai ose ajo ka nevojë. Unë jam presidentja e Fillores dhe shoh që fëmijëve u pëlqen shumë të dëgjojnë histori rreth fëmijëve si vetja e tyre në revistë. *Liahona* është një busull e domosdoshme në jetën tonë; ajo na ndihmon të shmangim grackat e Satanit.


Janina Ivanivna Davidenko, Ukrainë

Përvojat Shtojnë Ngushëllimin

Liahona më ka ndihmuar shumë përmes mesazheve dhe artikujve të saj. Me jetën e trazuar që ne kemi, unë shpesh ndaloj gjatë ditës dhe lexoj një artikull nga revista që ndan përvoja të jetës së anëtarëve të tjerë. Këta artikuj më ndihmojnë gjithmonë të gjej pak mbështetje shpirtërore dhe të përtërij dëshirën time për t'u kthyer në praninë e Perëndisë dhe Jezu Krishtit me familjen time.

Zhao Karlos, Brazil

Ju lutemi, dërgojini komentet ose sugjerimet tuaja tek liahona@ldschurch.org. Përgjigjet mund të redaktohen lidhur me gjatësinë apo qartësinë. ■



Ky numër përmban artikuj dhe aktivitete që mund të përdoren për mbrëmjen familjare në shtëpi. Në vijim janë dy shembuj.



“Bekimet e Seminarit”, faqja 20: Shqyrtojini artikujt para kohe dhe vendosni se si ta zbatoni më së miri mesazhin me familjen tuaj. Nëse keni adoleshentë në seminar, filloni duke i pyetur përse seminari është i rëndësishëm për ta. Më pas lexoni pjesën e titulluar “Marrja e Bekimeve të Premtuara”. Nxitini fëmijët e vegjël që të përgatiten për të marrë pjesë në seminar kur të arrijnë moshën e duhur. Nëse nuk keni të rinj të moshës së seminarit, ju mund të dëshironi ta lexoni artikullin dhe më pas të diskutoni mbi rëndësinë e seminarit për rininë e sotme.

“Të Gjithë e Njohin Bllekun”, faqja 42: Mendoni për të kënduar “Bëj Ç’Është e Drejt’ ” (*Himne dhe Këngë të Fëmijëve*, nr. 34) si himn hapjeje. Lexoni ose përmbliidhni historinë rreth Blleku. Kërkojuni pjesëtarëve të familjes të tregojnë një përvojë kur u duhej të merrnin një vendim të vështirë midis rrugëve të ndryshme dhe çfarë pasojash rrodhën nga vendimi që ata morën. Mbylleni duke lexuar citatin nga Presidenti Tomas S. Monson. ■

E Thjeshtë, e Qetë dhe e Paharrueshme

Ishte një mbrëmje e paharrueshme familjare me dy vajzat tona të vogla, Anxhelika, 6 vjeç dhe Bethani, 4 vjeç. Unë edhe bashkëshorti im ishim kruspullosur në karriget tona, të lodhur dhe duke mos ditur nga t’ia fillonim. Kështu që vajzat tona morën situatën në dorë dhe përgatitën grafikun e caktimit të detyrave për mbrëmjen familjare, duke na dhënë secilit një detyrë. Detyra e bashkëshortit tim ishte të drejtonte, Bethani u caktua për muzikën, unë kisha aktivitetet dhe Anxhelika duhet të jepte mësimin.

Bethani zgjodhi këngën “I Love to See the Temple” [“Unë e Dua Tempullin”] (*Children’s Songbook*, 95), dhe e kënduam atë së bashku. Babai bëri lutjen e hapjes. Më pas Anxhelika mori botimin më të fundit të revistës *Liahona* dhe zgjodhi një artikull në pjesën për fëmijët. Ajo po mëson të lexojë në shkollë, kështu që ajo na e lexoi artikullin. Ndjenja në shtëpinë tonë ishte një ndjenjë qetësie. Shpirti dëshmoi se ajo që ajo po lexonte ishte e vërtetë.

Ne luajtëm disa lojëra së bashku dhe unë bëra lutjen e mbylljes. Teksa po lutesha, nuk reshtja së falënderuari Atin tonë Qiellor për Shpirtin e dashurinë e Tij, dhe gjithashtu që na kishte bekuar shtëpinë me këta shpirtra të vegjël. Unë dhe bashkëshorti im e dimë se përgjegjësia jonë është të kujdesemi për to dhe t’u mësojmë atyre ungjillin. Mbajtja e mbrëmjes familjare është pjesë e asaj përgjegjësie të shenjtë. ■

Silvi Pusin, Reunion

**Nga Peshkopi
Richard C. Exhli**

Këshilltar i Parë në
Peshkopatën Kryesuese



SHPRESË TE SHLYERJA

Unë kam takuar njerëz që i kanë humbur të gjitha shpresat. Pendimi, sipas tyre, nuk është menduar për ta dhe falja nuk është e disponueshme për ta. Njerëzit pa shpresë nuk e kuptojnë fuqinë pastruese të Shlyerjes. Ose, nëse e kuptojnë, ata nuk e kanë bërë pjesë të vetes kuptimin e vuajtjes së Jezu Krishtit në Gjetseman dhe në kryq. Për çdonjërin nga ne, të heqim dorë nga shpresa për pastrimin e jetës sonë, është të mohojmë thellësinë, fuqinë dhe përmasën e vuajtjes së Tij për ne.

Disa vite më parë, mua m'u caktua të intervistoj një djalë 21-vjeçar ndërsa isha në konferencë, për të përcaktuar denjësinë e tij për të shërbyer në një mision. Tani, Autoritetet e Përgjithshme nuk i intervistojnë zakonisht misionarët e mundshëm. Kështu që kjo qe e pazakontë. Ndërsa lexova disa nga të dhënat lidhur me arsyet për intervistën time, me dhembti zemra. Ky djalë kishte kryer shkelje të rënda. Unë vrava mendjen se përse do të më kërkohet të vizitoja dikë me të dhëna të tilla, duke arritur në përfundimin se do të ishte shumë e pazakontë për mua që të jepja miratimin tim për ta rekomanduar si misionar.

Pas sesionit të së shtunës pasdite të konferencës, unë shkova në zyrën e presidentit të kunjit për intervistën. Ndërsa po prisja, u afrua një i ri simpatik me një shprehi të mahnitshme fytyre. Unë pyeta veten se si mund të justifikohesha, pasi ishte e dukshme se ai dëshironte të bisedonim dhe unë kisha një takim me një

*Shpresa duhet
bazuar jo ve-
tëm te njohuria
dhe dëshmia,
por edhe tek të
jetuarit e vër-
tetetë të Shlyerjes
në jetën tonë
vetjake.*

djalë shumë problematik. Pastaj ai u prezantua. Ai ishte i riu për të cilin isha aty.

Në fshehtësinë e zyrës, unë i bëra një pyetje: "Pse po të intervistoj ty?"

Ai rrëfeu të shkuarën e tij. Kur mbaroi, ai filloi të shpjegojë hapat dhe vuajtjen vetjake që kishte kaluar. Ai foli për Shlyerjen – fuqinë e pafundme të Shlyerjes. Ai ndau dëshminë e tij dhe shprehu dashurinë e tij për Shpëtimtarin. Pastaj ai tha: "Unë besoj se vuajtja vetjake e Shpëtimtarit në Gjetseman dhe sakrifica e Tij në kryq ishin caq të fuqishme sa të shpëtojnë edhe një njeri si unë".

I prekura nga përlësia e tij dhe nga Shpirti, unë thashë: "Unë do të të rekomandoj që të shërbesh si një përfaqësues i Jezu Krishtit". Më pas i thashë: "Do të kërkohet vetëm diçka nga ti. Unë dëshiroj që ti të jesh misionari më i mirë në të gjithë Kishën. Kjo është e gjitha."

Tre apo katër muaj më vonë, Motra Exhli dhe unë po flisnim në një qendër trajnimit misionarësh. Në fund të mbledhjes shpirtërore, unë po vizitoja misionarët kur pashë një të ri me një fytyrë të njohur.

Ai më pyeti: "A më mbani mend?"


Paksa i turpëruar i thashë: "Më vjen keq. E di se duhet, por unë nuk të mbaj mend."

Pastaj ai tha: "Lermë të të tregoj se cili jam. Unë jam misionari më i mirë në qendrën e trajnimit të misionarëve." Dhe unë e besova atë.


Shpresa e këtij të riu ishte e bazuar jo vetëm te njohuria dhe dëshmia e Shlyerjes por edhe te personalizimi i kësaj dhurate. Ai e kuptoi se ajo ishte personalisht për të! Ai e njihnte fuqinë e Shlyerjes dhe shpresën që ajo të jep kur gjithçka të duket e kotë apo e pashpresë. ■

Nga një fjalim i mbledhjes shpirtërore të mbajtur në Universitetin "Brigam Jang" më 4 nëntor të vitit 2008. Për tekstin e plotë në anglisht vizitoni adresën speeches.byu.edu.

Këtë vit shumë botime të *Liahonës* do të përmbajnë një komplet figurash të shkrimeve të shenjta nga Libri i i Mormonit. Në mënyrë që t'i bëni ato të forta dhe të lehta për t'u përdorur, pritini dhe ngjitini me zamkë ose shirit ngjitës në një letër të trashë, në qese të vogla letre ose në shkopinj artizanalë. Ruajeni çdo komplet në një zarf ose qese, së bashku me kuadratin që tregon se ku gjendet shkrimi i shenjtë që përputhet me figurat.



Alma



Amuleku



Zizromi

Misioni i Almës dhe
Amulekut të Amoniha

Alma 8–14



“Ju dhe unë kur ndihemi të dobët mund të bërtasim me hidhërim: ‘Askush nuk e kupton.

Askush nuk e di’”, shkroi Plaku Dejdiv A.

Bednar i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve. “Ndoshta, asnjë qenie njerëzore nuk e di. Por Biri i Perëndisë e di dhe e kupton përsosmërisht, sepse Ai i ndieu dhe i mbajti barrat tona përpara se ne ta bënim ndonjëherë. Dhe për shkak se Ai pagoi çmimin përfundimtar dhe e mbajti atë barrë, Ai mund të na kuptojë plotësisht dhe mund të shtrijë ndaj nesh krahun e Tij të mëshirës në shumë faza të jetës sonë. Ai mund të arrijë, mund të na prekë emocionalisht, të na ndihmojë - të vrapojë vërtet drejt nesh - dhe të na forcojë.” Shih “Shlyerja dhe Udhëtimi i Vdekshmërisë”, faqe 12.